



MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA

**STRATEGJIA KOMBËTARE
PËR BARAZINË GJINORE DHE KUNDËR
DHUNËS NË FAMILJE
2007-2010**

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit përbën një dokument të rëndësishëm të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.913, datë 19.12.2007.

Në hartimin dhe zbatimin e kësaj strategjie nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta rol të rëndësishëm kanë luajtur agjensitë e Kombeve të Bashkuara si UNIFEM, UNDP, UNFPA, UNICEF, si dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Ribotimi i Strategjisë kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje u realizua në kuadrin e projektit “Fuqizimi i mekanizmit kombëtar për promovimin e barazisë gjinore”.



Ky projekt është mbështetur nga Qeveria e Lihtenshtajnit

Projekti është zbatuar nga Njësia e Barazisë Gjinore dhe Shoqërisë Civile pranë Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.



**MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA**



Organizata për Sigurim
dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Përgatitur në Tiranë, Shqipëri 2008
Shtypur në shtypshkronjën Pegi



NJË STRATEGJI PËR NJË SHOQËRI ME BARAZI GJINORE DHE PA DHUNË.

Në Korrik të vitit 2006, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ndër-mori iniciativën për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit, duke dëshmuar angazhimin politik të Qeverisë për t'i dhënë lëvizjes për barazinë gjinore një dokument politikash të harmonizuara me iniciativat e shoqërisë civile.

Barazia gjinore është një e drejtë themelore qytetare, një vlerë e përbashkët e vendeve të Bashkimit Europian, e për këtë arsye një kusht i domosdoshëm për integrim dhe realizim të objektivave për punësimin dhe kohezionin social të MSA, të cilën Shqipëria ka nënshkruar në qershor të vitit 2006.

Në Shqipëri gratë dhe vajzat kanë arritur nivele të larta të edukimit, progres në tregun e punës dhe në jetën publike. Megjithatë, pabarazia gjinore mbetet një shqetësim për shoqërinë, duke vendosur shumë gra në dilemën midis rritjes së fëmijeve apo zhvillimit të karrierës, për shkak të mungesës së përshtatjeve në orare, shërbime sociale, dhe pengesa të tjera që sjellin stereotipet tradicionale gjinore dhe mendësia mashkullore e shoqërisë.

Në shoqërinë e sotme shqiptare vihet re gjithashtu një rritje e fenomenit të dhunës në familje, e cila ushtrohet më shumë mbi gratë dhe vajzat, fëmijët dhe të moshuarit. Studimet tregojnë se dhuna shfaqet në të gjitha format: dhunë emocionale, si forma më shpesh e hasur e dhunës në familje; dhunë ekonomike, e cila ndeshet më shumë në zonat urbane; dhunë fizike, e cila ndeshet më shumë në zonat rurale; dhunë seksuale, e cila rezulton më pak e raportuar. Grup moshat që përjetojnë më shumë dhunë janë 18 - 23 vjeç dhe 37- 45 vjeç, ndër të cilat më të rrezikuara janë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, gratë dhe vajzat migrante, gratë dhe vajzat rome si dhe gratë dhe vajzat e zonave rurale..

Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje diktohet nga nevoja për zhvillimin dhe përmirësimin e statusit të gruave dhe vajzave në Shqipëri, kapërcimin e barrierave dhe diferencimeve gjinore, për ecjen drejt rrugës së gjatë e të vështirë të barazisë gjinore, për harmonizimin me kërkesat dhe standartet për çështjet e barazisë gjinore dhe integrimin e tyre në politikat dhe programet publike: nga Konferenca e Pekinit 1995, Pekin +5, +10, procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE, Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit etj.

Synimi Strategjisë është të paraqesë rrugët dhe mekanizmat institucionalë për përfshirjen e çështjeve gjinore në politikat publike, për zbutjen e dallimeve gjinore dhe dekurajimin e parandalimin e dhunës në familje.

Strategjia është konceptuar në dy pjesë: Barazia Gjinore dhe Lufta kundër Dhunës në Familje, të cilat janë të ndërthurura ngushtë me njëra – tjetrën, por kanë edhe specifikat e tyre. Drejtimet kryesore të Strategjisë janë përcaktuar mbështetur në kushtet aktuale të vendit, sidomos problemeve më shqetësuese me të cilat përballlet shoqëria shqiptare. Këtij qëllimi i shërben analiza e situatës aktuale në 12 prefekturat e vendit, analiza e studimeve të fundit të realizuara nga institucionet qe-

veritare, shoqëria civile dhe ekspertë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje, mbështetur në standartet ndërkombëtare si Plani i Veprimit i Pekinit, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), objektivat e Mijëvjeçarit etj.

Hartimi i Strategjisë u realizua mbi bazën e një procesi gjithpërfshirës. Ky proces përfshiu hartimin e projektit nga grupet e punës, të përbërë nga përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, ekspertë të çështjeve gjinore, etj, dhe më pas diskutimi i projektit me grupet e interesit. Këtij diskutimi i shërbyen aktivitetet, të cilat u finalizuan në paraqitjen e projektit të Strategjisë për Parandalimin e Dhunës në Familje të shoqëruar me Planin e Veprimit, në nëntor 2006, dhe projektin e Strategjisë të Barazisë Gjinore në Konferencën Kombëtare “Barazia Gjinore, Kohezioni social dhe Shanset e Barabarta”, në shkurt 2007.

Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje shoqërohet me një Plan Veprimi, të detajuar në objektiva, masa zbatuese, buxheti përkatës, treguesit e matshëm dhe afatet kohore për realizimin tyre. Gjithashtu janë përcaktuar edhe institucionet kryesore përgjegjëse dhe bashkëpunëtorët për çdo masë zbatuese.

Ky dokument i rëndësishëm, së bashku me ligjet e miratuara së fundi si Ligji Nr. 9669 dt. 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe Ligji Nr. 9198, datë 01.07.2004 “Për një shoqëri gjinore të barabartë”, i cili është në proces përmirësimi, përbëjnë një bazë të rëndësishme politikash e ligjore për progresin drejt barazisë gjinore dhe familjes pa dhunë.

Në hartimin e Strategjisë kanë luajtur një rol të rëndësishëm edhe organizatat ndërkombëtare si Organizatat e sistemit të OKB-së (UNFPA, UNIFEM, UNICEF, UNDP) dhe OSBE, të cilat përfitoj nga rasti ti përshëndes e u shpreh mirënjohjen për mbështetjen teknike dhe financiare që ofruan.

Një falenderim i veçantë i drejtohet Kryeministrit të Shqipërisë, Z. Sali Berisha, i cili mbështeti fuqimisht këtë iniciativë dhe kontribuoi me pjesëmarrjen e tij në Konferencën Kombëtare ku u prezantua draft Strategjia dhe Plani i Veprimit, duke rikonfirmuar edhe një herë prioritetin në Programin e Qeverisë për çështjet e barazisë gjinore.

Gjithashtu falenderoj Znj. Marieta Zaçe, Zëvendësministre e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për punën drejtuese, serioze, profesionale e të përkushtuar në hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm, grupin koordinues të projektit për hartimin e Strategjisë, punonjësit e sektorit të barazisë gjinore në Drejtorinë e Politikave të Shanseve të Barabarta, të gjithë drejtuesit dhe anëtarët e grupeve të punës që morën pjesë në hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, si dhe të gjithë bashkëpunëtorët dhe kontribuesit në këtë proces.

Strategjia u hartua. Këtë e tutje sfida qëndron në zbatimin e saj.

Koço Barka
Ministër i Punës, Çështjeve
Sociale dhe Shanseve të Barabarta

GRUPI HARTUES I STRATEGJISË KOMBËTARE TË BARAZISË GJINORE DHE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE.

Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje u drejtua nga
Znj. Marieta Zaçe – Zëvendësministre e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta

Znj. Rajna Kovaçi – Drejtore

Znj. Valbona Jaupllari – Specialiste

Znj. Irena Benussi – Specialiste

Znj. Brunilda Dervishaj – Specialiste

Znj. Arta Sakja – Koordinatorë për Barazinë Gjinore

Znj. Luljeta Dauti – Financiere

Znj. Aida Orgocka – Eksperte

Znj. Mirela Muça - Eksperte

Grupet e punës - Barazia gjinore:

Balanca Gjinore në Vendimmarrje

Znj.Lajla Pernaska, Znj.Jeta Katro, Znj.Yllka Selimi, Z.Petro Koçi, Znj.Albana Imami, Znj.Man-
galina Cane, Znj.Natasha Llanaj.

Të drejtat e gruas, legjislacioni dhe mekanizmi institucional

Znj.Kledia Mazniku, Znj.Brunilda Dervishaj, Znj.Rezana Balla, Znj.Ermira Deçka, Znj.Vitore Tu-
sha, Znj.Alma Mehmeti, Z.Ervin Pupe.

Fuqizimi Ekonomik i Gruas

Znj.Arjana Misha, Znj.Merita Gjashta, Znj.Alketa Grepcka, Znj.Rajmonda Prifti, Znj.Neriana Zai-
mi, Znj.Ahmedie Daci.

Kujdesi Social

Znj.Meri Pone, Znj.Merita Xhumari, Znj.Valbona Jaupllari, Znj.Irena Benussi, Znj.Lantona Sado,
Znj.Mira Trebicka, Znj.Dajana Berisha.

Arsimi dhe Eleminimi i Dallimeve Gjinore

Znj.Antonieta Luli, Znj.Xhuli Jaho, Znj.Englantina Gjermani, Znj.Saemira Pino, Znj.Eljona Kul-
luri, Znj.Lavdie Ruci, Znj.Migena Reçi.

Kujdesi Shëndetësor

Z.Naim Lusha, Znj.Nedime Ceka, Znj.Majlinda Murati, Znj.Elizana Petrela, Znj.Arjana Malltezi,
Znj.Violeta Dhamo.

Gruaja dhe Media

Znj.Majlinda Bregu, Znj.Rajna Kovaçi, Znj.Alma Lahe, Znj.Antoneta Malja, Z.Demir Gjergji, Znj.
Elsa Xhai, Znj.Valdete Andoni.

Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim:

Znj. Eglantina Gjermeni – Drejtuese e Qendrës së Aleancës Gjimore për Zhvillim

Znj. Blerta Picari – Koordinatore për Dhunën në Familje

Grupi i Punës – Parandalimi i Dhunës në Familje:

Znj.Arta Mandro, Znj.Aida Orgocka, Znj.Anxhela Gramo, Znj.Zhulieta Demi, Znj.Arta Sakja, Znj.

Mirela Muça, Znj.Emira Shkurti, Znj.Daklea Shtylla, Znj.Natasha Shehu.

Konsulentë për strategjinë

Znj. Monika Kocaqi

Znj. Orgesta Muço

Bashkëpunëtorë të tjerë

Qendra për Gratë dhe Vajzat – Kombinat, Shoqata “Gruaja Kryefamiljare”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit- Tiranë; Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri; Qendra e Nismës Ligjore; Nisma për të Drejtat e Grave; Shoqata “Në dobi të Gruas Shqiptare”; Qendra e Trajnimit Multidisiplinar për Problemin e Keqtrajtimit të Fëmijëve, Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara; Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza – Tiranë, Elbasan, Kukës; Shoqata e Grave me Probleme Sociale – Durrës; Unë – Gruaja – Pogradec; Forumi i Gruas – Elbasan; Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin; Shoqata “Gruaja Kryefamiljare”; Shoqata “Përthyerja”; Medica.

SHKURTIME

ACER	Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike
BE	Bashkimi European
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
DRA	Drejtoria Rajonale Arsimore
DSHB	Drejtoria e Shanseve të Barabarta
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë
INSTAT	Instituti i Statistikave
KC	Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
KEDNJ	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
KF	Kodi i Familjes
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KP	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
KPC	Kodi i Proçedures Civile të Republikës së Shqipërisë
KPP	Kodi i Proçedures Penale të Republikës së Shqipërisë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MI	Ministria e Integritimit
MJ	Ministria e Jashtme
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Pushteti Vendor
QKTA	Qendra Kombëtare e Trajnimit të Arsimit
QKAVP	Qendra Kombëtare e Arsimit, Vlerësimit
QNLQ	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
QKCSAISH	Qendra Kombëtare Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore
RSH	Republika e Shqipërisë
SST	Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHP	Shkolla e Policisë

PËRMBAJTJA

HYRJE

KAPITULLI I PARË: SITUATA AKTUALE

1.1.	Situata Demografike dhe Struktura Gjinore	15
1.1.1.	<i>Balanca Gjinore në vendimmarrje</i>	15
1.1.2.	<i>Situata ekonomike, pabarazia në varfëri si dhe pabarazia në forcat e punës</i>	17
1.1.3.	<i>Situata aktuale në lidhje me dallimet gjinore në arsim</i>	20
1.1.4.	<i>Situata aktuale në lidhje me mbrojtjen sociale</i>	21
1.1.5.	<i>Situata aktuale në lidhje me kujdesin shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore</i>	22
1.1.6.	<i>Situata e aktuale në lidhje me përfaqësimin dhe prezantimin e gruas në media</i>	24
1.1.7.	<i>Situata aktuale në lidhje me Dhunën në Familje</i>	25
1.2.	Kuadri Ligjor - Barazia Gjinore dhe Dhuna në Familje	37
1.2.1	Barazia gjinore	37
1.2.2	Dhuna në familje	38
1.3.	Mekanizmat Institucionalë që Sigurojnë Barazinë Gjinore në Shqipëri dhe adresojnë Dhunën në Familje	38
1.3.1.	<i>Mekanizmi qeveritar që siguron barazinë gjinore</i>	38
1.3.2.	<i>Mekanizma të tjerë</i>	39
1.3.3.	<i>Mekanizmi qeveritar që adreson dhunën në familje</i>	40

KAPITULLI I DYTE: VIZIONI, PRIORITETET STRATEGJIKE DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

2.1.	Vizioni	43
2.2.	Prioritetet strategjike	43
2.3.	Qëllimet strategjike	44

KAPITULLI I TRETË: POLITIKAT

3.1.	Përmirësimi i mëtejshëm i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë barazinë gjinore në Shqipëri	45
3.2.	Balanca gjinore në vendimmarrje	45
3.3.	Fuqizimi ekonomik si një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore	45
3.4.	Arsimi dhe eliminimi i dallimeve gjinore	46
3.5.	Mbrojtja Sociale	47
3.6.	Kujdesi shëndetësor	48
3.7.	Eliminimi i stereotipeve gjinore në massmedia	49
3.8.	Adresimi i Dhunës në Familje	49

KAPITULLI I KATËRT: LLOGARIDHËNIA

Llogaridhënia	53
---------------	----

PLANI I VEPRIMIT

54

ANEKSI 1	Përshkrimi i Legjislacionit	113
ANEKSI 2	Referenca lidhur me kuadrin ligjor për mbrojtjen sociale	121
ANEKSI 3	Referenca lidhur me kuadrin ligjor për dhunën në familje	123

HYRJE

Çështjet e barazisë gjinore janë në qendër të politikave sociale të vendeve të BE dhe një nga kërkesat për vendet që kanë hyrë në procesin e integritit evropian. Lënia jashtë vëmendjes apo mos trajtimi me kujdes i tyre, do të sillte për pasojë rrezikun e mos përfitimit maksimal të rreth 50% të popullsisë, nga progresi i arritur nëpërmjet reformave shoqërore, politike dhe ekonomike. Pabarazia gjinore, e cila evidentohet në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në Shqipëri, nëse nuk do të vihet në qendër të politikave sociale, do të dëmtojë përpjekjet e Shqipërisë për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, pasi jo vetëm nuk do të shfrytëzohet potenciali i plotë njerëzor i vendit, por arritjet nuk do t'i gëzojnë të gjitha grupet shoqërore. Për rrjedhojë, integrimi gjinor duhet të jetë pjesë e të gjitha politikave sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri, për të pasur arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm nëpërmjet shfrytëzimit të potencialit të plotë njerëzor të vendit, sikurse dhe garantimit të gëzimit të këtyre arritjeve nga të gjitha grupet shoqërore.

Kjo është baza për të kuptuar përse çështjet gjinore po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për shoqërinë shqiptare. Në shekullin që sapo kemi hyrë, pas viteve 2000, ka pasur zhvillime të rëndësishme institucionale dhe strukturore për përparimin dhe emancipimin e mëtejshëm të grave në shoqërinë shqiptare, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen aktive të tyre njëjloj si burrat në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit. Në këtë drejtim vihen re gjithnjë e më tepër përpjekjet të vazhdueshme për të koordinuar iniciativat shtetërore me angazhimin gjithnjë e më në rritje të shoqërisë civile.

Prioritet iu është dhënë hartimit të strategjive të ndryshme sektoriale dhe ndërsektoriale, kryesisht me përmasa afatmesme. Por ndërsa procesi i hartimit të këtyre strategjive rezulton të përmbillet pozitivisht, procesi i zbatimit të tyre rrezikohet si pasojë e ndërlikimit të një sërë faktorësh, ndër të cilët mund të renditim: moszbatimin apo mungesën e korrektesisë në zbatimin e ligjit, kapacitetet e pamjaftueshme të administratës publike me tregues relativisht të lartë të korrupsionit, mosplanifikimin në kohë dhe me objektivitet, mungesën apo pamjaftueshmërinë e burimeve financiare, etj. Prandaj rëndësi të veçantë ka marrja e masave për zbutjen apo parandalimin e ndikimit të faktorëve të sipërpërmendur në suksesin e zbatimit të të gjitha strategjive të hartuara.

Iniciativa e MPCSSHB për hartimin e “Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore” dhe Kundër Dhunës në Familje vjen paralelisht me procesin e hartimit dhe aprovimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), një dokument ky tashmë në përmirësim dhe që synon t'i përgjigjet dinamikës së evolimit të ideve, si dhe që pranon përfshirjen e interesave dhe qëndrimeve të reja që përcaktojnë ecurinë e zhvillimeve sektoriale, tërësore apo dhe në favor të grupeve të ndryshme shoqërore.

Kjo strategji është fryt i një procesi ndërveprues dhe gjithë përfshirës i cili angazhoi institucione të qeverisjes qendrore, lokale, shoqërisë civile, shoqatave jo-qeveritare, grupe të ndryshme interesi, përfaqësues të forcave politike në vend, përfaqësues të fushës akademike, si dhe partnerë ndërkombëtare. Dokumenti u hartua si rezultat i **pjesëmarrjes së të gjithë aktorëve dhe palëve**

të interesuara në çështje të barazisë gjinore. Kjo pjesëmarrje e gjerë synoi të rrisë vlefshmërinë dhe të sigurojë që plani i masave dhe ndërhyrjeve të jetë në përputhje me nevojat dhe mundësitë reale të institucioneve të vendit. Gjithashtu, strategjia është përgatitur për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm qeveritarë (qendrorë e lokalë), donatorëve, shoqërisë civile dhe komunitetit, për të marrë vendime të orientuara dhe drejtuara nga përparësitë e çështjes së barazisë gjinore.

Strategjia është konceptuar në analizen dhe trajtimin e dy çështjeve të rëndësishme: Barazia Gjinore dhe Parandalimi i Dhunës në Familje.

Strategjia synon :

a) të arrijë barazinë gjinore në Shqipëri, nëpërmjet integritit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave. Kjo do të thotë pjesëmarrje e barabartë grave dhe vajzave, burrave dhe djemve në jetën sociale, ekonomike e politike të vendit, si dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në dobi të shoqërisë;

b) të përmirësojë mbrojtjen, reagimin e sistemit të drejtësisë dhe mbështetjen për viktimat e dhunës në familje, si dhe të vendosë një fokus më të qartë në parandalim, duke adresuar shkaqet e dhunës dhe abuzimit në familje.

Gjatë procesit të hartimit të strategjisë, grupet e punës janë mbështetur në:

- ✦ Analizën e situatës socio-ekonomike në Shqipëri, duke marrë në konsideratë treguesit ekonomikë, arsimorë, shëndetësorë dhe kulturorë;
- ✦ Analiza të veçanta për pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në sektorë të ndryshëm, si dhe në strukturat vendim marrëse në nivel qendror e lokal;
- ✦ Mekanizmat ligjorë e institucionalë, si dhe burimet financiare, materiale dhe njerëzore për të hartuar politika efektive që synojnë arritjen e qëllimeve dhe objektivave të vendosura;
- ✦ Identifikimin e vizionit dhe sfidave kryesore për arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri;
- ✦ Përgatitjen e planit të veprimit për të arritur synimet dhe objektivat e kësaj strategjie, si dhe
- ✦ Vendosjen e treguesve bazë për matjen dhe vlerësimin e ecurisë, apo dhe rishikimin e veprimeve në përputhje me situatat e reja që krijohen.
- ✦ Evidentimin e fushave kryesore të ndërhyrjes për parandalimin e dhunës në familje.

Kushtetuta e Shqipërisë sanksionon zyrtarisht barazinë ndërmjet burrave dhe grave, por në praktikë shpesh gratë nuk i gëzojnë njësoj të drejtat e tyre si burrat. Kjo pabarazi është e prekshme në shumë fusha të jetës, prandaj dhe grupet e punës gjatë hartimit të këtij dokumenti konsideruan si të arësyeshëm fokusimin në këto fusha specifike:

1. Mekanizmat ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë barazinë gjinore në Shqipëri,
2. Balanca gjinore në vendim marrje,
3. Fuqizimi ekonomik si një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore,
4. Arësimi dhe zbutja/eliminimi i stereotipeve gjinore të transmetuara nëpërmjet tij,
5. Mbështetja sociale,
6. Kujdesi shëndetësor,
7. Massmedia dhe zbutja/eliminimi i stereotipeve gjinore të transmetuara nëpërmjet saj, si dhe
8. Pesë fusha specifike për parandalimin e dhunës në familje: a) **Arsimin** – si një sektor paran-

dalues; b) **Drejtësinë** – si një sektor parandalues, luftues dhe mbështetës ndaj viktimave; c) **Shëndetësinë**– si një sektor parandalues, luftues dhe mbështetës ndaj viktimave; d) **Shërbimet Sociale**– si një sektor parandalues, luftues dhe mbështetës ndaj viktimave; e) **Ndërgjegjësimi** (ndërsektorial) si një mjet për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje.

Objektivat e këtij dokumenti (të cilat paraqiten shumë të detajuara në faqen në vijim), kryesisht synojnë:

- a) Theksimin e situatës aktuale të grave dhe vajzave, si dhe mënyës së trajtimit të barazisë gjinore dhe dhunës në familje në Shqipëri;
- b) Detajimin e hapave më të rëndësishëm që duhet të ndërmerren për të adresuar prioritetet lidhur arritjen e barazisë gjinore dhe reduktimin e dhunës në familje;
- c) Identifikimin e institucioneve përgjegjëse dhe partnerëve që do të punojnë bashkarisht për arritjen e qëllimeve të kësaj strategjie.

KREU 1

SITUATA AKTUALE

Barazia gjinore është një gur themeli në procesin e zhvillimit të vendit. Për ta arritur atë, duhen shqyrtuar shkaqet e pabarazisë që ndeshen në familje, në komunitet, në tregun e punës dhe në përgjithësi në shoqërinë shqiptare. Ndarja e punës sipas gjinive krijon ngarkesa (të matura sipas kohës dhe energjive), shkallë të njohjes (të prestigjit), si dhe pushtete të ndryshme për gratë dhe burrat. Pabarazia gjinore ndikon negativisht barazpeshimin ndërmjet mundësive, kushteve të jetesës dhe statusit shoqëror të grave/ vajzave dhe burrave / djemve. Transformimi i thellë social dhe ekonomik pas viteve 90-të, sollti ndryshime të dukshme në strukturën e ekonomisë, nivelin e jetesës, si dhe prishjen e ekuilibrit gjinor në shoqërinë shqiptare. Megjithëse gjatë tranzicionit Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm pozitivë drejt ndërtimit të një shoqërie demokratike, liritë e të drejtat që u fituan nuk kanë ndikuar në mënyrë të barabartë tek gratë dhe burrat.

1.1 Situata Demografike dhe Struktura Gjinore.

Popullsia e Shqipërisë karakterizohet nga një moshë e re, mesatarja e së cilës është 31.7 vjeç dhe ndarja e popullsisë sipas seksit është e ekuilibruar, femrat zenë rreth 51% të popullsisë¹. Mosha e re, proceset e urbanizimit, lëvizjet migratore, emigracioni dhe faktorë të tjerë ekonomikë kanë bërë që gjatë viteve të tranzicionit, treguesit demografikë të jenë dinamikë. Kështu, brenda një kohe të shkurtër kanë ndryshuar raportet midis popullsisë rurale dhe urbane. Aktualisht popullsia urbane është rritur në 46% nga 36% që ka qenë në fillim të viteve '90-të. Rritja e popullsisë urbane ka ardhur si pasojë e zhvendosjes së pakontrolluar të popullsisë rurale drejt qyteteve të mëdha, por edhe nga lëvizjet brenda të njëjtit rreth. Sipas vlerësimeve të bëra nga INSTAT, jashtë Shqipërisë llogaritet të kenë emigruar rreth 600.000 shqiptarë ose 18% e popullsisë. Një vështrim i thellë tek grupmoshat e popullsisë tregon se tranzicioni ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë strukturën e popullsisë shqiptare. Gjithashtu një ndryshim themelor ai ka sjellë edhe përsa i përket strukturës së familjes. Përpyekjet për një jetesë më të mirë kanë bërë që familja shqiptare të mos ndryshojë vetëm vendin ku do të jetojë por edhe mënyrën se si jeton. Brenda këtij dhjetë vjeçari, ka ndryshuar ndjeshëm mosha mesatare e martesës nga 22,6 në 23 për femra, dhe nga 27,2 në 28.5 për meshkuj². Po kështu kanë ndryshuar dhe numri i divorceve nga 8,7 në 9,6 për 100 martesa, si dhe numri mesatar i një familjeje me tendencë krijimin e familjeve me dy breza (prindër e fëmijë).

1.1.1. Balanca gjinore në vendimmarrje.

Pabarazitë në respektimin e të drejtave të grave dhe vajzave thellohen edhe nga niveli i dobët i përfaqësimit të tyre në procesin e vendimmarrjes, sikurse dhe nga fakti që shoqëria shqiptare, ende nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur eliminimit të transmetimit stereotipeve gjinore në edukimin e djemve, dhe burrave mbi pozicionin që ata duhet të kenë si brenda familjes ashtu edhe në jetën shoqërore. Pjesëmarrja e ulët e grave dhe vajzave shqiptare në vendimmarrje, me vetëm 7 përqind të vendeve në parlament, me vetëm 11 gra në poste drejtuese³ në qeverinë qendrore dhe me vetëm 2 përqind të drejtuesve në qeverisjen vendore, është një pengesë shumë e madhe në realizimin e

¹ INSTAT 2006 "Femra dhe Meshkuj 2005"

² INSTAT 2006 "Femra dhe Meshkuj 2005"

³ Shifrat iu referohen pozicioneve: Ministre, Zv/ministre, Sekretare e Përgjithshme deri në muajin Tetor 2006; Burimi: Drejtoria e Politikave për Shansë të Barabarta.

reformave dhe politikave të orientuara sipas nevojave të grave, fëmijëve dhe familjes. Megjithëse prania e grave dhe vajzave në administratën publike është disi më inkurajuese, burrat përsëri dominojnë në pozicionet drejtuese.

Edhe përfaqësimi i grave dhe vajzave në postet drejtuese të partive politike është i ulët. Kjo gjendje nuk vjen nga indiferentizmi i tyre për t'u përfshirë në politikë dhe as nuk dëshmon paafëtesinë e grave dhe vajzave në këtë drejtim. Ajo është e lidhur me vështirësitë me të cilat ndeshen gratë dhe vajzat për t'iu përshtatur realitetit të sotëm të politikës shqiptare dhe pasqyron mungesën e standarteve dhe mekanizmave efikasë, për përcaktimin e përparësive që do të mundësonin rritjen e pranisë së grave dhe vajzave në drejtimin e vendit, një rol për të cilin dhe vetë ato duhet të jenë edhe më këmbëngulëse. Niveli i ulët i përfaqësimit të grave të tyre në strukturat vendimmarrëse është tregues i faktit se aspiratat dhe nevojat e grave dhe vajzave nuk janë të përfaqësuara, si dhe kanë pak mundësi për të nxitur politika që adresojnë problemet e tyre, përfshirë edhe varfërinë e pabarazinë gjinore, apo për të përmirësuar statusin dhe rolin e tyre në zhvillimin ekonomik e social të vendit.

Pabarazia e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në veprimtarinë politike. Partitë politike shqiptare vazhdojnë të mos kenë politika specifike mbi barazinë gjinore të cilat do të mund të identifikonin qartë nevojat dhe prioritetet e grave dhe vajzave në pjesëmarrjen politike. Kjo shpjegon dhe faktin pse këto parti nuk kishin deklarime serioze në programet e tyre mbi barazinë gjinore në fushatën elektorale të vitit 2005, apo dhe në programet e sotme, ndonëse shprehen se barazinë gjinore e konsiderojnë çështje të rëndësishme në programet e tyre. Megjithë përpjekjet e vazhdueshme të organizatave politike të grave dhe vajzave për të rritur pjesëmarrjen e tyre në politikë e për rrjedhojë vendimmarrje, duhet thënë se përfaqësimi i tyre në parlament dhe qeveri mbetet ende i ulët. Gratë dhe vajzat vihet re të jenë pjesëmarrëse vërtet shumë aktive gjatë fushatave elektorale. Ato janë promovuese shumë të mira të programeve të forcave të tyre politike, kryejnë mjaft mirë rolin e komisionerit dhe janë një pikë shumë e fortë mbështetëse gjatë realizimit të fushatave, por ky përfaqësim dhe ky rol mjaft aktiv nuk është i vlerësuar nga forcat politike, si e kandiduar në zgjedhje parlamentare dhe veçanërisht ato vendore. Ndonëse ka një kuotë për sa i përket përfshirjes së grave dhe vajzave në strukturat drejtuese partiake, kjo kuotë nuk është e vendosur edhe për përfaqësimin e tyre si e zgjedhur. Megjithë përpjekjet e lëvizjes së gruas për ta përfshirë këtë kuotë në Kodin Zgjedhor, mos vendosja e saj, ka qenë një ndër shkaqet e mos përfaqësimit të duhur të grave në parlament dhe në lidhshimin vendor. Ky përfaqësim dëshmon edhe një herë konservatorizmin e një politike tashmë të njohur si politike e dominuar nga meshkujt në Shqipëri.

Pavarësisht këtij realiteti, zgjedhjet e vitit 2005 shënuan eksperiencën të reja pozitive, pasi për herë të parë në historinë parlamentare të Shqipërisë zgjidhet një grua në postin e kryetares së parlamentit dhe për herë të parë në këto zgjedhje, merr pjesë në garën politike, një forcë politike e kryesuar nga një grua, si dhe kandidon si kandidatë e pavarur një grua.

Përfaqësimi i grave dhe vajzave në shoqërinë civile. Shoqatat jo fitim-prurëse (OJF), të njohura si pjesa më aktive e shoqërisë civile, kanë qenë shumë aktive në zhvillimet demokratike edhe pse shpesh iu është dashur të operojnë në një shoqëri konservatore, në një shoqëri ku për një kohë të gjatë mbizotëroi anarkia dhe kaosi; në një shoqëri që jo rrallë rrezikoi aktivitetin, madje dhe ekzistencën e tyre. Edhe pse në mungesë të një procesi konsultativ ndërmjet shtetit dhe OJF-ve, ato kanë dhënë ndihmesën e tyre duke influencuar madje dhe vendime politike.

Në Shqipëri janë të rregjistruara 614 shoqata⁴ nga të cilat 112 ose 18.24 përqind janë të drejtura nga gratë dhe vajzat, që do të thotë se ato iu përgjigjën menjëherë ndryshimeve në vend, madje dhe duke marrë përgjegjësinë dhe rolin e saj në këto zhvillime demokratike. Një vend në tranzicion si Shqipëria ka shumë se ç'të përfitojë nga pjesëmarrja e gruas në këtë sferë, për rrjedhojë dhe nga kontributi i saj në vazhdimësinë e evolimit të ekonomisë së tregut dhe shoqërisë demokratike. Kjo pjesëmarrje thyen stereotipet e dominancës mashkullore. Si pasojë e mundësisë së kufizuar për pjesëmarrje në organizmat vendimmarrëse, gratë dhe vajzat kanë arritur mundësi drejtuese nëpërmjet alternativave të tjera, në mënyrë të veçantë në sektorin jo-qeveritar. Në këtë sektor ato gjetën më shumë hapësirë dhe liri për një angazhim aktiv në dobi të çështjeve të grave/ vajzave dhe fëmijëve në veçanti, por edhe të komunitetit në tërësi.

Kështu, shoqatat e grave realizuan dhe vazhdojnë të realizojnë një sërë aktivitete lidhur me të drejtat e grave/ vajzave dhe fëmijëve, përkujdesjen sociale e shëndetësore, zhvillimin ekonomik (kryesisht të biznesit të vogël), luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, etj. Që prej vitit 2000, ka nisur dhe është konsoliduar gjithnjë e më shumë një lëvizje kombëtare për fuqizimin politik të gruas, e cila arriti të ketë impaktet e saj në ndikimin e klimës politike dhe sociale në vend, në favor të balancës gjinore. Në një ecuri progresive edhe faktori shumë i rëndësishëm i medias, filloi të ketë në fokus problemet e barazisë gjinore, veçanërisht të pjesëmarrjes së gruas në politikë, ecuri kjo që kulmoi në fushatën zgjedhore të vitit 2005, me disa programe e debate në mediat kryesore në vend. Një element i rëndësishëm në evolucionin e OJF-ve të grave është dhe përmirësimi i organizimit të tyre. Pas vitit 1997 filloi një bashkëveprim më i mirë ndërmjet këtyre OJF-ve, të cilat filluan të organizohen në rrjete e koalicione me programe e aktivitete të përbashkëta.

Akresi dhe kontrolli në vendimmarrjen brenda familjes. Megjithëse mungojnë studimet dhe të dhënat mbi pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrjen brenda familjes, vëzhgime të jetës së përditshme tregojnë se pjesëmarrja e grave dhe vajzave në këtë vendimmarrje është e lidhur me nivelin arsimor të tyre, vendbanimin, moshën dhe aksesin ndaj pronës e të ardhurave. Sa më i ulët të jetë niveli arsimor i gruas, aq më e dobët është edhe fuqia e saj vendimmarrëse, për shkak të mundësive shumë më të pakëta për punësim e sigurim të një pavarësie ekonomike. Po kështu, gratë dhe vajzat në zonat rurale, gratë dhe vajzat e varfëra, si dhe ato të papuna, kanë pak të drejta në vendimmarrjen për çështje të rëndësishme brenda familjes. Kur vendimmarrja lidhet me shpenzimin e parave, në shumicën dërrmuese të rasteve vendimi final merret nga burrat e familjes, të cilët gjithashtu ruajnë të drejtën e vendimmarrjes edhe për numrin e fëmijëve, arsimimin e tyre, migrimin ose emigrimin e familjes apo të një anëtarë të saj, sikurse dhe martesën e fëmijëve, kur kjo bëhet e kombinuar. Gratë më shumë luajnë rol informues apo këshillues lidhur me nevojën e blerjes së një ushqimi të caktuar apo këshillojnë shitjen e një produkti të vetëprodhuar⁵.

1.1.2. Situata ekonomike, pabarazia në varfëri si dhe pabarazia në forcat e punës.

Të drejtat ekonomike të grave përfaqësohen me nivelin e pjesëmarrjes në forcat e punës, mbajtjen e vendit të punës dhe shpërblimin. Punësimi tek gratë dhe vajzat të shqiptare kufizohet nga një sërë faktorësh si detyrimi dhe përgjegjësia për rritjen e fëmijëve, kryerjen e punëve të shtëpisë, niveli arsimor, aksesit i kufizuar në formin profesional, pronësia dhe mundësia për të përfituar kredi, etj. Gratë dhe vajzat kanë ngritur bizneset e tyre kryesisht në aktivitete ekonomike të tilla si tregti, shitje me shumicë, dyqane, shërbime të ndryshme si dentist, noteri, avokati, parukeri, agro-biznes, industri, prodhimin e bulmetit, tekstil, botime librash, rrobaqepësi dhe punime artizanale. Sipas

⁴ Të dhëna nga MPCSSH. B.

⁵ Konkluzione të nxjerra nga biseda dhe takime të ndryshme të kryera me gratë dhe vajzat.

statistikave të INSTAT, 17 përqind e drejtuesve të biznesit privat janë gra dhe vajza. Numri më i madh i bizneseve të rregjistruara që drejtohen nga gratë dhe vajzat është përqendruar në Tiranë (31%), Durrës (8.7%) dhe Elbasan (6.2%). 85 përqind e këtyre bizneseve të drejtuara prej tyre ndodhen në zonat urbane dhe 15 përqind në zonat rurale.

Kreditë bujqësore, me më shumë lehtësira për gratë do të ndihmonin për një rritje të numrit të grave fermere. Nga dy studime të kryera nga ACER (Qendra Shqiptare për Studime Ekonomike) rezultoi se 78 përqind e kërkesave për huamarrje bëhet nga kryefamiljarë meshkuj ndërsa 5-7 përqind e fermereve (gra) marrin hua nga të afërmit e tyre.

Gratë po bëhen gjithnjë e më të varfëra se burrat. Reforma e thellë ekonomike gjatë tranzicionit, e cila u shoqërua me mbyllje masive të ndërmarrjeve shtetërore jo efektive, e gjeti të papërgatitur individin dhe shoqërinë shqiptare. Pas viteve '90-të, papunësia pësoi rritje drastike. Megjithë përmirësimet në vitet e mëvonshme, papunësia dhe varfëria kërcënojnë një numër jo të vogël familjesh shqiptare. Në mënyrë të veçantë papunësia dhe varfëria po ndikojnë negativisht në statusin social të grave shqiptare. Të dhënat mbi varfërinë në Shqipëri, tregojnë për një feminizim të varfërisë dhe rritje të peshës së grave në grupin e të varfërve. Ndërsa nga viti 2002 në vitin 2005 treguesi absolut⁶ i varfërisë është ulur 27 përqind⁷, reduktimi i varfërisë tek grup-popullatat femra nuk ka qënë i njëjtë. Gjeografikisht kemi rritme më të ulta të reduktimit të varfërisë në këto grup-popullata në zonat rurale, ku përveç shumë faktorëve që prodhojnë varfëri, inferioriteti ekonomik e social i gruas ndikon fuqishëm.

Në një vend si Shqipëria, kultura diskriminuese me bazë gjinore nuk është thjesht një çështje e shkeljes të së drejtave të grave dhe vajzave, por pabarazia gjinore përfaqëson një pengesë serioze në përshpejtimin e reduktimit të varfërisë. Tradicionalisht gratë mbajnë peshën kryesore të mirëqenies në familje megjithatë ato kanë më pak mundësi se burrat në kontrollin e burimeve dhe mjeteve që nevojiten për të përmbushur përgjegjësitë e mësipërme. Niveli i lartë i papunësisë, niveli arsimor i ulët, kryerja e shumë punëve të pakualifikuara, mungesa e mundësive kualifikuese, aksesit i dobët dhe mungesa e lirisë së përdorimit të metodave të planifikimit familiar, të qenit objekt i dhunës, keqtrajtimit apo veprimeve arbitrare brenda familjes, si dhe përfaqësimi i dobët në strukturat publike drejtuese e politike, ndikojnë në thellimin dhe feminizimin e varfërisë në Shqipëri si dhe në për zgjatjen e saj .

Pjesëmarrja e gruas në tregun e punës ra ndjeshëm gjatë viteve të tranzicionit. Kjo shifër në vitin 2005 rezultoi të jetë 46.8 % e forcës aktive⁸. Gratë dhe vajzat në Shqipëri kanë më pak akses se djemë dhe burrat për të filluar një punë, për pasojë niveli i papunësisë tek ato është më i lartë. Megjithëse aksesit i grave dhe vajzave në arsimim është i barabartë me burrat, kjo nuk u siguron grave të njëjtat mundësi në tregun e punës⁹. Situata e punësimit të gruas është më e favorshme në sektorin e administratës publike ku gruaja zë 56 përqind të të punësuarve, ndërsa burrat 44 përqind. Pabarazia është shumë e dukshme në sektorin privat, ku një numër shumë i vogël i grave dhe vajzave, vetëm 17 përqind, arrijnë në nivelin e menaxhereve. Ngjashmërisht me këtë edhe përqindja e biznesit jo-bujqësor të drejtuar nga gratë dhe vajzat është e vogël, vetëm 2 përqind në sektorin e transportit dhe 25 përqind në sektorin e shërbimeve.

⁶ Niveli absolut i varfërisë është 4,891 lekë për person.

⁷ Krahasimi i të dhënave të VSMJ 2002 dhe 2005.

⁸ INSTAT 2006, "Femra dhe Meshkuj 2005"

⁹ INSTAT, Perspektivat gjinore në Shqipëri, Tiranë, 2004

Nëse analizojmë pjesëmarrjen e femrave në popullsinë ekonomikisht jo-aktive,¹⁰ vërejmë se ato përbëjnë 53 përqind. Kjo do të thotë që për çdo 100 femra ekonomikisht aktive, rreth 53 prej tyre janë jo-aktive, ndonëse ky tregues për meshkujt është 2 herë më i ulët ose vetëm 31 përqind. Shkalla e ulët e pjesëmarrjes në forcën e punës shtrihet në të gjitha grupmoshat. Pjesëmarrja e gruas në tregun e punës përbën një nga treguesit kryesorë të fuqizimit ekonomik të saj, si dhe ridimensionon rolin e saj në drejtim të sigurimit të të ardhurave në familje. Megjithatë të dhënat tregojnë që ka pabarazi midis femrave dhe meshkujve në pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës dhe kryesisht kjo vërehet në treguesit statistikorë të burimeve të punës, si dhe në punësim.

Duke iu referuar statistikave të dhëna nga INSTAT për vitin 2005 nga bilanci i forcës së punës, niveli i punësimit është 60 përqind për meshkujt dhe 38.8 përqind për femrat, ndërsa shkalla e papunësisë në shkallë vendi është 14.1 përqind; shifra e papunësisë për meshkujt është 12.1 përqind dhe për femrat është 17.2 përqind, shifra këto që tregojnë se niveli i papunësisë është në përqindje më të lartë tek femrat se tek meshkujt. Të dhënat e të punësuarve në sektorin shtetëror tregojnë se gratë dhe vajzat zënë përqindjen më të lartë të punësimit në profesione të tilla si specialiste apo nëpunëse të thjeshta, pozicione këto më pak të paguara krahasuar me profesione të tilla si ligjvënës, nëpunës dhe drejtues të lartë, politikëbërës, etj, në të cilat shihen kryesisht djemtë dhe burrat si të punësuar. Duke bërë një krahasim të punësimit në dy nivelet, në atë qendror dhe vendor, të dhënat tregojnë se femrat zenë një përqindje më të madhe të punësimit në nivel qendror. Kështu në institucionet e qeverisjes qendrore, 43 përqind e të punësuarve janë femra, ndërsa në administratën vendore kjo shifër rezulton në 30 përqind. Punësimi i femrave shihet kryesisht në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit dhe më pak në sektorë të tjerë si bar-restorante, ndërmarrje prodhuese, tregëti etj.

Shifrat e ulta të punësimit të grave nuk tregojnë realitetin në lidhje me angazhimin e tyre në punë, pasi në këto shifra nuk pasqyrohet roli riprodhues social që ato luajnë në familje, duke filluar nga mirëmbajtja e shtëpisë, gatimi, kujdesi për fëmijët dhe familjarët, etj aktivitete këto që të gjitha të domosdoshme për vazhdimësinë e jetës dhe që cilësohen si punë e papaguar. Po kështu, edhe pse mund të kenë të njëjtin nivel arsimi apo kualifikimi sikurse dhe burrat tek gratë vihet re një vështirësi për mbajtjen e vendit të punës, apo dhe diferencim në shpërblim, për shkak të posteve të punës që ato kanë. Gratë dhe vajzat janë më të rrezikuara për largimin nga puna, apo janë më pak të pëlqyera për t'u punësuar e për t'ju ruajtur vendin e punës, veçanërisht në periudhën e shtatzanisë. Në nivelin e ulët të shpërblimit të grave ndikon gjithashtu edhe pjesëmarrja e vogël e tyre në aktivitete private vetëpunësimi, të cilat sigurojnë të ardhura më të larta se sektori publik. Aksesit i ulët ndaj pronës (vetëm 8 përqind e grave zotërojnë ligjërisht pronë¹¹), si dhe mungesa e politikave favorizuese që nxisin sipërmarrjen private të grave dhe vajzave, ka çuar në një nivel të ulët të numrit të atyre që drejtojnë biznese të vogla, të mesme apo të mëdha. Në vitin 2005 vetëm 17 përqind e bizneseve jo bujqësore drejtoheshin nga gra. Sigurimi i mundësive të barabarta për punësim të shpërblyer ndikon pozitivisht në nxjerrjen e familjes nga varfëria dhe në rritjen e statusit social të grave dhe vajzave brenda familjes. Nga një analizë e faktorëve që ndikojnë në madhësinë e shpërblimit, si grup-mosha, niveli i shkollimit dhe gjinia, kjo e fundit rezulton se ndikon më fuqimisht. Gratë janë ndjeshëm më të defavorizuara nga burrat, me një mesatare të pagës prej 35 përqind më të ulët për të njëjtin nivel arsimor¹². Gjithashtu një analizë më e detajuar sipas degëve të ekonomisë, tregon se paga mesatare mujore neto e burrave është¹³ dukshëm më e lartë se ajo e grave në të gjitha degët e ekonomisë dhe diferenca është më e theksuar për të punësuarit me pagë në sektorin privat jo-bujqësor.

¹⁰ INSTAT 2006, "Femra dhe Meshkuj 2005".

¹¹ Amnesty international: "Albania. Violence against woman in the family. It is not her shame"; 2005

¹² Në përlllogaritjet nuk janë peshuar grup-moshat.

¹³ INSTAT- LSMS 2005

1.1.3. Situata aktuale në lidhje me dallimet gjinore në arsim.

Arsimi është fusha në të cilën ka patur arritje të mira në drejtim të aksesit për femrat dhe meshkujt. Në shkollat nëntëvjeçare raportohet një pjesëmarrje e vajzave në 48 përqind. Në shkollat e mesme pjesëmarrja e vajzave është rreth 45 përqind krahasuar me djemtë (55 përqind). Në arsimin universitar, rregjistrimi i femrave është më lart sesa meshkujt dhe përbën rreth 58.2 përqind.

Po ndërsa përgjithësisht rregjistrimi i vajzave në shkolla është në nivele të konsiderueshme, dukuritë me të cilat përballemi shpesh janë braktisja konkrete e shkollës dhe braktisja e fshehtë e shkollës. Në lidhje me këtë, mund të themi se vihet re një braktisje nga femrat qoftë në vlerë absolute, ashtu edhe në përqindje (nga rreth 217950 vajza të arsimit 9 vjeçar, kanë braktisur shkollën rreth 1.1 përqind gjatë vitit akademik 2005-2006). Infrastruktura ose e shkatërruar ose jo-ekzistente që çon në pasigurinë e udhëtimit, mungesa e mjediseve sanitare (tualetet) dhe mungesa e ujit të pijshëm, janë disa nga faktorët që i detyrojnë vajzat të braktisin shkollën. Ndërsa puna e organizatave jo-fitimprurëse dhe atyre komunitare tregon se numri i vajzave që rrezikohen nga analfabetizmi është i lartë, diferencat në trajtimin e vajzave dhe djemve vihen re dhe në mënyrën e organizimit të orëve mësimore të veçanta (psh. edukimi fizik, ekonomia shtëpiake, etj gjatë të cilave vajzat dhe djemtë ndahen dhe iu nënshtrohen veprimtarive që përforcojnë rolet gjinore). Një sfidë reale për ndjekjen e shkollës janë kostot “joformale” për arsimim, të cilat u japin familjeve të varfëra një ngarkesë financiare që mund të lidhet me mos shkuarjen në shkollë të fëmijëve sidomos në zonat rurale dhe më të varfëra të vendit. Për më tepër, realiteti shoqëror dhe kulturor mbështet konkluzionin se vajzat më shpesh dhe më shpejt se djemtë braktisin shkollën për të kontribuar në ekonominë familjare, apo për t’u martuar në moshë tepër të re.

Në kuadrin e përmirësimit tërësor të kurrikulave shkollore MASH, në bashkëpunim me Institutin e Kurrikulës dhe Standarteve, ka shtruar si kërkesë integrimin e perspektivës gjinore nëpërmjet: (1) Rishikimit dhe hartimit të programeve në arsimin parauniversitar dhe universitar; (2) Rishikimit dhe hartimit të teksteve të reja shkollore; (3) Hartimit të udhëzimeve dhe materialeve metodologjike për integrimin e perspektivës gjinore në kurrikula. Në programet shkollore trajtimi i përkatësisë gjinore ndryshon sipas niveleve. Në arsimin nëntëvjeçar ky trajtim është i papërfillshëm. Në shkollat e mesme, komponenti gjinor prezantohet në lëndët shoqërore si njohuri për shoqërinë, histori dhe letërsi. Në shkollat e larta lëndët mbi çështjet e përkatësisë gjinore ofrohen në programin e Punës Sociale, Psikologjisë, Sociologjisë, Gazetarisë dhe Shkencave Politike në lëndët letërsi, psikologji, politikë sociale, filozofi, e kulturë. Një pjesë e fakulteteve përgatit studentët si specialistë në çështjet e përkatësisë gjinore për të punuar në sektorin publik dhe shoqërinë civile. Përgjithësisht tekstet shkollore të rishikuara kanë përmirësime për të eliminuar stereotipet që edukojnë pabarazinë gjinore, si në shembujt e përzgjedhur, ashtu dhe në psikologjinë që përshkon materialin e përzgjedhur, si dhe detyrat nga aparati pedagogjik. Megjithatë në tekstet e përdorura për të përgatitur mësues, këndvështrimi gjinor pothuaj është fare i pandjeshëm. Për më tepër, në përgatitjen fillestare si mësues, mësuesit hasen me një trajtim të pamjaftueshëm të komponentit gjinor, ndërsa kualifikimi i mësuesve në shërbim (në punë), përgjithësisht përqendrohet në kualifikimin e tyre sipas lëndëve dhe në kualifikimin metodik të mësimdhënies dhe të të nxëniet; komponenti gjinor nuk është pjesë integrale e këtyre kualifikimeve.

Në sistemin, parashkollor, nëntëvjeçar dhe të mesëm përfaqësimi i grave dhe vajzave është i konsiderueshëm. Në arsimin nëntëvjeçar përqindja e femrave vazhdon të rritet si në zonat urbane dhe ato rurale. Në vitin akademik 2005-2006, kjo shifër arriti në 66 përqind. Ndërsa përgjithësisht përqindja e femrave në arsimin e mesëm është më e lartë se ajo e meshkujve, në zonat rurale ato përbëjnë vetëm rreth 43 përqind të stafit pedagogjik. Në nivelin e lartë arsimor pjesëmarrja e grave është e ulët, 49 përqind kundrejt 51 përqind burra, në të gjitha nivelet si në administratë ashtu edhe

si staf pedagogjik. Në drejtoritë dhe zyrat arsimore ka një përfaqësim prej 59 përqind nga burrat dhe 41 përqind gra. Në pozicione drejtuese, 92 përqind drejtorë krahasuar me 8 përqind femra dhe 83 përqind drejtorë të zyrave rajonale krahasuar me 17 përqind drejtore të këtyre zyrave. Megjithëse në nivelin e specialistëve dhe punonjësve ndihmës në këto organizma gratë kanë përqindje më të lartë, ato ende mbeten më poshtë se burrat (48 përqind kundrejt 52 përqind specialistë; 40 përqind kundrejt 60 përqind punonjës ndihmës).

1.1.4. Situata aktuale në lidhje me mbrojtjen sociale.

Reformat politike dhe ekonomike të viteve '90-të u shoqëruan me rritje të numrit të personave të ekspozuar ndaj varfërisë dhe përjashtimit social. Për zbutjen e këtyre pasojave është ndërtuar një sistem i posaçëm i mbrojtjes sociale, i bazuar në programet e (1) sigurimeve shoqërore, (2) ndihmës ekonomike, (3) mbështetjes me të ardhura të personave me aftësi të kufizuar, dhe (4) shërbimeve shoqërore. Vlerësimi i vulnerabilitetit dhe problemeve sociale të individëve (grave/vajzave dhe burrave/ djemve,) shpesh nënkupton përkufizimin e shkallës së përjashtimit të tyre social nga jeta normale e shoqërisë, mungesën e politikave dhe masave për mbrojtjen e të drejtave të tyre, si dhe mungesën e mundësisë për t'i përdorur shërbimet që ekzistojnë në komunitetin e tyre. Renditja e vulnerabilitetit i ka përkufizuar gratë dhe vajzat e papuna si një nga grupet kryesore në rrisht dhe me probleme sociale. Vitet e fundit është rritur numri i grave kryefamiljare, si gratë e veja, të divorcuara ose që i kanë burrat në emigracion. Gratë kryefamiljare përfitojnë ndihmë ekonomike apo pensione familjare, kur bashkëshorti ka qenë i punësuar, si dhe ndihma humanitare dhe shërbime punësimi nga OJF-të. Vetëm për tre mujorin e parë të vitit 2007 mund të renditen këto shifra: numri i grave të papuna rezultoi 7688; trajtohen me pagesë papunësie rreth 1141 gra; me ndihmë ekonomike rreth 5598 gra dhe numri i familjeve me kryefamiljare gra rezultoi 5844¹⁴.

Ndryshimet demografike në Shqipëri kanë sjellë ndryshime në vetë strukturën e familjes shqiptare. Së pari, familjet synojnë të jenë më të vogla se para viteve '90-të, ku familjet me shumë fëmijë ishin më të shpeshta dhe familja e zgjeruar ishte një formë e rëndësishme e mbështetjes sociale dhe ekonomike. Shqipëria karakterizohet nga një profil demografik i cili dallohet nga martesat në moshë të hershme, lindja e fëmijëve në moshë relativisht të re dhe martesa të qëndrueshme. Këto tendenca tani kanë ndryshuar, por fenomene të reja janë prezantuar si probleme sociale në familjen shqiptare. Kështu, gratë si prindër të vetëm janë një fenomen i ri që erdhi si rezultat i emigrimit ndërkombëtar. Gratë e vetmuara kryefamiljare përballojnë sfida tepër të vështira, papunësi dhe mungesë e sistemit të përkujdesjes për fëmijë. Balancimi i rolit të kryefamiljarit dhe të përkujdesit të vetmuar është një detyrë e vështirë e cila kërkon prezencën e skemave të mbrojtjes sociale.

Arësytet për disavantazh social për grupet e grave në nevojë¹⁵ janë: (a) për shkak të papunësisë në vend, një pjesë e madhe e tyre kanë punësim në sektorin privat/informal; (b) për shkak të mbulimit të të dyja përgjegjësive, si të sigurimit të ushqimit edhe atë të përkujdesjes, gratë dhe vajzat punësohen në punë me orare të shkurtuara, që nuk kërkojnë lëvizshmëri apo orare të zgjatura dhe njohuri të avancuara profesionale. Për pasojë, ato kanë paga të ulëta, pasiguri të vendit të punës, mos sigurim shoqëror dhe shëndetësor, janë të mbingarkuara (punë me pagesë në tregun e punës dhe pa pagesë në shtëpi), janë të nënpaguara, janë përkujdesëse të vetme, shpesh siguroese të vetme të ushqimit, janë të konsumuara psikologjikisht, e për rrjedhojë reflektojnë gjithçka dhe tek fëmijët dhe familjet e tyre.

¹⁴ Burimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit / MÇSSH, të dhënat për tre mujorin e parë të vitit 2007.

¹⁵ Termi "gra në nevojë" përfshin: gratë kryefamiljare, të dhunuara, të trafikuar, rome, egjiptjane, me aftësi të kufizuara, nëna me shumë fëmijë, etj.

1.1.5. Situata aktuale në lidhje me kujdesin shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore.

Për Ministrinë e Shëndetësisë, mbrojtja e shëndetit të gruas përbën një prioritet. Për këtë arsye, politikat dhe strategjitë e saj, të mbështetura dhe nga UNFPA si një nga donatorët kryesorë në këtë fushë, e vendosin gruan dhe vajzën në qendër të shërbimeve të shëndetit riprodhues duke synuar të integrojnë këto shërbime në tre nivelet e kujdesit shëndetësor, me prioritet kujdesin shëndetësor parësor. Përmirësimi i vazhdueshëm i shëndetit mbetet një sfidë e madhe si për gratë dhe vajzat ashtu edhe për djemtë dhe burrat. Marrja e një kujdesi shëndetësor cilësor është faktor kyç për mirëqenien, zhvillimin dhe ecurinë e përgjithshme të të gjithë shoqërisë.

Sfida më e madhe në lidhje me paraqitjen e situatës dhe ndërthurjes së çështjeve të barazisë gjinore në shëndetësi qëndron në faktin që ka shumë pak të dhëna të ndara në bazë gjinore, ndaj dhe prezantimi i kësaj situatë mbështetet në raporte të rralla dhe në informacionin e mbledhur në mënyrë jo sistematike, kryesisht nga organizata të ndryshme me bazë komunitare apo jo-fitimprurëse.

Çështjet gjinore në sektorin e shëndetit. Përgjithësisht, theksi i trajtimit të dallimeve dhe çështjeve gjinore vihet në dallimet biologjike, që egzistojnë ndërmjet burrave, djemve si dhe grave dhe vajzave. Por nga ana tjetër është shumë e rëndësishme të kuptohet se në jetën e përditshme gratë, vajzat dhe burrat, djemtë kryejnë veprimtari të ndryshme, janë pjesë e realiteteve jetësore të ndryshme si dhe kanë nevojë dhe ushtrojnë përgjegjësi të ndryshme nga njëri-tjetri. Duke e analizuar në kontekstin e kujdesit shëndetësor, gratë, vajzat dhe burrat, djemtë për shkaqet e sipër përmendura janë të ekspozuar në mënyra të ndryshme ndaj ndërlikimeve shëndetësore. Kjo lidhet jo vetëm me specifika të sëmundjeve dhe ndërlikimeve shëndetësore që janë të ndryshme për të dyja gjinitë, por edhe me hapësirat sociale, ekonomike, kulturore, madje dhe politike, që ndikojnë në mënyra të ndryshme në shëndetin e grave dhe burrave, djemve e vajzave. Është e rëndësishme të theksohet se cilësia e jetesës së individëve duhet parë jo vetëm në perspektivën e ndryshimeve biologjike, por edhe të roleve të ndryshme të caktuara nga shoqëria për ta. Nga ana tjetër këto pabarazi ndërthuren dhe me efektet e formave të tjera të ndarjes sociale si klasa, etnia apo vendndodhja. Duke patur parasysh këtë mund të themi se ka një dallim të ndjeshëm në faktin se si gratë, vajzat dhe burrat, djemtë e grupeve të ndryshme sociale ndikohen nga çështjet e kujdesit shëndetësor. Shërbimet shëndetësore duhet të jenë dinamike, të përshtashme dhe bashkëkohore, që të mund t'iu përgjigjen nevojave të ndryshme të individëve.

Koncepti i barazisë gjinore në sektorin e shëndetësisë ka të bëjë më tepër me drejtësinë në trajtimin shëndetësor të të gjithë individëve, sesa me trajtimin e barabartë. Duke patur në fokus drejtësinë e shpërndarjes dhe të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, është e mundur shmangia dhe zhdukja e disavantazhit në kujdesin shëndetësor të grave/vajzave dhe burrave/djemve. Në 15 vitet e fundit shëndetësia është ndeshur me sfidat për të dhënë shërbime të përshtatshme për meshkujt dhe femrat. Ndërsa theksi më i madh vihet në shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar, çështje të tjera shëndetësore, si shëndeti mendor apo ai në mjedisin e punës lënë për të dëshiruar. Ka shumë pak informacion në lidhje me sëmundjet më të përhapura për femrat dhe meshkujt; ngarkesën e femrave në punë dhe tendencat e sëmundshmërisë të gratë dhe vajzat si keqshqyerja, anemia dhe sëmundje të tjera. Edhe më pak dihet mbi perspektivat e vetë meshkujve dhe femrave në lidhje me rolin që ata/o duhet të luajnë në kujdesin shëndetësor në komunitet, perceptimet e tyre në lidhje me çështjet më të zakonshme të shëndetit, kush vendos në familje se çfarë ilaçesh duhen blerë, etj. Gjithashtu është e vështirë të flitet nëse ka tendenca të ndryshme rritjeje midis vajzave dhe djemve, sëmundjet nga të cilat ata preken më shumë, dhe nëse këto dallime lidhen me trajtimin e ndryshëm të djemve dhe vajzave. Në lidhje me shëndetin riprodhues, duke iu referuar një studimi të UNDP-së

të vitit 2001, Shqipëria ka një indeks nga më të ulët për zhvillimin gjinor, krahasuar me vendet e Europës Lindore.

Gratë dhe vajzat paraqesin një nivel të ulët të njohjes së HIV/AIDS dhe të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, si dhe një kulturë të varfër për shëndetin në përgjithësi dhe për atë riprodhues në veçanti. Më të rrezikuara ndaj këtyre sëmundjeve janë adoleshentet. Një faktor tjetër që paraqet rrezik për infektimin nga SST, është edhe fakti i mungesës së fuqisë së femrave për të negociuar me partnerin për të përdorur prezervativë gjatë marrdhënieve seksuale, si një nga mbrojtësit më të mirë nga HIV.

Kur vjen fjala për planifikimin familjar, vendimet për madhësinë e familjes duhet të merren kryesisht nga të dy bashkëshortët, sipas mendimit të femrave dhe meshkujve në moshën 15-44 vjeç, megjithëse midis burrave, përqindja e atyre që bien dakord është më e ulët se ajo e grave (përafërsisht 96 përqind kundrejt 89 përqind. Nuk ekzistojnë studime që raportojnë për diferenca gjinie në njohuritë dhe qëndrimet në lidhje me vendimet për fertilitetin. Ndërkohë që sipas një studimi të vitit 2002, në fshat dhe në qytet metoda kryesore kontraceptive mbetet tërheqja (në qytet 88 përqind gra kundrejt 92 përqind burra; në fshat, 93 përqind gra kundrejt 99 përqind burra).¹⁶ Megjithatë këto tre vitet e fundit, si rezultat i politikave të Ministrisë së Shëndetësisë për rritjen e cilësisë së shërbimeve të planifikimit familjar dhe zgjerimit të këtyre shërbimeve në zonat rurale, ka një përmirësim të situatës në lidhje me treguesit e përdorimit të metodave moderne të kontracepsionit, ku përqindja është rritur nga 8 përqind që ishte në vitin 2002 në 22 përqind për vitin 2005.¹⁷ Po kështu numri i qendrave shëndetësore publike që ofrojnë shërbime të planifikimit familjar është trefishuar krahasuar me 5 vite më parë. Metodatat e kontracepsionit në këto shërbime ofrohen falas.

Çështjet gjinore në marrjen e informacionit shëndetësor. Marrja e informacionit mbi kujdesin shëndetësor për meshkujt dhe femrat bwhet në shërbimet e publike të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë dhe donatorë, organizata ndërkombëtare si UNFPA, USAID, UNICEF e OJF-të e ndryshme, bazuar në çështjet shqetësuese për momentin dhe në varësi të fondeve të dhuruara nga donatorë të ndryshëm. Ndërsa shkollat e mesme kanë të përfshirë si lëndë të veçantë edukatën seksuale, raporte joformale të nxënësve tregojnë se jo vetëm mësuesët nuk janë gjerësisht të përgatitur për t'iu përgjigjur pyetjeve të nxënësve, por shpeshherë ora e veçantë e lënë për këtë lëndë përdoret për të plotësuar boshllëqet e lëndëve të tjera të shkencave ekzakte. Përçimi i informacionit mund të përshkruhet si jo sistematik. Hartimi i Strategjisë Kombëtare për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së HIV/AIDS në Shqipëri, për vitet 2004-2010, lindi si nevojë e disa faktorëve siç ishin rritja e numrit të rasteve të diagnostikuara, evolimi i sjelljeve të popullsisë, si psh prirja për të patur marrdhënie seksuale në moshë më të re, përdorimi i drogës etj. Ndër pikat e kësaj strategjie është vënia e theksit në rrezikun e prekjes nga HIV/AIDS të grave dhe vajzave në Shqipëri, për arsye të ndryshme.

Çështjet gjinore në sistemin e dhënies së kujdesit shëndetësor. Mungesa e të dhënave në përdorimin e sistemit të dhënies së kujdesit shëndetësor të ndarë sipas gjinisë, si dhe mbi nivelin e tyre të aprovimit të këtyre shërbimeve, e bën të vështirë vlerësimin e situatës. Është vënë re se gratë kanë më pak kohë dhe mundësi se burrat për të shkuar te mjeku si pasojë e ngarkesës së madhe që ato kanë me punët shtëpiake dhe përkujdesjen për anëtarët e familjes. Por roli i burrave si fitues kryesorë të të ardhurave në familje, ushtron një presion të madh mbi to për të pranuar faktin e të qenit sëmurë, pasi pasojat ekonomike dhe ato sociale për familjen do të ishin të ndjeshme. Përveç

¹⁶ Përshkrimi i situatës në këtë çështje i referohet të dhënave nga Anketimi për Shëndetin Riprodhues 2002.

¹⁷ Studim i INSTAT dhe UNICEF MICS 2005

këtyre faktorëve, për gratë dhe vajzat në zonat e largëta dhe rurale, distanca nga spitalet apo qendrat shëndetësore, mungesa e parave për transport, kufizimet e grave dhe vajzave për të lëvizur të pashoqëruara, cilësia e kujdesit të ofruar veçanërisht në disa qendra shëndetësore në zonat rurale, mund të pengojë marrjen e duhur të këtyre shërbimeve. Shpesh ato mbështeten në njohuritë lokale të transmetuara nëpër breza dhe raste të lindjeve në shtëpi, sidomos në zonat e largëta, raportohen shpesh. Gratë dhe vajzat, sidomos në zonat rurale dhe të largëta, kanë vështirësi në pasjen e shërbimeve shoqëruese të shëndetit si furnizimi me ujë dhe shërbimet sanitare. Uji i pijshëm dhe tualetet në shumë prej këtyre zonave shpesh janë të lokalizuara jashtë banesave të tyre. Reforma e Kujdesit Shëndetësor Parësor e filluar nga Ministria e Shëndetësisë do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së punës së këtyre shërbimeve të ofruara nga Qendrat Shëndetësore, ku në paketën e shërbimeve që do të ofrojnë këto qendra, prioritet do të kenë shërbimet e shëndetit riprodhues, si dhe shëndetit të nënës dhe fëmijës.

1.1.6. Situata e aktuale në lidhje me përfaqësimin dhe prezantimin e gruas në media.

Media shqiptare pasqyron fare pak ose aspak problemet që shqetësojnë gruan shqiptare, të tilla si mundësia për arsimim, punësim, problemet e dhunës në familje, ngacmimeve seksuale, etj edhe kur këto fenomene bëhen pjesë e debatit publik.

Karakterizimi i figurës së femrës shpesh shoqërohet me leksik joetik, fyes dhe denigrues. Ndodh që publikimi i ngjarjeve reale bëhet nën dritën e paragjyimit dhe ngjarjet pasqyrohen nën ndikimin e stereotipeve negative. Figura e femrës, në më të shumtën e rasteve, paraqitet në pozicionin e viktimës dhe rrallë ndodh që ajo të paraqitet si një individ që kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, jo vetëm për hir të përqindjes që zë në raport me popullsinë por, veçanërisht për vlerat që ajo mbart.

Stereotipet tradicionale për gruan, aplikohen dukshëm në media, ku figura e kësaj pjese të shoqërisë paraqitet si e varur ekonomikisht dhe emocionalisht, e dobët, e pazonja profesionalisht, nga njëra anë dhe nga ana tjetër, shtëpiake e përkushtuar, familjare, nënë e bashkëshorte e denjë. Vihet re një tendencë e medias që, kur nevojitet përdorimi i burimeve apo prononcimeve dhe opinioneve të figurave të fusha të ndryshme, iu referohet meshkujve, veçanërisht në fushën e politikës, ekonomisë, sportit, etj. Dhe zëri i gruas profesioniste zë fare pak vend dhe citohet shumë rrallë nga media.

Pasqyrimi i roleve gjinore. Nga monitorimi disa mujor i medias vizive kombëtare dhe lokale në vitin 2006, rezulton se: në TVSH gruaja dhe problematika e saj zë 7 përqind; në TV Klan 10 përqind; Top Channel 5 përqind; News 24 4 përqind; TV Koha 5 përqind; TV Alsat 5 përqind. Gjithsej, në programacionin e mediave vizive gruaja zë 7.8 përqind¹⁸. Nga monitorimi i 15 titujve më të shitur të medias së shkruar në datat 13/09/06 - 20/09/06, rezulton se: Politika - Në këtë rubrikë opinioni i grave politikane apo i analistëve për pjesëmarrjen e grave në politikë zë vetëm 6 -7 përqind; Ekonomia - Kjo është rubrika e cila dominohet pothuaj nga burrat dhe ku zëri i ekonomisteve gra zë vetëm 1-2 përqind; Sociale - 10-12 përqind të hapësirës në këtë rubrikë e zë gruaja, ku në 80 përqind të rasteve figura e saj paraqitet kryesisht në pozicionin e viktimës nga dukuri të tilla si dhuna në famije, kriminaliteti dhe prostitucioni; Kulturë-Sport - konstatohet se kjo është rubrika më e “balancuar” për sa i përket vendit që zë problematika e gruas, e cila shkon rreth 20-25 përqind. Por, në këtë rubrikë vëmendja e medias përqendrohet kryesisht në thashethemet erotike rreth femrave që i përkasin botës së artit, kulturës e sportit, ku 90 përqind e zë trajtimi i pamjes së jashtme të tyre, si dhe seksualitetit femëror, nudizmit, joshjes; Opinione-Intervista - Në këtë rubrikë 8-10 përqind e zënë opinionistet gra, dhe vetëm 2-3 përqind e këtyre opinioneve apo intervistave kanë në qendër të tyre trajtimin e problematikës gjinore.

¹⁸ Monitorim i kryer nga vetë grupi punës gjatë hartimit të Strategjisë.

Raporti gazetarë/gazetare në media. Problematike për median shqiptare mbetet jo vetëm pasqyrimi në të i realitetit maskilist të shoqërisë dhe i deformimit të roleveve gjinore, por edhe fakti që realiteti shqiptar gjen pasqyrim në vetë strukturën e ndërtimit dhe funksionimit të medias. Kështu, ende raporti gazetar/gazetare është dukshëm në favor të të parëve dhe sa më lart të ngjitesh në hierarkinë e drejtimit të medias aq më i madh është ky raport.

Nga një sondazh i vitit 2006 rezulton se, raporti gazetarë/gazetarë socialë është 55 përqind /45 përqind; kulturë-sport 45 përqind /55 përqind; politike 35 përqind /65 përqind; ekonomi 40 përqind /60 përqind, analistë 8 përqind /92 përqind në favor të meshkujve. Në total, përqindja e femrave që punojnë si gazetarë në median e shkruar është rreth 40 përqind, ndërsa në median vizive ato përfaqësojnë 60 përqind si prezantuese, 68 përqind si reportere.

Gazetarët femra ngarkohen të trajtojnë tema sociale, për mjedisin, edukimin dhe kohët e fundit, kanë filluar të ndryshojnë raportet në favor të tyre edhe në fushën politike, por ky raport gjithsesi vazhdon të ketë vlera të ulta kur flitet për fushën ndërkombëtare ose analizën politike, të cilat vazhdojnë të mbeten pronë e meshkujve.

Një tjetër problem shqetësues që shfaq tregu mediatik shqiptar është puna e zezë e gazetarëve. Shumica e tyre punojnë pa kontrata pune dhe janë të pasiguruar. Sipas një studimi të Ministrisë së Punës (2003): 75 përqind e gazetarëve nuk kanë kontrata pune; ndërsa në prill të vitit 2006 Sindikata e Gazetarëve të Shqipërisë deklaronte se ky numër arrin 90 përqind.

Gazetarët e terrenit rezultojnë më të diskriminuarit dhe të pambrojturit dhe është e kuptueshme se ata që nuk arrijnë të mbrojnë dhe të përfaqësojnë të drejtat e tyre, se sa do të jenë në gjendje të pasqyrojnë dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e një shoqërie apo grupi të caktuar shoqëror.

1.1.7. Situata aktuale në lidhje me dhunën në familje

Sipas legjislacionit shqiptar “Dhunë në familje” është çdo veprim apo mosveprim i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik. Dhuna në familje është krim që shpesh është i fshehur. Në shoqërinë shqiptare ajo është parë si një çështje private, me pak ose aspak vëmendje për parandalim, kryesisht nga organizata të ndryshme joqeveritare.

Megjithëse jo shumë sistematike, studime të ndryshme tregojnë se dhuna në familje është gjerësisht e pranishme në shoqërinë shqiptare. Ajo nuk njihet sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike apo fetare, gjendjes ekonomike, paaftësisë, ose gjeografisë, por në shumicën e rasteve të raportuara gratë dhe vajzat janë viktime. Kështu, vlerësohet se një e treta e grave dhe vajzave shqiptare përjetojnë një formë dhune brenda familjes. Ato rrihen, goditen, në disa raste edhe rrëmbehen e trafikohen për qëllime shfrytëzimi nga familjarët e tyre. Vrojtmet e dhjetë viteve të fundit tregojnë se mbi një të katërtat e grave dhe vajzave raportojnë të jenë bërë viktime të dhunës emocionale dhe seksuale, dhe se gratë rurale janë rëndom më të prekuara nga dhuna fizike (shih Refleksione, 1995, 1996; Bregu & Gjermani, 2003, Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2006). Në 2004 Qendra e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat raporton se ka patur rreth 6670 thirrje telefonike nga gratë dhe vajzat e dhunuara. Sipas shifrave të Ministrisë së Brendshme për rastet e dhunës në familje për vitin 2005, në bazë të evidentimit të ngjarjeve kriminale rezultojnë 102 raste të tilla, nga të cilat 21 janë raste vrasjeje, ndërsa 25 të tjera janë kërcënuar me vrasje. Për më tepër, fëmijët janë gjithashtu viktime të dhunës. Studimi i 2006 mbështetur nga UNICEF tregon se 1 në 5 fëmijë ka përjetuar marrje mendsh, 1 në 14 fëmijë ka provuar të fikët dhe 1 në 4 ka provuar mavijosje dhe gjakosje për shkak të goditjeve.¹⁹

¹⁹ Tamo & Karaj, 2006

1. 1.7.1 Nismat e ndërmarrja dhe problemet në parandalimin e dhunës në familje

Parandalimi i dhunës në familje është një çështje komplekse që kryesisht është zhvilluar si rrjedhojë e veprimtarisë së organizatave joqeveritare. Në kuadrin e parandalimit është thelbësore që çdokush i prekur nga dhuna në familje të ketë akses në informacionin dhe këshillimin si dhe profesionistët të dinë se si t'i përgjigjen shenjave të hershme të abuzimit.

Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë. Ndër format e parandalimit, një vend të rëndësishëm zënë veçanërisht ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë nëpërmjet fushatave mediatike, ndryshimi i qëndrimeve të publikut, sidomos të rinjve, dhënia e shpejtë e ndihmës për viktimat për të parandaluar përsëritjen e rasteve, këshillimi se ku mund të sigurohet ndihma ligjore apo sociale, dhe ndalimi i dhunuesve që këta të mos përsërisin rastet e dhunshme. Pak është bërë në të gjitha këto drejtime. Kështu ka studime të pakta, kryesisht nga OJF-të në lidhje me shpeshtësinë dhe shkallën e përhapjes së dhunës në familje. Nuk ekziston një bankë të dhënash apo qendra informimi për publikun e gjerë dhe për viktimat. Për më tepër, përtej sensacionalizmit të dukurisë së dhunës në familje, mediat, rrallëherë ndihmojnë në trajtimin e kësaj dukurie.

Edukimi i fëmijëve dhe të rinjve. Sistemi arsimor është evidentuar si tejet i rëndësishëm në ndryshimin e qëndrimeve të brezit të ri. Analiza e aktivitetit në kurtw fushw tregon se në sektorin e kurrikulave në MASH nuk ka politika të qarta për krijimin e një modeli të organizuar, që të orientojë specialistët e kurrikulës dhe teksteve shkollore për trajtimin e problemit të dhunës në familje. Trajtimi i dhunës në familje jepet si rekomandim për t'u zbatuar në shkolla, por asnjë program shkollor nuk ka të vendosura njohuritë për dhunën (si abuzimi i fëmijëve dhe incesti, abuzimi ndaj të moshuarve, abuzimi fizik/emocional, abuzimi seksual) si pjesë të njohurive të përgjithshme. Për më tej, standartet e kurrikulave nuk formulojnë praktika në klasë që i ndihmojnë mësuesit të japin njohuritë, aftësitë dhe sjelljet e nevojshme për nxënësit që të dinë të dallojnë dhunën dhe të reagojnë ndaj saj. Në sistemin parashkollor, dukuria e dhunës në familje trajtohet më shumë se në çdo nivel tjetër nëpërmjet marrëdhënieve stimuluese pozitive, respektimit të ndjenjave, ideve, vendimmarrjes së politikave në grup, përfaqësimi me prindërit, pushtetin lokal, mësuesi, përfshirja e veprimtarisë njohëse edukative në trekëndëshin e marrëdhënieve mësues, prindër, fëmijë dhe në të gjithë filozofinë e tij të edukimit. Kështu për shembull, standarti 1 përkufizon që edukimi i hershëm i fëmijës stimulon zhvillimin optimal të fëmijës duke u mbështetur në marrëdhënie pozitive me të rriturit, në vend që t'i zgjidhin problemet me anë të forcës. Dhuna e ushtruar te fëmija identifikohet, adresohet, trajtohet nga punonjësi social, edukatori, prindi, por nuk dalin të qarta institucionet dhe shërbimet e specializuara që i ofrohen fëmijës dhe roli i psikologut dhe punonjësit social nuk është shumë i përfshirë në veprimtarinë edukative dhe filozofinë e edukimit.

Veprimtaritë ekstrakurrikulare bëhen mbi bazën e materialeve të pasura me trajtimin e të drejtave të fëmijëve dhe integrimin në strukturat politike ndërkombëtare. Dhuna në familje shihet si një e drejtë e përgjithshme e trajtuar në kuadrin e Konventës së të Drejtave të Fëmijës, problemeve të konflikteve, tolerancës, integritit social, por jo si veprimtari specifike për integrimin e fëmijëve të abuzuar nga dhuna. Botimet e Institutit të Kurrikulave dhe Standarteve me literaturë për të drejtat e fëmijëve, me libër nxënësi dhe mësuesi, seritë e librave “Toleranca pragu i dijes”, “Veprimtari ekstrakurrikulare “ për klasat 1- 12 trajtojnë në mënyrë të plotë dhe në vazhdimësi edukimin e nxënësit me normat e reja të qytetarisë. Në veprimtaritë e organizuara sipas udhëzimeve fëmija aftësohet të njohë rrezikun dhe të mbrohet prej tij, aftësohet të jetë tolerant e të gjejë rrugën e duhur për zgjidhjen e konfliktit duke shmangur dhunën, por dhe këtu koncepti i dhunës në familje lihet si problematikë alternative e temave që do të trajtojnë mësuesi. Veprimtaritë edukative nuk kanë programe integruese për fëmijët të abuzuar nga dhuna në familje. Planet edukative nuk kanë objektiva të vlerësuara nga psikologu apo punonjësi social.

Sfida më e madhe në këtë fushë është se tekstet që përdoren në shkollat tona hartohen nga autorë të pavarur të cilët nuk kanë kualifikimin e duhur për të punuar me standartet dhe programet. Trajtimi i temave për dhunën në familje nuk është objektiv i mirëfilltë i autorëve të teksteve. Shtëpitë botuese punojnë të pavarura nga institucionet që hartojnë standartet dhe programet, kështu që krijohet një hendek në trajtimin cilësor të objektivave. Në sistemin e arsimit të detyruar 9 vjeçar, niveli i marrjes së njohurive nga tekstet e edukatës shoqërore (tekstet bazë) nuk e shpreh drejtpërdrejt dhunën në familje. Familja trajtohet akoma si një mit i mirëkuptimit dhe dashurisë njerëzore. Në tekstet e reja të hartuara sipas kërkesave të standarteve dhe objektivave të programeve ka trajtime të reja të koncepteve për familjen, ndarjes së punëve në familje, respektimin e të moshuarve, pranimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në grupet e tyre sociale, marrjen e përgjegjësive dhe respektimin e të drejtave të tyre. Nëpërmjet veprimtarive dhe ushtrimeve nxënësi aftësohet të përdorë mirëkuptimin dhe tolerancën në zgjidhjen e situatave problematike e konflikteve. Në shkollat e mesme dhuna në familje trajtohet në kuadrin e njohurive që merren për familjen, por jo si një grupim temash. Jepen konceptet e familjes, jeta brenda saj, dhuna në familje si dhe ekspozimi i saj ndaj dukurive negative të shoqërisë së hapur, si prostitucioni, pornografia, trafikimi, por nuk i jepen nxënësit njohuri dhe informacion si një individ për t'u përgatitur për jetën në familje dhe zgjidhjen e problematikave brenda këtij grupimi të rëndësishëm social. Në të gjithë sistemin e shkollave, si ato të përgjithshme dhe të profilizuara përfshirë edhe shkollat e profilit të mësuesisë ndjehet nevoja e futjes së literaturës shtesë e referuese për problemet e dhunës në familje.

Kualifikimi i personelit në shkolla gjithashtu lë për të dëshiruar. Mësuesit në përgjithësi janë të mbingarkuar me detyrime të shumta dhe nuk kanë në kontratat e punës klauzola të veçanta për trajtimin e dhunës në familje në veprimtaritë jashtë normës mësimore. Mësuesit shpesh kanë defekte në komunikim dhe përdorin dhunë verbale ndaj fëmijëve. Për më tepër nuk ekziston një kod i miratuar i etikës në marrëdhëniet me fëmijët. MASH nuk e ka si objekt parësor të politikës së saj krijimin e një sistemi unik për trajtimin e fëmijëve të abuzuar nga dhuna në familje. Ajo nuk parashikon kualifikimin e administratës së arsimit për problemet e dhunës në familje dhe nuk ka projekte të vlerësimit të situatës e hartimit të propozimeve për pilotim lokal apo kombëtar. QKTA nuk ka programe trainimi për dhunë në familje sepse kjo dukuri nuk është trajtuar si objektiv i punës së tyre. QKAVP nuk ka një rrjet të dhënash për dhunën në familje, sepse ky problem nuk është trajtuar si objekt i studimeve dhe veprimeve të këtij institucioni. Shërbimi i tyre është përqëndruar në trajnimin e inspektorëve të DRA, mësuesve të periferisë së rrethëve të ndryshme të vendit. Shërbime alternative të ofruara nga shoqatat nuk janë të koordinuara dhe të përhapura me një efektivitet sipas zonave të rëndësishme, dhe veprimtaria e tyre shpesh kufizohet nga mungesa financiare.

Tradicionalisht, shkolla nuk është parë në tërësinë e saj si një institucion i edukimit, por anon më shumë nga procesi i pajisjes së nxënësve me njohuri mësimore. Si e tillë, drejtorja dhe bordi i shkollës nuk e trajtojnë me përparësi dhunën në familje, në veprimtaritë edukative dhe shërbimet që ofron shkolla. Planet e veprimtarive vjetore të punës edukative në shkolla për dhunën në familje nuk shihen si prioritete apo të trajtohen si një detyrim për t'u zbatuar nga mësuesit në procesin mësimor edukativ 2 orë në vit. Ndihma e tyre bëhet e dukshme vetëm në situatat ekstreme, kryesisht në forma këshillimi individual të shkëputura, ndihma ekonomike, apo partneriteti mes nxënësve. Drejtorja e shkollës nuk ka një protokoll të paraqitjes së situatës për rastet e fëmijëve të dhunuar. Aktualisht shkollës i kërkohet të marrë përgjegjësi për shërbimet që ofron, por asaj i mungojnë kapacitetet njerëzore. Në bazë të SKZHAP shkolla nuk mbështetet me legjislacionin e duhur për manaxhimin e fondeve dhe pjesëmarrjen e komunitetit në hartimin e politikave për të përmirësuar shërbimet që ajo ofron, kështu që shkolla punon me rekomandimet që i dërgon MASH.

Rojet, shërbimi sanitar nuk kanë trajnime për të vëzhguar sjelljen e mbrojtjen në mjedise të tjera të shkollës të fëmijëve viktime të dhunës.

Dhënia e ndihmës me fokus parandalimin. Një ndër sfidat e shëndetit publik shqiptar është adresimi i dhunës brenda familjes si çështje e shëndetit publik.²⁰ Përveç dëmtimeve fizike dhe traumës së menjëhershme të shkatuar nga abuzimi, dhuna në familje kontribuon në një numër problemesh shëndetësore kronike, duke përfshirë depresionin, abuzimin me alkool dhe substanca të tjera, dhe shpesh kufizon aftësinë e vajzave dhe grave për të menaxhuar sëmundje të tjera kronike si diabeti apo hipertensioni. Megjithëkëtë, pak përpjekje janë bërë për të përmirësuar përgjigjen e kujdesit shëndetësor ndaj dhunës në familje nëpërmjet politikave publike, edukimit shëndetësor dhe përpjekjeve parandaluese. Ekziston një hendek kritik në dhënien e kujdesit për individët e dhunuar. Shumë punonjës të shëndetësisë i nxjerrin nga spitali apo qendra shëndetësore individët e dhunuar duke evidentuar vetëm dëmtimet që duhen kuruar dhe duke i dërguar kështu në shtëpi, në të njëjtën situatë të dëmshme që ishte shkaku fillestar i dëmtimeve. Kjo ndodh sepse punonjësit e shëndetit kanë mungesë të theksuar trainimesh dhe mbështetje për të identifikuar si duhet, trajtuar apo referuar individët viktimë të dhunës në familje.

Sipas modelit tradicional të shërbimit shëndetësor shqiptar, mjekët nuk kanë detyrimin ligjor të pyesin pacientët dhe të shënojnë në regjistrat e pacientëve shkakun e dëmtimeve, plagosjeve, frakturave që ata/ato paraqesin. Si rezultat, mjekët kurojnë “simptomën fizike”, ndërsa dhuna që fshihet pas kësaj simptome mbetet përherë “e patrajtuar” e si rezultat e paadresuar. Vetëm 13% e ofruesve të shëndetit pohojnë se i dokumentojnë rastet e dhunës, nga të cilët vetëm 4% shprehen se dokumentojnë jo vetëm rastin por edhe shkakun e dhunës. Pra, regjistrimet që u bëhen pacientëve lidhen vetëm me protokollimin e diagnozës dhe të dhënave personale. Shkak për këtë, përveç mungesës së detyrimit me ligj për të dokumentuar rastet e dhunës, mungesës së protokollit të qartë dhe mungesës së njohurive mbi vlerat e dokumentimit, është edhe mungesa e shprehive të qarta dhe profesionale për ta trajtuar këtë çështje delikate me pacientin pa e vënë në rrezik atë (SHKPS, 2006).

Punonjësve të shëndetësisë u mungojnë ndërgjegjësimi dhe shprehitë bazë për të kapërcyer barrierat personale ndaj çështjes së dhunës në familje. Sipas një studimi të Shoqatës Kombëtare të Punonjësve Sociale (2006), që përfshin rrethet Dibër, Shkodër, Pogradec, Tiranë dhe Vlorë, ofruesit e shëndetësisë janë të paqartë në lidhje me qëndrimin ndaj dhunës me bazë gjinore. Të pyetur me shkrim, 37% e tyre e quajnë dhunën një çështje të brendshme të familjes, ndërsa në diskutime të hapura ata e kundërshtojnë këtë, duke e konsideruar atë si çështje të të gjithë shoqërisë (SHKPS, 2006). Në Kodin e Deontologjisë Mjekësore (Kalaj, 2001) ndër Detyrat e Përgjithshme të Mjekut, në nenin 8 citohet “...nëse mjeku konstaton se personi (me heqje lirie) ka pasur keqtrajtim, pas miratimit të këtij fakti nga i interesuari, mjeku duhet të informojë autoritetet ligjore”. Ndërsa ndër Detyrat ndaj të Sëmurëve, në po këtë Kod, në nenin 43 citohet “Kur gjatë vizitës konstaton se fëmija është keqtrajtuar, ai duhet të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës. Këtë ai duhet ta kryejë me kujdes e maturi, por nëse e gjykon të arsyeshme sidomos për fëmijët nën moshën 15 vjeç, ai duhet të njoftojë autoritetet kompetente”. Në këtë Kod nuk parashikohet si detyrë e mjekut trajtimi i vecantë i pacientëve /viktimë të dhunës në familje. Edhe në rastin e sipërpërmendur të keqtrajtimit të fëmijëve nuk specifikohet keqtrajtimi nga anëtarët e familjes e për më tepër, mbetet “në dorën/ gjykimin e mjekut” e nuk shihet si detyrim raportimi i viktimave në autoritetet kompetente. Akoma më shumë, nuk përcaktohen qartë “autoritetet kompetente”.

1.1.7.2 Nismat e Ndërmarrja dhe Problemet në Drejtësi dhe Mbrojtje

Në procesin e demokratizimit të jetës familjare dhe shoqërore, një rol të rëndësishëm luan sistemi ligjor dhe ai i drejtësisë me qëllim që t’u ofrohet familjeve mbështetja e nevojshme, për të parandaluar dhe mbrojtur nga keqtrajtimi anëtarët e saj si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e saj.

²⁰ Strategjia Afatgjatë e Zhvillimit të Sistemit Shëndetësor, 2004.

Siguria e të gjithë anëtarëve të familjes *duhet të jetë prioritet* i veprimtarisë së gjykatës, i menaxhimit të rastit, i veprimtarisë së prokurorisë, veprimtarisë së avokatit, policisë, etj.

Kuadri ligjor i plotë ose jo i tillë, organet që formojnë sistemin e drejtësisë, me pengesat, (mos)koordinimet, strukturat, mentalitetet që ekzistojnë brenda tyre, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe indirekte jetën e shumë viktimave dhe dhunuesve. Arritja e standardeve të paanësisë, pavarësisë dhe profesionalizmit në sistemin e drejtësisë shqiptare, ku “pushteti” i kujtdo qoftë varet vetëm nga sa ligji të jep pushtet dhe të drejtë, ku i jepet fund (ri)sakrifikimit dhe (ri)viktimizimit të viktimave të dhunës në familje, është një detyrim ligjor, mision moral e kontribut qytetar i këtij sistemi, në mënyrë që të mbrohen të drejtat e asaj kategorie që i janë cënuar padrejtësisht.

“Analiza e sistemit të drejtësisë tregon se besimi i publikut në Shqipëri për këtë sistem është i ulët”²¹. Pra, reformat në sistemin e drejtësisë, atë ligjor dhe më gjerë, ende nuk i kanë siguruar publikut shërbimin e atij standardi që ky i fundit kërkon prej sistemit ligjor dhe gjyqësor në vendin tonë. Kur dhuna në familje përforcohet nga pasiguria për shkak të mungesës së ligjit ose qëndrimeve të sistemit të drejtësisë edhe shpresat për restaurim dhe demokraci shuhën. Shkallëzimi i dhunës brenda familjes shqiptare deri në marrjen e jetës së njerëzve të afërt, apo deri në çuarjen e tyre në vetëvrasje është bërë me të vërtetë dukuri shqetësuese²² për të gjithë shoqërinë dhe veçanërisht për organet e zbatimit të ligjit.

1.1.7.2.1 Përmbledhje e gjetjeve kryesore nga analiza e kuadrit ligjor

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit dhe ndalimin e diskriminimit. Gjithashtu ajo parashikon mbrojtje të veçantë të familjes, fëmijëve, të rinjve, grave shtatzëna dhe nënave të reja. Po ashtu, instrumenta të rëndësishme ndërkombëtare, të ratifikuara nga vendi ynë, si Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Mizor, Çnjerëzor a Degradues vendosin detyrime mbi shtetin shqiptar për përmbushjen e disa standardeve, duke iu ofruar individëve (edhe brenda familjes) mbrojtje të përshtatshme nga dhuna. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për një sërë konventash të Këshillit të Europës.

Megjithatë, kuadri ligjor për dhunën në familje paraqitet ende i paplotësuar:

Kodi Penal:

- ✦ Mungon dhuna në familje si rrethane cilësuese (specifike) në vepra të veçanta, si marrëdhëniet seksuale me dhunë, rrahja dhe veprat e tjera të dhunshme, vrasja, plagosjet, fyerja, etj.
- ✦ Mungojnë dispozita për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi por edhe neglizhenca e anëtarëve të familjes.
- ✦ Mungojnë disa dispozita që ndalojnë/ndëshkojnë vendosjen e fëmijëve në situata të tilla ku ata mund të bëhen dëshmitarë të dhunës (gjë që ndonëse tërthorazi, i dëmton mjaft ata në zhvillimin e tyre normal dhe në mirëqenien fizike e psikologjike)
- ✦ Politikat e dënimit nuk kanë ashpërsinë e duhur ndaj dhunës në familje. Gjithashtu, nuk parashikohen disa dënime alternative që janë më të përshtatshme për rastet e dhunës në familje.
- ✦ Nuk ka parashikime të veçanta për mbrojtjen e familjarëve të moshuar nga dhuna, abuzimi dhe neglizhimi.

²¹ Analizë e sistemit ligjor në Shqipëri, Tiranë: OSBE, 2004.

²² (fq32,39 QNLQ “për një zbatim sa më të mirë të ligjit...”).

Kodi i Procedures Penale

- ✦ Ndjekjen e disa veprave penale, Kodi i Procedurës Penale e lidh vetëm me nismën e viktimës, duke krijuar përshtypjen dhe duke dhënë mesazhin e gabuar se dhuna në familje nuk është aq e rëndësishme sa shteti të investohet vetë (kryesisht) por është një çështje private mes palëve.
- ✦ Gjithashtu KPP nuk ndjek politikën e mospushimit të çështjes kur ankuesi tërhiqet nga procesi. Duke qenë se në rastet e dhunës në familje ndodh rëndom që viktima të tërheqë kallëzimin nga frika dhe presionet, KPP duhet të parashikojë dispozita që lejojnë prokurorin të vazhdojë ndjekjen penale edhe kur viktima tërhiqet në rastet e dhunës në familje.
- ✦ Po kështu, duhen riparë dhe sqaruar më mirë dispozitat që rregullojnë dhe koordinojnë ngritjen e padisë civile brenda procesit penal.

Kodi Civil

- ✦ Nuk bën parashikime të veçanta për rastet e dhunës në familje që t'i sigurojnë viktimës mundësi efektive për shpërblimin e saj për dëmin moral dhe material të pësuar.

Kodi i Familjes

- ✦ Neni 62 i Kodit të Familjes krijon mundësinë e largimit nga banesa të bashkëshortit dhunues, duke nënkuptuar vetëm dhunën mes bashkëshortëve dhe jo edhe dhunën ndaj pjesëtarëve të tjerë të familjes. Deri me tani kjo dispozitë ka qenë e pashoqëruar me dispozita të nevojshme procedurale që të rregullonin mënyrën se si do të merrej kjo masë, kohëzgjatjen e saj, etj, por këto mangësi po adresohen nga ligji i ri për dhunën në marrëdhëniet familjare.
- ✦ Mungojnë procedura të veçanta dhe më të thjeshtuara për zgjidhjen e martesës për shkaqe të dhunës.
- ✦ Po ashtu, nuk ka rregullim të veçantë për pasojat që mund të sjellë dhuna në familje për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, lënien e fëmijës njërit prind për rritje dhe edukim, të drejtën e vizitës apo të banimit, etj.

1.1.7.2.2 Përmbledhje e gjetjeve kryesore nga analiza e sistemit të drejtësisë

Pushteti gjyqësor²³

Nga analiza e roleve, përgjegjësisë dhe funksionimit të gjyqësorit, problemet e evidentuara më poshtë janë më të rëndësishmet për dhunën në familje:

- ✦ Ndonëse ekzistojnë mundësitë kushtetuese, në Shqipëri ende nuk është krijuar një gjykatë e specializuar për të miturit, por me dekretin Nr. 5351 dt.11.06.2007 të Presidentit janë krijuar Seksione të veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore.
- ✦ Gjyqtarët shqiptarë kanë kompetencë të shqyrtojnë të gjitha çështjet penale, civile, administrative, tregtare, familjare si dhe çdo çështje tjetër të përcaktuar më ligj. Megjithatë është me rëndësi ndarja e brendshme në gjykata dhe specializimi i gjyqtarëve të veçantë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
- ✦ Ka një besim të kufizuar të publikut të veprimtaria dhe autoriteti i gjyqësorit. Nuk kanë munguar akuzat për korrupsion, zvarritje të gjykimeve, jotransparence, mungesë profesionalizmi të gjyqtarëve etj.

²³ Ligji nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor Republikën e Shqipërisë”

- ✦ Punonjësve të administratës së gjyqësorit u mungojnë trajnimet e posaçme për pritjen, orientimin dhe trajtimin e viktimave të dhunës në familje.
- ✦ Qytetarët nuk janë të mirëinformuar për mënyrën e funksionimit të pushtetit gjyqësor dhe të drejtat e tyre. Kështu, në vend që t'i drejtohen gjykatës, ata e paraqesin ankesën e tyre në Ministrinë e Drejtësisë, duke humbur kështu edhe afatet e ankimit në një organ më të lartë gjyqësor. Gjithashtu mungojnë formularët e gatshëm dhe të thjeshtë që mund të lehtësojnë aksesin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.
- ✦ Mungojne statistikat e qarta, të hollësishme ose të besueshme që vijnë nga gjyqësori lidhur me rastet e dhunës në familje në përgjithësi dhe asaj të ushtruar ndaj/prej fëmijëve, ndaj/prej të moshuarve dhe grave. Mungon edhe një sistem i unifikuar i raportimit të statistikave që duhet të permbajnë të dhënat e mëposhtme:
- ✦ Numrin e rasteve të dhunës në familje të paraqitur përpara gjykatës dhe numrin e vendimeve të dhëna në gjykata lidhur me to.
- ✦ Kohën mesatare për trajtimin e rastit deri në vendimin përfundimtar.
- ✦ Ekzekutimin ose jo të vendimit.
- ✦ Numrin e gjyqtarëve të trajnuar mbi dhunën në familje, etikën, të drejtat e njeriut, menaxhimin e rastit të dhunës, etj.
- ✦ Numrin e stafit administrativ të trajnuar.
- ✦ Duke munguar statistikat, mungojnë njëkohësisht edhe studimet për efektivitetin e dënimeve dhe vendimeve të dhëna nga gjyqësori për të luftuar dhunën në familje, gjë që e bën të pamundur ndërhyrjen e saktë dhe të mirëinformuar për përmirësime të mundshme.
- ✦ Arsyetimet e vendimeve gjyqësore rezultojnë të jenë të cekëta, pa analiza të qarta të faktit dhe të shkaqeve të dhunës në familje. Si në vendimet penale, ashtu edhe ato civile e familjare ka një skematizëm të theksuar. Argumentet e gjykatës duhet të jenë më të thelluara dhe jo të një rutine të përgjithshme pasi ato kanë mundësi të luajnë edhe rolin shpjegues dhe edukues dhe të brumosin idenë, si për publikun, ashtu edhe për palët e interesuara, e vecanërisht për dhunuesit se dhuna në familje është e patolerueshme dhe e dënueshme nga sistemi i drejtësisë.
- ✦ Përvoja në çështjet penale ka treguar se jo gjithnjë masa e dënimit ka qenë në përputhje me rëndësinë e vepres dhe rrethanat lehtësuese e rënduese nuk janë zbatuar drejt. **Mosndëshkimi i dhunuesve i bën viktimat në përgjithësi dhe ato të zonave rurale në veçanti më të larguara nga sistemi i drejtësisë.**
- ✦ Ndërkohë, ndonëse rrahja, plagosja, e të tjera forma të dhunës fizike dhe psikike parimisht përbëjnë vepra penale dhe janë të ndëshkueshme, është vënë re se nëse ato përfshijnë anëtarë të familjes, nga praktika gjyqësore dhe ajo e profesionistëve të ligjit, nuk trajtohen me seriozitetin e duhur.
- ✦ Ndërsa realiteti paraqet raste të abuzimeve të prindërve ndaj fëmijëve, në praktiken gjyqësore raste të tilla vihen re shumë pak pasi fëmija e ka të vështirë të denoncojë prindin si dhunues. Nga ana tjetër njohuri të specializuara lidhur me metodikën e gjykimit, teknikat e pyetjes së të miturve që janë pjesë e dhunës në familje, në përputhje kjo me veçoritë moshore dhe psikologjike janë ende të kufizuara.
- ✦ Edhe në rastin e fëmijëve dhunues vihen re keqpërdorime të masave shtrënguese ligjore të cilat mund të shkaktojnë pasoja të rënda psikologjike, morale, fizike për të miturin.
- ✦ Gjyqtarët duhet të garantojnë që rregullat e procedurës të parandalojnë pyetjen poshtëruese dhe/ose të paautorizuar për viktimat apo dëshmitarët e dhunës në familje, me qëllim që të reduktohen

efektet traumatike të procedimit apo riviktimizimi i të dëmtuarve nga dhuna në familje.

- ✦ Infrastruktura bazë dhe shërbimet janë përgjithësisht të pamjaftueshme. Gjykimet ende ndodh të bëhen në kushte të papërshtatshme. Ka mungesë të infrastrukturës mbrojtëse ose mos garantimit të masave mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje por edhe të vetë gjyqtarëve, gjatë procesit të hetimit dhe gjyqimit.
- ✦ Një mangësi kryesore që vihet re është moskoordinimi ndërmjet strukturave. Mungojnë marrëveshjet nderinstitucionale që sigurojnë mbrojtje shumë disiplinore të viktimave të dhunës në familje dhe unifikim të shërbimeve. Të tilla mund të jenë ato me policinë, shërbimet e urgjencës (ambulancat), mjekësinë ligjore, psikiatrinë ligjore, spitalet, pushtetin lokal (për mundësitë e strehimit dhe shërbimet e tjera sociale), avokatinë (për ndihme ligjore, këshillime dhe mbrojtje falas), OJF-të. Rritja e efektivitetit dhe efciences së sistemit të drejtësisë është e lidhur ngushtë me nivelin e bashkëpunimit midis gjyqësorit dhe strukturave të tjera që zbatojnë vendimet dhe ligjet të tilla si prokuroria, policia dhe policia gjyqësore, përmbarimi, etj.

Ministria e Drejtësisë

Veç rolit të posaçëm që Ministria e Drejtësisë duhet të fillojë të luajë seriozisht në drejtim të harmonizimit të legjislacionit tonë që lufton dhe parandalon dhunën në familje vihen re edhe mangësitë e mëposhtme:

- ✦ Drejtoria e Legjislacionit dhe Ndihmës ligjore (pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit), ende *nuk ka një studim lidhur me drejtësinë dhe legjislacionin në rastet e dhunës në familje.*
- ✦ Pranë Drejtorisë së Drejtësisë për të Miturit, e cila kujdeset dhe bashkërendon veprimtaritë për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të të miturve në fushën e drejtësisë, si dhe për edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga të miturit, nuk ka statistika të qarta, të ndara në grupmosha. Kjo e bën të vështirë hartimin e politikave për parandalimin e kriminalitetit në këto grupmosha, mbrojtjen e të drejtave të të miturve, etj.
- ✦ Ministria e Drejtësisë ende nuk ka nxjerrë akte nënligjore lidhur me mirëfunksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore të cilat do të bëjnë të mundur:
 - Përmirësimin e punës së ekspertëve mjeko-ligjore, me qëllim që ata të disponojnë akte ekspertimi edhe me kërkesën e të dëmtuarit akuzues në rastet e veprave penale që nuk ndiqen kryesisht (shumë prej tyre lidhen me dhunën në familje). Aktualisht viktimave të dhunës u nevojitet një autorizim nga policia ose prokuroria për të kryer ekspertimin mjeko-ligjor, gjë që e zgjat procedurën në dëm të viktimës.
 - Rimbursimin e shpenzimeve të bëra nga viktimat e dhunës në familje (në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës).

Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Inspektorati i KLD-së

Në situatën kur dhuna në familje është një çështje shqetësuese dhe kur aksesin e viktimave të sistemi i drejtësisë nuk është i standardeve që qasen me nivelin evropian, KLD duhet të diskutojë që në vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve të mbledhë të dhëna dhe të shqyrtojë edhe kriteret që lidhen me etikën, shkallën e ndjeshmërisë, shpejtësinë dhe mënyrën se si gjyqtari adreson çështjet e dhunës në familje; të orientojë kontrollin e Inspektoratit të KLD-së ndaj këtyre çështjeve dhe vendimeve; të rekomandojë edukimin e gjyqtarëve me këto çështje, etj.

Shkolla e Magjistraturës

Ndonëse në përmbajtjen e programit të trajnimit fillestar dhe të atij vazhdues çështjet e dhunës në familje kanë qenë pjesë, rekomandohet vazhdimësia e sesioneve dhe ruajtja e periodicitetit të tyre, për sa kohë dhuna në familje mbetet një çështje shumë serioze, ndaj së cilës qëndrimet e sistemit të drejtësisë janë ende të brishta. Organizimi i konferencave, takimeve rajonale, duke patur parasysh edhe specifika të rajoneve të ndryshme të Shqipërisë, gjyqeve imituese, bërja e studimeve, përgatitja e moduleve të trajnimit, hartimi i pyetësorëve për njohuritë, ndjeshmërinë, nevojat dhe prirjet e sistemit të drejtësisë duhet të jetë në qendër të vëmendjes së Shkollës. Organizimi i sesioneve multidisiplinore me pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë të sistemit të drejtësisë është i rëndësishëm gjithashtu. Shkolla e Magjistraturës futi për herë të parë në programin e formimit fillestar elemente të dhunës në familje si dhe të barazisë gjinore në vitin shkollor 2003-2004. Këshilli Drejtues i Shkollës në miratimin e programit të formimit fillestar dhe vazhdues duhet t'i mëshojë përfshirjes së temave mbi dhunën në familje me qëllim që të sigurohet vazhdimësia.

Prokuroria

Mungojnë prokurorë të specializuar në shkallë vendi në të gjitha shkallët e prokurorive lidhur me veçoritë e ndjekjes penale të veprave penale të dhunës në familje dhe trajtimin e viktimave. Nuk i kushtohet vëmendja e duhur veprave penale të tilla si rrahja apo plagosja dhe kjo bëhet shkak që dhuna të ashpërsohet aq sa pasohet nga vepra penale të rënda deri me pasojë vdekjen. Masa e dënimit të propozuar për fajtorin përgjithësisht rezulton të jetë e ulët dhe lloji i dënimit jo i përshtatshëm. *Kallëzimet në raport me situatën reale janë të kufizuara gjë që reflekton mosbesim tek ky organ.*

Shumica e veprave penale që lidhen me dhunën në familje hyjnë në kategorinë e atyre që ndiqen me ankim nga i dëmtuari akuzues. Për këtë arsye, kallëzimet e tyre **nuk regjistrohen në prokurori** dhe i dërgohen për kompetencë gjykatës në mënyrë të drejtpërdrejtë. (fq.17 QNLQ “për një zbatim sa më të mirë të ligjit...”) Ndonëse prokuroria ka për detyrë të vërë në dijeni opinionin publik për veprimtarinë që kryen, asaj nuk i lejohet të japë të dhëna që dëmtojnë procesin e hetimeve, që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, që cenojnë të drejtat e të miturve dhe moralin publik. Trajnimi me këto çështje si edhe ato që kanë të bëjnë me aftësitë përfaqësuese të prokurorit në sallën e gjyqit janë ende të pakta. Konstatohen njohuri të pamjaftueshme lidhur me procedimin në rastet kur viktimat nuk është (ka vdekur) ose nuk dëshiron që të ankohet.

Policia gjyqësore

Policia gjyqësore kryen hetime mbi veprat penale, nën drejtimin dhe mbikqyrjen e prokurorisë.

- ✦ Organizimi i strukturave të policisë gjyqësore është i ndërlikuar dhe nuk janë të qarta lidhjet e policisë gjyqësore me strukturat e tjera të policisë. Operativiteti i policisë ka ende nevojë për më shumë diskrecion (miratimi nga prokurori për veprimet hetimore lidhur me situatat e dhunës në familje të jetë më i qartë). Mungon një sektor që të merret me çështjet e dhunës në familje.
- ✦ Organet e policisë nuk janë të qarta lidhur me detyrimin për mbështetjen e mbrojtjen që duhet të ofrojnë ndaj viktimave të dhunës në familje. Trajnimi i policisë me të drejtat e njeriut, etikën, sjelljen profesionale, dhunën në familje është ende një çështje që nuk është përmbushur në standardin dhe masën e duhur.
- ✦ Dokumentimi i fakteve kriminale nga policia gjyqësore lë për të dëshiruar dhe kjo ka bërë që ndonëse ka pasur një numër të konsiderueshëm kallëzimesh, është vendosur mosfillimi i procedimit (fq.33 QNLQ “për një zbatim sa më të mirë të ligjit...”). Pranë policisë gjyqësore nuk ekzistojnë rregjistra të veçantë që të përmbajnë të dhëna të hollësishme statistikore për viktimat e dhunës që paraqiten pranë policisë gjyqësore dhe organeve të policisë në përgjithësi.

- ✦ Njohuritë e policisë gjyqësore lidhur me cilësimin e një vepre si penale nuk janë në standardin e duhur, gjë që shkakton gjithashtu efektin e mësipërm.
- ✦ Mungojnë protokollet e qarta proceduriale për hapat që duhet të ndjekë policia dhe policia gjyqësore kur ndeshen me raste të dhunës në familje.
- ✦ Mungojnë marrëveshjet e bashkëpunimit midis policisë gjyqësore, policisë dhe strukturave të tjera qeveritare e joqeveritare që ofrojnë shërbime ndaj viktimave.

Zyra e përmbarimit

- ✦ Nuk ka trajnime të përmbaruesve lidhur me bashkëpunimin me prokurorët, gjyqtarët dhe policinë dhe përgjithësisht mungojnë marrëveshjet e bashkëpunimit mes strukturave.
- ✦ Viktimat e dhunës nuk janë të përjashtuara nga pagesat në rastet e ekzekutimit të vendimeve që lidhen me dhunën në familje.
- ✦ Ka vonesa në veprimtarinë e përmbarimit ose mospërbushje të urdhrave të ekzekutimit gjë që në rastin e dhunës në familje mund të sjellë pasoja në jetën e viktimës.

Ndihma ligjore dhe avokatia

Legjislacioni që siguron të drejtën e mbrojtjes ligjore është i një niveli të mirë, por zbatimi i tij has në vështirësi. Kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së akteve nënligjore, por edhe e shkaqeve subjektive që në të vërtetë çënojnë efektivitetin e së drejtës së mbrojtjes. Ndihma ligjore falas përgjithësisht i jepet asaj kategorie të personave të cilët kanë mundësi të kufizuara ose janë në pamundësi për të përballuar shpenzimet për zgjidhjen e problemeve ligjore. Me miratimin e ligjit të ri kundër dhunës në familje viktimave të saj u sigurohet ndihmë ligjore falas. Është me rëndësi në këtë pikë zbatimi i kësaj dispozite të re.

Ndërkohë, është e domosdoshme që për efektivitetin e mbrojtjes së ushtruar prej avokatëve (pararësisht nëse është fjala për mbrojtjen falas ose jo) **të minimizohen ose eliminohen probleme që kanë të bëjnë me etikën profesionale, të tilla si:** heqja dorë nga mbrojtja gjatë procesit, mungesa e profesionalizmit, mosparaqitja në seanca të ndryshme gjyqësore, zvarritjet, etj.

Një koordinim më i mirë midis gjykatave dhe prokurorive (këto caktojnë mbrojtësin falas) nga njëra anë dhe dhomave vendore të avokatisë në rrethe nga ana tjetër kërkohet për të rritur cilësinë e përfaqësimit dhe të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje. Kjo do të kërkojë përgatitjen e listave të avokatëve falas të cilët janë me përgatitje të lartë profesionale në çështjet e dhunës në familje dhe vendosjen e këtyre emrave në dispozicion të gjykatës dhe të prokurorisë.

Rëndësia dhe vështirësia që paraqesin çështjet e dhunës në familje *kërkojnë një shkallë të lartë të përgatitjes profesionale të avokatëve, profilizimit dhe përvojës së atyre që caktohen për mbrojtje të tilla.* Deri tani kësaj pjesë të përgatitjes profesionale të avokatëve nuk i është kushtuar rëndësia e duhur. Edhe niveli i profesionalizmit të avokatëve të rretheve të ndryshme është i ndryshëm. Në këto kushte *hartimi i programeve, moduleve dhe kalendarëve të detajuar të trajnimit për stazhierët për avokatë dhe atyre që ushtrojnë profesionin në përgjithësi, është detyrë imediate e Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.*

Këshilli Drejtues i Dhomës së Avokatisë të përcaktojë *në rubrikën e pyetjeve të kualifikimit të kandidatëve për avokat rast pas rasti edhe rubrika që lidhen me veçoritë e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje kryesisht të fëmijëve, grave dhe të moshuarve, ngritja e padisë civile brenda procesit penal, etj.*

Ndihma ligjore për viktimat e dhunës në familje ofrohet edhe prej OJF-ve që veprojnë në këtë fushë. Madje disa prej tyre kanë ofruar një shërbim shumë të kualifikuar. Ndërmjet tyre përmendim kryesisht Qendrën për Nisma Ligjore dhe Qytetare (ish-Qendrën Avokatore për Gratë), Klinikën Ligjore për të Miturit, Qendrën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, etj. Mbështetja e këtyre shërbimeve dhe qendrave prej shtetit është në funksion të rritjes së aksesit në sistemin e drejtësisë. Është detyrë e shtetit që të përgatisë procesin e licencimit dhe të mbështesë OJF të licencuara për mbrojtjen falas të viktimave si dhe të parashikojë përjashtimin e tyre nga detyrime financiare kundrejt tatimeve në favor të arkës së shtetit. Një koordinim i sesioneve trajnuese me avokatë të OJF-ve që ushtrojnë mbrojtje ligjore lidhur me praktikën më të mira është i rekomandueshëm.

Ministria e Brendshme. Policia e shtetit. Shkolla e policisë

Në nivel qendror një prej strukturave që lidhet më ngushtë me çështjet e dhunës në familje është “Sektori Për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën Familjare” në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në Ministrinë e Brendshme. Në nivel qarku funksionojnë 12 Drejtoritë e Policive në Qarqe.

- ✦ Policia ende nuk e luan në mënyrë profesionale rolin e saj në parandalimin e fenomenit të dhunës në familje si edhe në identifikimin, regjistrimin, ndjekjen dhe zgjidhjen e konflikteve të ndryshme që shoqërohen apo pasohen me përdorimin e dhunës në familje. Mungojnë analiza lidhur me përgjegjësitë dhe rolin parandalues që mund të luajë policia në rastet e krimit brenda familjeve dhe të vetëvrasjeve.
- ✦ Emergjent është krijimi i një sistemi të referimit dhe menaxhimit të rastit të fëmijëve të dhunuar, të grave, e të moshuarve në të gjitha nivelet e policisë.
- ✦ Ende ka standarde jo të kënaqshme në ofrimin e shërbimit policor prej strukturave përkatëse. Nuk janë të qarta mënyrat se si policia do të mbajë nën kontroll individë dhunues dhe familje të rrezikuara nga dhuna.
- ✦ Mungojnë manuale që në mënyrë të thjeshtë dhe operative të tregojnë veprimet procedurale të policisë pas marrjes dijeni për një veprim të dhunshëm brenda familjes, protokollet e komunikimit me shpejtësi me prokurorinë dhe shërbimet e tjera multidisiplinore në mbrojtje të viktimës. Nuk ka marrëveshje të bashkëpunimit për këtë qëllim midis strukturave të policisë, OJF, shërbimin shëndetësor, arsimin, median, etj.
- ✦ Nuk janë të qarta detyrat me efekt parandalues që duhet të kryejë inspektori i policisë kriminale dhe i zonës pas referimit të veprës penale në prokurori për parandalimin e mundshëm të thellimit të konfliktit, i cili mund të behet shkak për kryerjen e një veprë tjetër penale.
- ✦ Ende nuk ka një numër telefoni evident publik ku qytetarët të mund të denoncojnë dhunën në familje.
- ✦ Përgjithësisht punonjësit e policisë nuk janë të trajnuar në mënyrë specifike për të trajtuar seriozisht dhe në mënyrë profesionale rastet e dhunës në familje. Masat disiplinore duhet të përfshijnë edhe rastet e neglizhencës lidhur me dhunën në familje. Riviktimizimi prej policisë është një dëm i pariparueshëm.
- ✦ Treguesit e rekrutimit të punonjëseve femra në strukturat e kësaj policie si edhe i punonjësve socialë pranë komisariateve të policisë për të mbështetur në mënyrë profesionale një të dhunuar duket se ende janë të kufizuara.
- ✦ Deri tani nuk ka pasur një evidentim apo statistikë periodike që të referojë rastet e paraqitura para policisë lidhur me dhunën në familje. Megjithatë, si rezultat i ndihmës së huaj në strukturat e policisë po ngrihet sistemi i regjistrimit të kompjuterizuar TIMS, në të cilin do të kenë akses të pakufizuar të gjithë punonjësit e policisë si dhe akses të kufizuar prokurorët dhe gjyqtarët.

Sistemi i raportimit TIMS do të përmbajë të dhëna edhe për dhunën në familje. Me këtë rast është me rëndësi trajnimi i oficerëve të policisë për përdorimin e sistemit si dhe hartimi i akteve nënligjore (udhëzimeve) për të dhënat që duhen përfshirë detyrimisht në sistem.

Noteria

Nuk parashikohen shërbime falas për noterizimin e akteve në interes të viktimave të dhunës në familje me pamundësi ekonomike. Trajnimet e notereve lidhur me çështje të ndryshme të etikës profesionale janë shumë të kufizuara.

Mjekësia ligjore

Shërbimi i Mjekesise Ligjore ka ende nevoja për trajnim të specializuar të ekspertëve mjekoligjore dhe përpilimin e protokolleve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe për mënyrën e ekzaminimit; mënyrën e mbajtjes së rekordeve; Ekspertet duhet të pajisen edhe me paketën e mjeteve të duhura për ekzaminimin e rasteve të dhunës në familje; duhen hartuar udhëzime për mbajtjen e statistikave dhe duhen përfunduar marrëveshjet e bashkëpunimit me shërbimet e tjera që u ofrohen viktimave.

Fakultetet e Drejtësisë. Shkollat Pasuniversitare

Shtimi i numrit të fakulteteve të drejtësisë, kërkon në mënyrë imediate unifikimin e standardit të njohurive në disa lëndë dhe në disa nivele ndërmjet të gjitha fakulteteve publike dhe private me qëllim që studentët të kenë njohuritë e domosdoshme mbi kuptimin e dhunës në familje, format e shfaqjes së saj dhe qëndrimin ligjor ndaj sjelljeve të dhunshme. Jo të gjitha fakultetet kanë klinika ligjore (ose edhe aty ku figurojnë nuk funksionojnë), të tilla që të stimulojnë përgatitjen e ekipeve të studentëve jo vetëm të ditur nga pikëpamja teorike por edhe të aftë në praktikë. Problemi i dhunës në familje dhe mënyra e adresimit të tij prej sistemit të drejtësisë ende nuk përfshihen në programin e ndonjë lënde në shumicën e fakulteteve të drejtësisë. Pedagogët dhe studentët duhet të inkurajohen në kryerjen e punimeve shkencore mbi dhunën në familje (universitare dhe pas universitare) dhe masat për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave.

1.1.7.3 Nismat e Ndërmarra dhe Problemet në Shërbimet Sociale

Që në vitin 1996 në raportin e tyre “Dhuna në familje në Shqipëri” Avokatet për të Drejtat e Njeriut, rekomandojnë se Shteti Shqiptar duhet të përkujdeset për viktimat e dhunës në familje duke i ofruar atyre shërbime juridike e sociale.²⁴ CEDAW, gjithashtu rekomandon se duhet të merren masa për ndërtimin e “strehëzave” për gratë, dhe fëmijët e dhunuar në familje si dhe të përgatitet stafi i nevojshëm për të adresuar nga pikëpamja ligjore dhe sociale viktimat e dhunës në familje.

Megjithë rekomandimet, të vetmet veprime të ndërmarra deri më sot janë artikuj në mediane shkruar dhe elektronike ku denoncohet dhuna në familje, si dhe ngritja e kapaciteteve të disa organizatave joqeveritare. Gratë dhe fëmijët e dhunuar brenda familjes nuk kanë asnjë mundësi për të përfituar shërbime, asistencë dhe mbështetje nga organizatat publike. Megjithëse Pushteti Lokal (PL) ka sektorë të arsimit dhe shërbimeve sociale, të cilat e kanë për detyrë të merren me dhunën në familje, procesi i decentralizimit të pushtetit ka bërë që shumë probleme të anashkalojnë. Shërbimet sociale që ofron PL reduktohen vetëm në ndihma ekonomike ose adresim të dhunës në polici, në ndonjë OJF, ose në spital.

²⁴ Amnesty International 2006; Albania: Violence against women in the family is not her shame. <http://web.amnesty.org/library/Index/ENGEUR110052006?open&of=ENG-ALB>

Shërbimi më i specifikuar për të ndihmuar fëmijët e abuzuar nga dhuna në familje, ende në nivel projekt, është ai i psikologut/punonjësit social. Në 140 vende, janë të bashkangjitura pranë shkollave shërbime të psikologut, por jo të gjitha këto shërbime kryhen nga profesionistë të diplomuar si të tillë. Sipas aneksit të drejtorisë së kurrikulave të MASH për “Shërbimin Psikologjik në Shkollë” rekomandohet që këtë detyrë ta kryejnë dhe persona të përafërt me detyrën e psikologut, gjë e cila ka sjellë uljen e cilësisë së punës dhe efektin të fëmijët. Kjo detyrë, sipas këtij projekti, përqendrohet në promovimin dhe zhvillimin mendor e fizik si dhe ndihmesën për rritjen e cilësisë së procesit mësimor të mësimdhënies e mësimnxënies. Sipas këtij rekomandimi puna e psikologut është e ndarë dhe specifikuar, ndërsa për problemet e tjera është e rekomandueshme që të merret punonjësi social. Për shumë raste këto dy detyra janë unifikuar. Stafi i shërbimit të psikologut dhe punonjësit social nuk kanë specializime të veçanta. Shërbimi social apo mjekësor nuk ka si objektiv të punës së tyre trajtimin e fëmijëve të abuzuar nga dhuna në familje.

Megjithëse kopshtet e shkollat në të shumtën e tyre janë ristrukturuar, në to nuk janë parashikuar mjedise çlodhëse për fëmijët të abuzuar nga dhuna në familje si: dhomat e qetësisë, një aneks ngrënieje, dhoma e artit, e lojrave me dorë, mjediset e informimit dhe komunikimit. Mjediset ekzistuese si biblioteka, dhomat e veprimtarive, palestrat, sallat e kompjuterave vihen pak në shërbim të tyre. Godinat janë pak të siguruara, rrethimet dhe sistemi i komunikimit nuk janë efikase. Numri i madh i nxënësve për klasë në disa zona është tepër shqetësues për këta fëmijë.

Sipas raportit të Amnesty International 2006 qeveria shqiptare ka dështuar në drejtim të mbrojtjes ligjore të viktimave të dhunës si dhe në drejtim të ofrimit të shërbimeve sociale për riintegrimin e tyre.

1.2 Kuadri Ligjor

1.2.1. Barazia Gjinore

Sanksionimi me ligj i barazisë së të gjithë shtetasve përpara ligjit, (Neni 18 i Kushtetutës), bën që burri dhe gruaja, si subjekte të së drejtës, *de jure* të trajtohen njësoj, në mënyrë të barabartë dhe si pasojë të kenë edhe detyrime të njëjta. Barazia përshkon të gjithë Kushtetutën dhe ligjet e tjera. Projekt Ligji për Barazinë Gjinore plotëson kuadrin ligjor lidhur me barazinë gjinore në arsim, punësim dhe vendim-marrje. Ai mundëson ngritjen e mekanizmave qeveritarë në hartimin e politikave për barazinë gjinore dhe parashikon matjen e ndikimit të këtyre politikave nëpërmjet vlerësimeve dhe monitorimit periodik.

Një sërë Kodesh të miratuara pas vitit 1995, përmbajnë dispozita në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe sanksionojnë parimin e barazisë burrë-grua. Më konkretisht mund të përmendim:

- ✦ *Kodi Civil* dhe *Kodi i Proçedurës Civile*, iu njohin grave zotësinë juridike që me lindjen e tyre, si dhe zotësinë juridike për të vepruar me mbushjen e moshës madhore, njësoj si edhe burrave, psh. të drejtën e vendbanimit, të mbajtjes së mbiemrit, të trashëgimisë, etj.
- ✦ *Kodi Penal* dhe *Kodi i Proçedurës Penale* mbrojnë në mënyrë të barabartë si burrat dhe gratë, por i vendosin pa diskriminim edhe përpara përgjegjësisë penale kur ata janë subjekte të veprave penale.
- ✦ *Kodi i Familjes* miratuar në vitin 2003, iu njeh të drejta të barabarta si burrit edhe gruas që kanë mbushur moshën 18 vjeç të lidhin martesë lirisht; të ndjekin të njëjtën proçedurë për zgjidhjen e martesës; të kenë të drejta dhe detyrime të barabarta në martesë, familje, në rritjen dhe kujdesin e fëmijëve, etj.

✦ *Kodi i Punës* iu njehtë drejta të barabarta si burrit dhe gruas për të zgjedhur lirisht profesionin, të drejtën për shpërblim të barabartë për punë me vlerë të barabartë; të drejtën e pushimeve vjetore të paguara; etj.

Ligje të tjera të veçanta sigurojnë barazinë në fushën e vendim-marrjes, arsimit dhe formimit profesional, sigurojnë mbrojtje ndaj ngacmimit seksual, mbrojtje të të drejtave riprodhuese, mbrojtje përmes sigurimeve shoqërore, etj.

Edhe *parimi i mosdiskriminimit* sanksionohet në pikën 2 Neni 18 i *Kushtetutës*: "Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si *gjinia*, raca, feja, ..." Përdorimi i termit "gjinia" krahasuar me "seks" i përdorur në dispozitat kryesore kushtetuese, tregon për një hap pozitiv lidhur me përdorimin e koncepteve të këndvështrimit gjinor, sipas standarteve ndërkombëtare. Duke e përdorur me vend këtë term, ligjvënësi ka mundësi të hartojë legjislacion mbrojtës për burrin dhe gruan, duke mos u ndalur më vetëm në aspektin biologjik, por duke i trajtuar ata në aspektin social.

Shqipëria është anëtare e OKB-së që në vitin 1955 dhe ka ratifikuar një numër të madh të Konventave për të Drejtat e Njeriut, ku për aspektin për të cilin po flasim më e rëndësishmja është Konventa "Për Eleminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas" (CEDAW) 1978, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me Ligjin nr.7767, datë 09.11.1993. Kjo Konventë për nga rëndësia njihet edhe si *Kushtetuta e Gruas*. Shteti Shqiptar sipas detyrimeve që ka, ka raportuar pranë Komitetit të Konventës në janar 2003, dhe tani është në fazën e përmbushjes së rekomandimeve të bëra nga Komiteti i Konventës, sikurse dhe në përgatitjen e raportit të tretë periodik zyrtar. Shqipëria gjithashtu, aderonte edhe në Protokollin Shtesë të kësaj Konvente, me Ligjin Nr. 9052 datë 17.04.2003²⁵.

1.2.2 Dhuna në familje

Ligji për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare. Miratimi dhe hyrja në fuqi e këtij ligji është një hap i rëndësishëm drejt plotësimit të kuadrit ligjor në fushën e dhunës në familje. Ky ligj ka dy drejtime të rëndësishme: *Së pari* ai sanksionon organet shtetërore që kanë detyrime dhe kompetenca për t'iu përgjigjur dhunës në familje. *Së dyti*, ligji i ri i jep mundësi gjykatave të lëshojnë urdhra mbrojtjeje kundër dhunuesit, një mekanizëm shtesë në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje. Sfidë për zbatimin e këtij ligji mbeten plotësimi i tij me kuadrin nënligjor dhe mbështetja e përshtatshme buxhetore

1.3 Mekanizmat Institucionalë që Sigurojnë Barazinë Gjinore në Shqipëri.

1.3.1. Mekanizmi qeveritar që siguron barazinë gjinore.

Ligji Nr. 9198 dt.01.07.2004 "Për barazinë gjinore në shoqëri", pas ndryshimeve që pësoi në shkurt 2006, përcakton si autoritet përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Vizioni i qeverisë së re demokratike për përparimin e gruas dhe arritjen e barazisë gjinore bëri që të përfshihen këto çështje në politikën e saj si prioritete të rëndësishme, duke vënë theksin në fuqizimin e mekanizmit qeveritar. Për këtë, në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale e Shanseve të

²⁵ Për një përshkrim më të hollësishëm të legjislacionit, ju lutemi referohuni tek Aneksi 1 i kësaj strategjie.

Barabarta u krijua Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta. Kjo Drejtori ka si mision kryesor të saj: *“formulimin dhe zhvillimin e politikave për nxitjen e barazisë në fusha të tilla si, barazia gjinore, barazinë/pabarazinë në aftësi, problemet e pakicave etnike, etno- kulturore dhe gjuhësore, pabarazinë moshore, atë brezore e racore etj”*. Në veçanti për çështjet e barazisë gjinore Drejtoria ka për qëllim: *“të nxisë barazinë gjinore dhe një pjesmarrje të gjerë të gruas në jetën ekonomike, politike e kulturore të vendit”*.

Detyrat e Drejtorisë për çështjet e barazisë gjinore janë:

- ✦ Të formulojë politika për shanse të barabarta të fokusuar në perspektivën e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të kategorive të tjera të shoqërisë siç janë të përmendura edhe në misionin e saj.
- ✦ Të propozojë nisma për studim dhe analiza në fushën e gjithë gamës të politikave për shanse të barabarta dhe shfrytëzimin e këtyre studimeve në procesin e politikave të zhvillimit.
- ✦ Të hartojë akte ligjore të nevojshme për arritjen e barazisë në fusha të ndryshme dhe të zbatojë e monitorojë dispozitat e ligjit për barazi dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij.
- ✦ Të mbikqyrë zbatimin e marrveshjeve dhe akteve ndërkombëtare me fushën që mbulon, të cilat miratohen nga Qeveria.
- ✦ Të bashkëpunojë me organizatat jo-fitimprurëse të cilat janë aktive në fushën e shanseve të barabarta.
- ✦ Të koordinojë punën për përgatitjen e Programeve Kombëtare për shanse të barabarta për kategoritë e popullsisë që mbulon objekti i Drejtorisë së Politikave të Shanseve të Barabarta.

Krijimi dhe fuqizimi i rrjetit të pikave të kontaktit në nivel ministrie dhe në prefektura, ka bërë të mundur përfshirjen e politikave gjinore në politikat qeveritare, gjë që do të ndikojë në përmirësimin e situatës së barazisë gjinore në nivel kombëtar.

Në nivel parlamentar, brenda Komisionit Parlamentar të Punës dhe Çështjeve Sociale, funksionon Nënkomisioni për Minorenët dhe Shanset e Barabarta, i cili sipas problematikës që mbulon shqyrton dhe ndërmerri inisiativa ligjore. Ky nënkomision bashkëpunon me MPPÇSSHB për çështjet e barazisë gjinore dhe fëmijëve.

1.3.2. Mekanizma të tjerë.

Rëndësia e barazisë gjinore theksohet në raportin e progresit të SKZHES 2003, e cila vë theksin në të drejtën për akses të barabartë në punësim dhe arsimim, duke vënë në dukje që këto kanë impakt të drejtpërdrejtë në reduktimin e varfërisë. Politikat dhe programet e fokusuar drejt realizimit të barazisë gjinore janë thelbësore në programet qeveritare për integrimin e Shqipërisë në BE. Ligji për Nxitjen e Punësimit parashikon mbështetjen e punëdhënësve që krijojnë vende të lira pune dhe punësojnë kandidatë të ofruar nga Zyrat e Punësimit. Në mbështetje të këtij ligji, aplikohen pesë programet e nxitjes së punësimit: (1) programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë; (2) programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nëpërmjet formimit në punë; (3) programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit institucional; (4) programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra; (5) programi i nxitjes së punësimit për studentët që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit²⁶.

²⁶ Burimi: MPPÇSSHB

Në nivel qendror është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, misioni i së cilës (ligji Nr. 7995 datë 20.09.1995 “Për nxitjen e Punësimit” dhe ligjit 8872 datë 29.03.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”) është hartimi i politikave në fushën e punësimit dhe formimit profesional. Këtë ministria e realizon nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të Punësimit. Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) - krijuar në vitin 1988 - është një shërbim publik autonom, me statusin e një administrate shtetërore qendrore, që përgjigjet para Ministrit. Organi më i lartë vendim-marrës i tij është Këshilli Administrativ Tripalësh me 13 anëtarë që kryesohet nga Ministri, dy anëtarë të këtij këshilli janë femra. Po kështu, në mbështetje të ligjit Nr. 8872, datë 29.03.2002 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, që në Nëntor të vitit 2003, është krijuar Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional. Dialogu social në Shqipëri zhvillohet midis partnerëve socialë në shkallë vendi me përfaqësuesit e qeverisë për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me politikën apo ndërhyrjet e kësaj të fundit. Në shkallë vendi, janë të mbuluar me kontrata kolektive 85 përqind e punonjësve në sektorin shtetëror dhe 22 përqind e punonjësve në sektorin privat. Pranë Zyrave të Punësimit funksionojnë këshillat konsultative trepalëshe, të cilët zhvillojnë konsultime për qëndrueshmërinë e politikave, programeve dhe projekteve të punësimit. Partnerët socialë marrin pjesë në Këshillat Administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

1.3.3 Mekanizmi qeveritar që adreson dhunën në familje

Ligji “Për dhunën në marrëdhëniet familjare përcakton dy lloj autoritetesh përgjegjëse, ato administrative dhe gjyqësore.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Kjo ministri është autoriteti kryesor përgjegjës (N. 5/1 dhe N. 6). Ajo ka rol koordinues, mbështetës dhe mbikqyrës.

Detyrat e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

- ✦ Të përcaktojë drejtimin e politikave shtetërore
- ✦ Të financojë projekte për viktimat e dhunës dhe mbrojtjen e familjes
- ✦ Të mbështesë ngritjen e strukturave ndihmëse të infrastrukturës dhe mbikqyrjes së këtij procesi;
- ✦ Të trajtojë
- ✦ Të mbajë statistika
- ✦ Të mbështesë dhe mbikqyrë qendrat e shërbimeve
- ✦ Të liçensojë OJF-të

Autoritetet e Tjera Përgjegjëse të Linjës (sipas Ligjit Nr.9669 dt.18.12.2006)

Ministria e Brendshme

Detyrat e Ministrisë së Brendshme

- ✦ Të ngrerë sektorë të veçantë kundër dhunës në familje në çdo drejtori policie (N7/1/a)
- ✦ Të krijojë struktura të posaçme dhe të caktojë personat përgjegjës për zbatimin e këtij ligji (mund të jetë edhe në nivelin e postës) (N8/1)
- ✦ Të trajtojë efektivat e policisë që do të merren me dhunën në familje (N 7/1/b)

Detyrat e strukturave të Ministrisë së Brendshme (N 8):

Policia (në nivel rajonal dhe lokal):

- ✦ Të krijojë struktura të posaçme dhe të caktojë personat përgjegjës
- ✦ T'i përgjigjet çdo njoftimi nga viktimat ose të tjerë
- ✦ Të mbaje një raport dhe t'i japë një kopje viktimës a shoqëruesit
- ✦ Të informojë për masat që parashikon ligji dhe institucionet që duhet t'u drejtohen
- ✦ Të informojë viktimën për shërbimet sociale
- ✦ Të shoqërojë viktimën në këto shërbime
- ✦ Të transportojë viktimën në qendrat shëndetësore a sociale
- ✦ T'i vërë viktimës në dispozicion një polic kur viktimës i rrezikohet jeta
- ✦ Për çdo dyshim për dhunë në familje policia bën konstatimet e menjëhershme, i reflekton ato në një raport dhe fillon hetimet kryesisht
- ✦ T'i japë viktimës numri i rastit të raportuar (TIMS)

Funksione të tjera të policisë në kuadrin e urdhër mbrojtjeve

- ✦ Policia, me urdhër të gjykatës, të shoqërojë viktimën ose dhunuesin në banesë për të mbikqyrur largimin e sendeve vetjake (N. 10/1/f)
- ✦ Të konfiskojë armën e gjetur gjatë kontrollit (N 10/1/g)
- ✦ Të heqë/pezullojë lejen e armës për dhunuesin (n 10/4/b)
- ✦ Të paraqesë kërkesën për Urdhër Mbrojtjeje dhe Urdhër Mbrojtjeje të Menjëhershëm për viktimën madhore (n 13/1/c dhe 13/3/c)
- ✦ T'i lëshojë kërkesit ose gjykatës kopje të certifikuara (me vulë) të dokumenteve shkresore (N 15/2)
- ✦ Të marrë pjesë në gjykim për lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes dhe Urdhërit të Mbrojtjes së Menjëhershme
- ✦ Të ekzekutojë vendimet e gjykatës menjëherë dhe të vërejë zbatimin e tyre në vazhdimësi
- ✦ Kur është rasti për përgjegjësi penale, të bashkëpunojë me prokurorin për fillimin e procesit penal (n. 24, n 23/6)

Njësitë e qeverisjes vendore

Detyrat e bashkive, komunave (sipas ligjit)

- ✦ Të krijojnë strukturat e shërbimit social për dhunën në familje
- ✦ Të ngrenë qendra sociale dhe rehabilitimi për viktimat dhe dhunuesit
- ✦ Të bëjnë referim, orientim, shoqërim, transportim të viktimave për në shërbimet e tjera
- ✦ T'i lëshojnë viktimës dhe gjykatës dokumenta shkresore
- ✦ Të paraqesin kërkesën në gjykatë për Urdhër Mbrojtjeje për të mitur dhe për Urdhër Mbrojtjeje të Menjëhershme
- ✦ Të marrin pjesë në gjykim për lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes për të miturit
- ✦ Të sigurojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore
- ✦ Të instalojnë një linjë telefonike 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre

Ministria e Shëndetësisë dhe strukturat e saj

- ✦ Të krijojnë kapacitetet për të trajtuar rastet e dhunës në familje në urgjenca dhe qendra shëndetësore (komuna e bashki)
- ✦ Të ofrojnë ndihmën mjekësore dhe psikologjike në çdo kohë
- ✦ Të kryejnë ekzaminimet mjekësore në çdo kohë
- ✦ Të pajisin viktimën me një raport mjekësor
- ✦ Të referojnë/orientojnë viktimën për në shërbimet e tjera (n 7/2/d), por edhe ta shoqërojnë apo transportojnë atë (n 8/3/b dhe c)
- ✦ T'i paraqesin gjykatës dokumente të çertifikuara

Ministria e Drejtësisë

Kjo Ministri adreson çështjet e dhunës në familje nëpërmjet shërbimit mjeko-ligjor, përmbartimit dhe mbrojtjes ligjore.

Detyrat e shërbimit mjeko-ligjor

- ✦ Të trajnojnë ekspertët për dhunën në familje dhe ndaj fëmijëve
- ✦ T'u siguron ekspertëve bazën materiale
- ✦ Të mbikqyrë zbatimin e ligjit
- ✦ Të bëjë ekzaminimin dhe t'i japë një kopje viktimës
- ✦ Të paraqite në gjykatë si ekspert

Detyrat e përmbartimit

- ✦ Të trajnojnë përmbartuesit për ekzekutimin e Urdhrit të Mbrojtjes dhe Urdhrit të Mbrojtjes së Menjëhershme
- ✦ Të sigurojë përmbushjen e tyre
- ✦ Të ndër marrë të gjitha veprimet e duhura

Detyrat e mbrojtjes ligjore

- ✦ Të sigurojë mbrojtje ligjore falas
- ✦ Të sigurojë një numër (listë) avokatësh të trajnuar që ofrojnë këtë shërbim

Të gjitha organet e sipërpërmenduar kanë detyrimi ligjor për t'iu pergjigjur çdo rasti, dhe për ta trajtuar në bazë të specifikave të secilit organ. Po kështu, ato kanë detyrimin për të zbatuar vendimet gjyqësore, për të rregjistruar dhe reflektuar gjithçka në dokumentacion dhe për të bashkëpunuar me strukturat e tjera. Ato kanë përgjegjësi administrative dhe penale për mospërmbushjen e këtyre detyrimeve.

Gjykata

- ✦ Të shqyrtojë kërkesat për Urdhrin e Mbrojtjes dhe Urdhrin e Mbrojtjes së Menjëhershme
- ✦ Të sigurojë zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve të tjera
- ✦ Të veprojë sipas parimeve të paanësisë, ligjshmërisë, mosdiskriminimit, mbështetjes në prova dhe të respektojë etikën profesionale.
- ✦ Të marrë masat e organizimit të brendshëm administrativ për t'iu pergjigjur në kohë (urgjent) viktimave që i drejtohen asaj si dhe për të krijuar siguri në mjediset e gjykatës
- ✦ Të trajnojnë gjyqtarët për njohjen e ligjit për dhunën në familje
- ✦ Të trajnojnë stafin për t'iu pergjigjur viktimave sipas ligjit dhe rregullave të etikës.

KREU 2

VIZIONI, PRIORITETET STRATEGJIKE DHE QËLLIMET STRATEGJIKE.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas janë instrumenta të rëndësishëm për të reduktuar pabarazitë dhe varfërinë tek kjo pjesë e shoqërisë. Ndërhyrjet dhe strategjitë në reduktimin e varfërisë dhe në respektimin e të drejtave edhe për kategoritë e varfëra, janë të suksesshme nëse ato (a) njohin gratë dhe vajzat si grup që nuk iu ofrohen mundësi të njëjta për të përmbushur të drejtat e tyre dhe për të gëzuar një status të barabartë me burrat; (b) rritin pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në identifikimin e zgjidhjeve për problemet që ato kanë, duke respektuar jo vetëm të drejtat e tyre, por edhe duke kontribuar në hartimin e programeve e politikave të qëndrueshme; (c) ndërthurin zhvillimin e politikave me parimet e të drejtave bazë dhe të barazisë gjinore.

2.1. Vizioni

Zhvillimi ekonomik dhe social i vendit dhe hartimi e zbatimi i politikave të përshtatshme për realizimin e barazisë gjinore, do të shërbejnë si premisë për programimin e objektivave që lidhen me barazinë gjinore, aksesin e barabartë midis burrave dhe grave në vendimmarrje në nivel qendror e vendor, në fushën e arsimit, shëndetësisë, punësimit, shërbimeve publike, parandalimin e dhunës në familje, etj.

Për ta realizuar këtë është i domosdoshëm përcaktimi i synimeve të qarta dhe të realizueshme që kanë lidhje me arsimin, shërbimet shëndetësore për gratë, vajzat, garantimin e mundësisë për punësim dhe për të ardhura, reduktimin e dhunës si dhe të problemeve të tjera sociale, sikurse dhe me pjesëmarrjen në vendimmarrjen politike në nivel qendror dhe lokal. Gjithashtu për arritjen e këtij vizioni janë të nevojshme shumë ndërhyrje, strategji dhe politika “*pro gjinore*” që garantojnë ndryshime pozitive në jetën e grave dhe vajzave.

Synimi kryesor është përfshirja e çështjeve gjinore në politikat publike nëpërmjet planeve konkrete të veprimit, të detajuara dhe buxhetuara për të hedhur bazat për avancimin e barazisë gjinore dhe minimizimin e fenomenit të dhunës në familje në të ardhmen, mbështetur në dokumentat, rekomandimet dhe instrumentat ndërkombëtare, duke iu referuar kushteve konkrete të Shqipërisë.

2.2. Prioritetet Strategjike

Disa nga **prioritetet strategjike** të këtij dokumenti në bazë të fushave përkatëse të cilat mbulon, mund të renditen si më poshtë:

1. Forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë mbrojtës me qëllim sigurimin e barazisë gjinore në Shqipëri.
2. Fuqizimi i gruas nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së saj në vendimmarrje;
3. Fuqizimi ekonomik i gruas dhe rritja e mundësive të saj për punësim dhe kualifikim profesional;
4. Promovimi i aksesit të barabartë të grave dhe vajzave në arsimin cilësor;

5. Përmirësimi i situatës sociale të grave dhe vajzave në risk nëpërmjet rritjes së qasjes së tyre ndaj shërbimeve sociale cilësore.
6. Përmirësimi i shëndetit të popullsisë duke rritur përgjigjen e sistemit shëndetësor, ndaj nevojave të veçanta shëndetësore të grave/ vajzave dhe burrave,/ djemve.
7. Përmirësimi i rolit të medias për një mentalitet të ri, që i përgjigjet zhvillimit të kohës, lidhur me barazinë gjinore në shoqëri dhe rritjen e përfaqësimit të grave dhe vajzave në këtë profesion.
8. Rritja e ndërgjegjësimit ndaj dukurisë së dhunës, mbrojtje ligjore dhe administrative si dhe mbështetje për individë të prekur nga dhuna në familje dhe dhunuesit.

2.3. Qëllimet Strategjike

Qëllimet strategjike të këtij dokumenti janë formuluar duke u bazuar në zbërthimin e prioriteteve strategjike. Për çdo fushë, qëllimet strategjike janë detajuar më tej dhe në objektiva specifike e veprime konkrete që duhet të ndërmerren. Për të gjitha këto, si dhe për treguesit e monitorimit e të vlerësimit në lidhje me përmbushjen e këtyre qëllimeve stretegjike, ju lutemi referohuni tek Plani i Veprimit.

KREU 3

POLITIKAT

3.1 Përmirësimi i mëtejshëm i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë barazinë gjinore në Shqipëri.

Megjithëse burrat, djemtë dhe gratë, vajzat gëzojnë de jure të drejta të barabarta dhe vështirësia kryesore qëndron në respektimin dhe zbatimin e këtyre të drejtave në jetën e përditshme (de facto), sërish ka gjithmonë vend për përmirësimin e mëtejshëm të të gjithë atyre mekanizmave ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë barazinë gjinore në Shqipëri, me qëllim që të krijohen kushte sa më të përshtatshme për bërjen realitet të kësaj barazie. Kështu, duke pasur parasysh fushat që mbulon kjo strategji dhe legjislacionin përkatës, në lidhje me përmirësimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë në funksion të arritjes së barazisë gjinore në shoqëri,

Rekomandohen:

1. Forcimi i mekanizmave qeveritarë në nivel qendror dhe vendor, me qëllim zbatimin dhe monitorimin e strategjisë.
2. Rishikimi i legjislacionit nga këndvështrimi gjinor në përputhje me standartet ndërkombëtare
3. Ndërgjegjësimi i opinionit publik, sidomos i grave dhe vajzave të reja, lidhur me të drejtat ligjore që atyre iu takojnë.

3.2. Balanca Gjinore në VendimMarje

Në dokumentin e “Pro-poor & pro-women development policies in Albania²⁷” në vitin 2005 fuqizimi i pjesëmarrjes së gruas në jetën politike përcaktohet nga një sërë ndërhyrjesh. Në këtë kuadër, duke pasur parasysh dhe mekanizmat ligjorë dhe institucionalë në funksion të arritjes së balancës gjinore në vendimmarrje,

Rekomandohen:

1. Rritja e numrit të grave dhe vajzave në vendimmarrjen politike
2. Rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare për pjesëmarrjen aktive të grave dhe vajzave në politikë.

3.3 Fuqizimi Ekonomik si një ndër Kushtet Themelore për Arritjen e Barazisë Gjinore

Ndryshimet ekonomike, sociale e kulturore u pasqyruan edhe në legjislacionin shqiptar, nëpërmjet hartimit të kodeve të reja. Regullimi i marrdhënieve të punës u pasqyrua në hartimin e një Kodi të ri në vitin 1995 dhe ligjeve e akteve nënligjore, të cilat vazhdimisht në këto vitet e fundit janë përmirësuar duke patur në bazë standartet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Të drejtat e gruas si pjesë integrale e të drejtave të njeriut kanë gjetur vendin e tyre në legjislacionin shqiptar në përgjithësi, dhe në atë të punës në veçanti.

²⁷ UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor – Shqipëria, 2005.

Praktikisht nuk kemi të dhëna për raste të diskriminimit për shkak të gjendjes së shtatëzanisë apo mëmësisë në sektorin publik apo privat. Megjithatë mendohet se në sektorin privat gruaja diskriminohet për shkak të këtyre gjendjeve. Ajo nuk punësohet në qoftë se është shtatëzënë apo me fëmijë të vegjël. Nuk ka raste të denoncimit në gjykatë për këto shkaqe. Kjo ndoshta vjen nga mosnjohja e legjislacionit mbrojtës për këtë kategori grash nga vetë gratë, ose dhe nga mosbesimi i grave se mund të fitojnë të drejtën e tyre, kështu që nuk bëjnë denoncime.

Rekomandime:

1. Rritja e numrit të projekteve apo programeve të cilat nxisin formimin profesional dhe punësimin e grave dhe vajzave, si dhe shtrirja e këtyre projekteve edhe në zonat rurale.
2. Rritja e numrit të grave dhe vajzave sipërmarrëse nëpërmjet dhënies së mundësive për më shumë akses në pronë, kapital dhe kreditime

3.4 Arsimi dhe Eliminimi i Dallimeve Gjinore

Strategjia e Barazisë Gjinore në Arsim synon të përmirësojë në mënyrë të dukshme rezultatet me bazë gjinore në sistemin arsimor të Shqipërisë. Ajo është në përputhje me dokumenta të rëndësishme mbi të cilat mbështetet qeveria shqiptare për reduktimin e varfërisë, si Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarin, dhe SKZHI. Varfëria ndikon në arritjet në arsim jo vetëm në nivelin makro (vendet me ekonomi të varfër shtëpiake rezultojnë me nivele më të ulta arritjeje në arsim), po edhe në atë mikro (fëmijët e familjeve të varfëra arsimohen më pak, pasi detyrohen të ndërpresin apo braktisin arsimin për shkak të pamundësisë ekonomike dhe nevojës për të kontribuar në mirqenien e familjes). Vajzat janë veçanërisht të prekuara jo vetëm për arsye ekonomike (kryesisht duke ndihmuar familjet), por edhe për shkak të qëndrimeve shoqërore dhe kulturore që konsiderojnë investimin në arsim për vajzat si prioritet të shkallës së ulët.

Rekomandime:

1. Përmirësimi i programeve shkollore që promovojnë barazinë gjinore, si dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në mësimdhënie, planifikimin dhe menaxhimin e arsimit.
2. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve arsimore për të integruar çështjet dhe konceptet e barazisë gjinore në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin në arsim.
3. Përmirësimi i qëndrimeve shoqërore dhe kulturore të komuniteteve dhe familjeve që promovojnë vlerat dhe rëndësinë e arsimimit të vajzave duke përfshirë rolet dhe kontributet e grave dhe vajzave në zhvillim.

5.5 Mbrojtja Sociale

Shteti i mirëqenies sociale siguron mbrojtjen sociale²⁸ familjeve me shumë fëmijë, familjeve rome dhe egjyptjane, familjeve me fëmijë jetimë, jetimëve pas moshës 18 vjeç, etj, përmes dy mekanizmave kryesorë: 1) transfertave cash në formën e ndihmës ekonomike; 2) shërbimet publike apo private për personat në nevojë. Transfertat cash synojnë të garantojnë një jetë dinjitoze mbi kufirin e minimumit jetik (pension pleqërie, invaliditeti, pagesë paaftësie, ndihmë ekonomike për varfërinë).

Disavantazhi i transfertës cash për gruan: Shumë prej transfertave kesh lidhen me sigurimin shoqëror dhe jepen në formën e pensioneve familjare për personat në varësi të titullarit të sigurimit. Transfertat cash lidhen me titullarin burrë dhe i jepen atij për familjen, nëse ai bie nga të ardhurat. Kjo le jashtë përfitimit si titullare gratë kryefamiljare, të cilat për shkak të modelit tradicional gjinor që inkurajon qëndrimin në shtëpi të gruas për t'u përkujdesur për fëmijët, nuk janë punësuar. Gratë që kanë qenë në punë nuk kanë qenë kryefamiljare në momentin e krijimit të familjes, pasi kryefamiljari është burri dhe për pasojë, nuk janë nxitur të kenë punë të paguara mirë dhe me kohë të plotë, por punë me kohë të pjesshme ose punë të paguara pak. Prandaj edhe kontributi për sigurimin e tyre është i ulët.

Programi i ndihmës ekonomike përfaqëson një komponent të rëndësishëm të politikave të mbrojtjes sociale në mbështetje të familjeve të varfëra, të cilat në kushtet e ekonomisë së tregut, janë më të prekshme nga varfëria dhe rreziku i marxhinalizimit social. Nëpërmjet këtij programi ofrohet një minimum i garantuar të ardhurash me mjete monetare (transferta mujore në cash) për plotësimin e nevojave më elementare të jetesës për familjet pa të ardhura ose me të ardhura nën nivelin e përcaktuar si “vija zyrtare e varfërisë”. Skema e ndihmës ekonomike nisi të funksionojë në vitin 1993 mbi bazën e ligjit 7710, dt. 18.05.1993 “Për Ndihmën dhe Përkujdesin Shoqëror”. Ndihma ekonomike u jepet familjeve të shtetasve shqiptarë që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose nuk kanë të ardhura materiale jetese nga veprimtaria ekonomike, anëtarë të familjes jashtë shtetit, kapital, etj. Për përmirësimin e kujdesit social, nevojitet një angazhim i Qeverisë dhe në veçanti i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Social Shtetëror, me përkrahjen e donatorëve dhe angazhimin e pushtetit vendor, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, etj.

Rekomandime:

1. Mbështetja e familjeve të varfëra dhe individëve e grupeve në nevojë për reduktimin e varfërisë, me pagesa kesh dhe shërbime sociale, me prioritet familjet me kryefamiljare gra, nënat me shumë fëmijë dhe fëmijët jetimë..
2. Shtrirja në të gjithë vendin e shërbimeve komunitare për gratë dhe vajzat me probleme sociale.

²⁸ **Mbrojtja sociale** i referohet strukturës së përfitimeve të vlefshme (ose jo të vlefshme) nga shteti, tregu, shoqëria civile dhe familjet ose nëpërmjet një kombinimi të këtyre agjensive, individ/familje për të zvogëluar humbjen shumë-dimensionale.

Politika sociale ka të bëjë me drejtimet për të ndryshuar, për të mirëmbajtur ose krijuar kushte të jetesës që janë të favorshme për mirëqenien sociale. Në këtë mënyrë politika sociale është pjesë e politikave publike që kanë të bëjnë me çështjet sociale si aksesimi publik i programeve sociale. Qëllimi i politikës sociale është të përmirësojë mirëqenien sociale dhe të njohë nevojat njerëzore për arsimim, shëndetësi, strehim, dhe siguri sociale.

Shërbime shoqërore nënkupton tërësinë e shërbimeve që u ofrohet individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë, me burimet që kanë, nevojat e tyre jetësore, për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente apo kronike.

Shërbime shoqërore në komunitet janë të gjitha llojet e shërbimeve shoqërore, publike dhe jopublike, që kryhen në nivel vendor, në territorin që është në juridiksionin e qarkut/bashkisë/komunës.

Shoqëria civile përfshin tërësinë e institucioneve dhe organizatave shoqërore, të cilat avokojnë dhe ndërmarrin veprime në interes të publikut duke bashkëvepruar ndërmjet shtetit, biznesit dhe familjes. Në të përfshihen organizatat jofitimprurëse, sindikatat, grupet fetare, klubet shoqërore, kulturore dhe sportive, shoqatat e profesionistëve, akademikët e studiuesit, institucionet e politikës, organizatat e konsumatorëve dhe klientëve, media, grupet qytetare dhe institucionet fetare.

3.6 Kujdesi Shëndetësor

Strategjia e Barazisë Gjinore në Shëndetësi adreson jo vetëm nevojat e grave dhe vajzave për shëndetin riprodhues, por edhe nevojat e tjera të përgjithshme shëndetësore të tyre dhe përmirësimin e kushteve më të përgjithshme që krijojnë nevoja të ndryshme shëndetësore për femrat dhe meshkujt. Duke qenë të ndërgjegjshëm se gratë, vajzat dhe burrat dhe djemtë ndërmarrin role dhe përgjegjësi të ndryshme në familje dhe në komunitete, lind domosdoshmeria e përfshirjes së nevojave, interesave dhe kontributeve të tyre në hartimin, zbatimin, monitorimin e politikave të programeve dhe projekteve të ndryshme në fushën e shëndetësisë. Gjithashtu, kur flitet për kujdesin shëndetësor, duhen marrë në konsideratë dhe faktorët apo dallimet e mëposhtme:

- a) *Sëmundjet apo problemet shëndetësore nga të cilat gratë dhe vajzat vuajnë për shkak të seksit të tyre.* Këto janë zakonisht situata që lidhen me sistemin riprodhues të femrave. Përhapja e tyre mund të jetë një tregues i rëndësishëm për shëndetin e tyre në një komunitet të caktuar. Në shumë raste këto ndërlikime mund të vijnë nga marrja e kujdesit të papërshtatshëm shëndetësor, përdorimi i praktikave tradicionale të mjekimit apo dhe nga ushtrimi i dhunës.
- b) *Sëmundje apo probleme nga të cilat vuajnë si femrat edhe meshkujt, por që hasen më tepër në njërin nga grupet.* Këto janë situata ku gratë, vajzat apo burrat, djemtë janë më të rrezikuar, si pasojë e dallimeve biologjike të cilat ndërthuren me marrdhëniet e pabarabarta të pushtetit dhe aksesin e pabarabartë ndaj kujdesit shëndetësor. Situata mund të bëhet më e rëndë kur pengohen, veçanërisht gratë, vajzat të marrin shërbimet e nevojshme për të trajtuar ndërlikimet / sëmundjet e mundshme.
- c) *Sëmundje apo probleme që ndeshen te të dyja gjinitë, por që ndikojnë më negativisht apo venë më tepër në rrezik njërin prej tyre.*
- d) *Sëmundje dhe probleme nga të cilat vuajnë të dyja gjinitë, por që ndaj tyre njëra prej gjinive është më pak në gjendje të mbrohet apo kurohet.*

Mosmarrja parasysh e këtyre faktorëve mund të çojë në një situatë ku sistemi i shërbimeve shëndetësore diskriminon gratë, vajzat ose burrat, djemtë. Nëse do t'i referoheshim kuadrin ligjor në Shqipëri, përfshirë edhe konventat e dokumentat ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë, promovohet barazia gjinore dhe nuk lejohet diskriminimi. Në mënyrë të vecantë neni 12 i konventës CEDAW thekson: “Shteti duhet të marrë masat e nevojshme për të zhdukur diskriminimin e grave në fushën e kujdesit shëndetësor, për të siguruar bazuar në drejtësinë ndërmjet burrave dhe grave, akses të njëjtë ndaj shërbimeve shëndetësore përfshi edhe ato që lidhen me Planifikimin Familjar.”

Rekomandime:

1. Hartimi dhe përmirësimi i politikave dhe programeve shëndetësore në mënyrë që ato t'ju përgjigjen dallimeve gjinore dhe nevojave shëndetësore të femrave dhe meshkujve.
2. Rritja e njohurive dhe të kuptuarit e shëndetit të femrave dhe meshkujve, si dhe të nevojave të tyre shëndetësore
3. Mbështetja dhe të garantimi i aksesit të plotë dhe të barabartë në të gjitha nivelet e shërbimit shëndetësor për gratë, vajzat dhe burrat, djemtë si dhe sigurimi i dhënies së shërbimeve efektive shëndetësore për ta.
4. Mbështetja e dhënies së shërbimeve efektive shëndetësore për gratë, vajzat dhe burrat, djemtë, si dhe promovimi i shëndetit të mirë, nëpërmjet masave parandaluese dhe zvogëlimit të faktorëve të rrezikut në shëndetin e grave dhe vajzave.

3.7 Eliminimi i Sterotipeve Gjinore në Massmedia

Njohja, promovimi dhe zbatimi i barazisë gjinore në media, është domosdoshmëri për çdo shoqëri demokratike, pasi ndikon në rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në të gjitha fushat e jetës, veçanërisht në institucionet vendim-marrëse. Roli i medias është të informojë publikun në mënyrë objektive, të japë dhe mbështesë një imazh të denjë të individit në shoqëri. Media duhet të shkëputet nga gjuha seksiste, pasqyrimi i rremë dhe stereotipet e krijuara mbi rolin e individit në përgjithësi dhe të femrës në veçanti, si në familje edhe në shoqëri.

Integrimi gjinor, si një nga çështjet e rëndësishme të politikave të zhvillimit dhe si një përgjigje ndaj marxhinalizimit të vazhdueshëm të vajzave dhe grave, ka shtruar një sërë kërkesash si në rrafshin politik edhe atë shoqëror, ku një rol të rëndësishëm luan edhe media. Realiteti i shoqërisë shqiptare flet për mungesën e theksuar të barazisë gjinore, moskuptim dhe mospranim të saj dhe është detyrë parësore e mediave që të kthehen në agentë ndryshimi, nëpërmjet përfaqësuesve ndaj figurës shumëdimensionale të gruas dhe paraqitjes së drejtë të aktivitetit të saj në shoqëri.

Rekomandime:

1. Rritja e ndërgjegjësimit dhe cilësisë së informimit të publikut për kapërcimin e stereotipeve gjinore dhe rëndësinë e arritjes së barazisë gjinore në shoqëri, nëpërmjet politikave dhe produkteve të ndryshme në fushën e medias.

3.8 Adresimi i Dhunës në familje

3.8.1 Parandalimi

Parandalimi i dhunës në familje është prioritet i qeverisë. Është thelbësore që çdokush që preket nga dhuna në familje të ketë akses në informacionin e nevojshëm dhe këshillim dhe që profesionistët të dinë si t'u përgjigjen shenjave të hershme të dhunës. Politikat në fushën e parandalimit orientojnë:

1. Parandalimin e dhunës në familje nëpërmjet ndryshimit të qëndrimeve të popullsisë, dhe sidomos të të rinjve;
2. Edukimin i popullsisë dhe fushata ndërgjegjësimi
3. Dhënien e shpejtë të ndihmës për të gjithë viktimat e dhunës në familje për të parandaluar përsëritjen e dhunës;
4. Këshillimin dhe dhënien e informacionit për të gjithë viktimat se si të marrin shërbimet mbështetëse dhe mbrojtje ligjore;
5. Parandalimin e dhunuesve, ku është e mundur, nga përsëritja e veprimeve të dhunshme.

Rekomandime:

1. Edukimi e fëmijëve dhe të rinjve në shkolla në mënyrë të tillë që brezat e ardhshëm të dinë se çfarë janë marrëdhëniet e shëndetshme, janë të informuar që dhuna në familje është krim dhe është e papranueshme.
2. Ndjekja në udhëzimeve të MASH për organizimin e veprimtarive edukative dhe ndërgjegjësuese në të gjitha nivelet e mësimdhënies, qoftë në shkollë qyteti, rrethi ose qarku, për sensibilizimin dhe parandalimin e të gjitha formave të dhunës të fëmijët.
3. Përmirësimi i kurrikulave mësimore, teksteve shkollore dhe teksteve jashtëshkollore në fusha të ndryshme të studimit.
4. Edukimi i publikut të gjerë mbi seriozitetin e problemit të dhunës në familje dhe në përqëndrimin e vëmendjes në dhunuesit.
5. Organizimi i fushatave publicitare në mënyrë të vazhdueshme. Informacioni për viktimat duhet të zhvillohet më tej në mënyrë të tillë që hollësitë rreth ndihmës dhe mbështetjes së ofruar nga

organizma të ndryshme janë lehtësisht të aksesueshme për çdokënd që i kërkon ato.

6. Të gjithë profesionistët dhe stafi, veçanërisht në shërbimet shëndetësore/sociale dhe sektorin e arsimit, si dhe ata në sektorë të tjerë duhet të kenë udhëzimet e duhura dhe trainimin për t'i aftësuar të identifikojnë viktimat e abuzimit herët dhe të ofrojnë ndihmë dhe mbështetje.
7. Vazhdimi i eksperimentimit të shërbimit psikologjik në zonat urbane, planifikimin e trainimeve të mësuesve, veprimtarive monitoruese dhe vlerësuese të shërbimit psikologjik dhe fuqizimin e rrjetit të specialistëve në nivel kombëtar
8. Zhvillimi i udhëzuesve të praktikave të mira, materiale apo manuale burimore nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe koordinimi nga Ministria e Punës, Mbështetjes Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
9. Bashkërendimi i zhvillimit të materialeve burimore me OJF-të e specializuara
10. Zhvillimi i projekteve që synojnë dhunuesit për t'i ndihmuar ata të pranojnë përgjegjësinë për veprimet e tyre dhe të ndryshojnë sjelljet e tyre.

3.8.2 Mbrojtja dhe Drejtësia

Është vitale që viktimat e dhunës dhe abuzimit të kenë akses në informacionin për mbrojtjen nëpërmjet legjislacionit penal dhe civil dhe që ato të marrin përgjigje pozitive nga qeveria, policia dhe organizmat e ndryshme të drejtësisë penale. Politikat në fushën e mbrojtjes dhe të drejtësisë duhet të orientohen në këto drejtime:

1. Sigurimi i të gjithë atyre që preken nga dhuna në familje dhe përgjegjësia e dhunuesve para ligjit për veprimet e tyre.
2. Sigurimi i një përgjigjeje të qëndrueshme dhe efektive të policisë për çdo incident të raportuar të dhunës në familje.
3. Përfshirja e viktimave të dhunës në familje në procedurat e mbrojtjes së dëshmitarit, kur është rasti.
4. Aplikimi i dënimeve dhe sanksioneve që i përgjigjen dhunës në familje
5. Mundësimi që viktimat të mos hezitojnë të lidhen me organet e mbrojtjes dhe të drejtësisë për arsye të mënyrës se si trajtohen në fazat e ndryshme të procesit të drejtësisë.
6. Të bëjnë të mundur që legjislacioni civil dhe penal të ofrojë mbrojtjen maksimale për të gjithë viktimat në mënyrë të tillë që të mos përsëritet dhuna në familje.
7. Ndërgjegjësimi për ligjin e dhunës në familje.

Rekomandime:

1. Organizmat e drejtësisë penale njohin nevojën për të intensifikuar përpjekjet e tyre që viktimave t'u jepet mbrojtja e duhur dhe dhunuesit të përgjigjen para ligjit për veprat e tyre si dhe të rrisin besimin e publikut në shërbimet që ato ofrojnë.
2. Informacioni për legjislacionin civil dhe atë penal si dhe procedurat gjyqësore të jetë vazhdimisht i disponueshëm.
3. Përcaktimi i aktorëve të sistemit të drejtësisë që do të merren me rastet e dhunës në familje. Ngritja e njërive/sectorëve/seksioneve që do të merren me çështje të dhunës në familje pranë institucioneve përkatëse.
4. Trainimi i punonjësve të gjyqësorit mbi dhunën në familje dhe ekzistenca e masave të vecanta për viktimat.
5. Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe konsolidimi i lëndës së barazisë gjinore dhe dhunës në familje në kurrikulën e Shkollës së Policisë.
6. Ndërtimi, në partneritet midis organizmave të ndryshme të gjyqësorit dhe organizatave joqeveritare, i një programi trainimi për gjykatësit.

7. Ndarja e vazhdueshme e informacionit të duhur midis gjykatave civile dhe penale.
8. Rishikim për të identifikuar mësimet e nxjerra dhe për të përmirësuar punën e organizmave të ndryshme.

3.8.3 Mbështetja Sociale

Viktimat duhet të kenë akses në një gamë shërbimesh mbështetëse nga organizmat të ndryshme. Politikat në fushën e mbështetjes sociale duhet të orientohen në drejtimet e mëposhtme:

1. Rritje e mundësive të akomodimit, me më shumë ndihmë për të mbështetur viktimat të qëndrojnë në shtëpitë e tyre nëse është e mundur, strehëza dhe shërbime riakomodimi, si dhe informacion dhe këshillim të përmirësuar.
2. Ndihmë për viktimat që kanë lënë ose dalë nga një marrëdhënie e dhunshme për të rindërtuar jetën e tyre.
3. Mbështetje fëmijëve dhe të rinjve të prekur nga dhuna në familje
4. Dhënie e informacionit për çdokënd të prekur nga dhuna në familje nëpërmjet organizmave të ndryshme të specializuara për këtë problem.

Rekomandime:

1. Vendosja e një linje 24-orëshe ndihmuese që viktimat të kenë mundësi të raportojnë dhe të marrin mbështetjen e duhur dhe të shpejtë.
2. Përmirësimi i bashkëpunimit dhe ndarjes së informacionit midis agjensive të ndryshme. Ky lloj bashkëpunimi duhet të shoqërohet me formulimin e një sërë aktesh të cilat do të mbështesin shërbimet, si akte të shërbimeve të përkujdesit ndaj fëmijëve, akte të shërbimeve sociale, akte të policisë, shërbime të shëndetit në nivel lokal dhe akte të shërbimeve speciale shëndetësore në nivel lokal. Krijimi i një sistemi koordinimi është mundësia e vetme për të krijuar një rutinë të mirë midis institucioneve dhe organizatave të cilat punojnë kundër dhunës në familje.
3. Zgjerimi i shërbimeve mbështetëse për strehimin e viktimave në strehëza.
4. Puna dhe dhënie e fondeve për organizatat që japin shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre.
5. Zhvillimi i shërbimeve për të identifikuar dhe mbështetur fëmijët dhe të rinjtë që preken nga dhuna në familje.

KREU 4

LLOGARIDHËNIA

1. Zbatimi

Për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje, autoriteti përgjegjës është Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, e cila ka si qëllim të nxisë barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e gruas në jetën e vendit.

Institucione të tjera përgjegjëse për zbatim janë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, me institucionet në vartësi të tyre.

Në procesin e zbatimit të strategjisë një rol të rëndësishëm kanë organet e qeverisjes vendore. Bashkëpunimi midis MPÇSSHB dhe pushtetit vendor do të realizohet nëpërmjet rrjetit të pikave të kontaktit në Prefektura dhe Bashki. Ka filluar bashkëpunimi për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve institucionale të rrjetit në Prefekturat dhe Bashkitë.

2 – Monitorimi

Për monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje do të jenë përgjegjës:

1. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore, i cili do të ngrihet me Vendim të Këshillit të Ministrave, do të kryesohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe do të përbëhet nga zv/ministrat e ministrive të linjës, përfaqësues të shoqatave dhe grupeve të interesit dhe të botës universitare.
2. Sekretariati Teknik për Monitorimin e Strategjisë së Barazisë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje, pranë MPÇSSHB, i cili ndjek zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
3. Komisionet e Shanseve të Barabarta në nivel Bashkie.

Detyrat e këtyre organizmave do të përcaktohen në vendime të Këshillit të Ministrave.

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE dhe Kundër dhunës në familje PLANI I VEPRIMIT

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështrirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
Qëllimi I Forcimi i mekanizmave ligjorë dhe insti-tucionalë mbrojtës me qëllim siguri-min e baraz-isë gjinore në Shqipëri.	Objektiv 1.1. Forcimi i mekaniz-mave qe-veritarë në nivel qendror dhe vendor, me qëllim zbatimin dhe monitorimin e strategjisë.	1.1.1. Ngritja e struk-turave të reja, konkretisht: - Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore (KKBGJ); - Sekretariati Teknik (për moni-torimin e strat-egjisë); - Komisionet e Shanseve të Barab-arta (në nivel Bashkie)	MPÇSSH; Këshilli i Mini-strave MPÇSSH Ministria e Brendshme, Bashkitë	2 (dy) muaj pas miratimit të Strategjisë Brenda gjashtë mu-jorit të parë të 2008 Deri në fund të vitit 2008	Nuk ka efekt financiar Të përlloga-ritet	Vonesat e mundshme të VKM për ngritjen e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, mund të sjellin vonesa dhe në sta-bilizimin e organizmave të tjerë	Organizmat e ngritur; Përshkrimi i qartë i detyrave dhe përgjegjë-sive për secilin organizëm. Fillimi i funk-sionimit të tyre.	MPÇSSH DSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanimizat monitorues dhe Vlerësues
	Objektiv 1.2. Rishikimi i legjislacionit nga këndvështrimi gjinor në përputhje me standartet ndërkombëtare.	1.2.1 Rishikimi i Ligjit nr. 9198 dt. 01.07.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri “ me qëllim sigurimin e një mbrojtjeje më efektive ndaj shkeljeve të barazisë gjinore.	Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, MPÇSSHBB OSBE, PNUD, Këshilli i Ministrave, Kuvendi.	Deri në fund të vitit 2007	Nuk ka efekt financiar	Shtyrja e afateve kohore për miratimin e përmirësimeve në lidhje me Ligjin për Barazinë Gjinore	Draft ligji i përgatitur; Miratimi dhe botimi në fletoren zyrtare	KKBGJ Sekretariati Teknik Drejtoritë përkatëse pranë MPÇSSHBB
		1.2.2. Plotësimi i kuadrit nënligjor të barazisë gjinore, pas miratimit të Ligjit të ri për Barazinë Gjinore, me synim bërijen e tij të zbatueshëm.	Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, MPÇSSHBB OSBE, PNUD, Këshilli i Ministrave, Kuvendi.	Janar – Qershor 2008	Nuk ka efekt financiar	Shtyrja e afateve kohore për miratimin ligjit, mund të ndikojë dhe në afatin e vendosur për plotësimin e kuadrit nënligjor. Po kështu, mund të ketë dhe shtyrje të miratimit të përmirësimeve	Aktet nënligjore të përgatitura, Miratimi dhe botimi në fletoren zyrtare	KKBGJ Sekretariati Teknik Drejtoritë përkatëse pranë MPÇSSHBB

Qëllimet strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që duhen ndërmarrë	Institucionet përgjegjëse dhe partneret	Koha e realizimit	Burimet/buxheti 000/Lekë	Supozimet/vështirësitë	Treguesit e monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe vlerësues
		1.2.3. Përmirësimi ligjor në Ligjin nr.7703 dt 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore”	Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, MPÇSSHBB Këshilli i Ministrave, Kuvendi. MF ISSH Organizma ndërkombëtare Donatorët	Gjatë vitit 2010	Nuk ka efekt financiar	Shtyrja e afateve kohore për miratimin e përmirësimeve	Ndryshimet e përgatitura. Miratimi dhe botimi në fletoren zyrtare	KKBGJ Sekretariati Teknik Drejtoritë përkatëse pranë MPÇSSHBB
		1.2.4. Ndryshimi në paragrafin nr. 1 të Nenet 104 të Kodit të Punës së RSH, lidhur me lejen e shtatëzanië – periudha 35 ditore para lindjes	Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, MPÇSSHBB Këshilli i Ministrave Organizma ndërkombëtare Donatorët	Gjatë vitit 2009	Nuk ka efekt financiar	Shtyrja e afateve kohore për miratimin e ndryshimit.	Ndryshimet e përgatitura dhe miratimi e botimi në fletoren zyrtare	KKBGJ Sekretariati Teknik Drejtoritë përkatëse pranë MPÇSSHBB

Qëllimet strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që duhen ndërmarrë	Institucionet përgjegjëse dhe partnere	Koha e realizimit	Burimet/ buxheti 000/Lekë	Supozimet/ vështirësitë	Treguesit e monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe vlerësues
		1.2.5. Zbatimi i Ligjit Nr.9131, datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”, në lidhje me “paraqitjen e nëpunësit”	Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, MPCSSHB Këshilli i Ministrave Organizma ndërkombëtare Donatorët	Janar - Qershor 2008	Nuk ka kosto financiare	Moskuptimi nga ana e vetë institucioneve, i rëndësishëm që ka përgatitja e rregullorëve.	Rregullat e përgatitura në bazë të ligjit; Zbatimi i rregullores së brendshme të institucioneve	KKKBGJ Sekretariati Teknik Drejtoritë përkatëse pranë MPCSSHB
	Objektiv 1.3. Ndërgjegjësimi i opinionit publik, sidomos i grave dhe vajzave të reja, lidhur me të drejtat ligjore që atyre iu takojnë.	1.3.1. Përkthimi zyrtar dhe botimi i konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, veçanërisht rimbotimi i Konventës CEDAW, protokollit shtesë, si dhe dokumentave të tjera ligjore në përputhje me legjislationin e BE	Ministritë e linjës, MPCSSHB OJF-të, Organizatat Ndërkombëtare	2007-2008	Të përllogarit	Procedurat e tejzgjatura për zyrarizimin e përkthimeve mund të ndikojnë në afatet kohore	Konventat e përkthyer dhe të botuara, Numri i botimeve zyrtare të shpërndara; d lista e institucioneve/ rretheve ku janë shpërndarë botimet.	KKKBGJ Sekretariati Teknik Drejtoritë respektive në Ministritë e përfshira Organizata që punojnë në fushën e të Drejtave të Njeriut.

Qëllimet strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që duhen ndërmarrë	Institucionet përgjegjëse dhe partnere	Koha e realizimit	Burimet/buxheti 000/Lekë	Supozimet/vështirësitë	Treguesit e monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe vlerësues
		<p>1.3.2. Organizimi i Fushatave Sensibilizuese “Të drejtat e grave janë të drejta njerëzore”; sensibilizimi në lidhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.</p>	<p>Ministritë e linjës, MPCSSHB DSHB OJF-të, Organizatat Ndërkombëtare</p>	2008 - 2010	Të përllogaritë në bazë të numrit të trajnimeve që do zhvillohen në 12 prefekturat e vendit	Mungesa e burimeve mund të cojë në mos mbulimin e plotë të të 12 prefekturave	12 trajnimet 4 ditore në 12 prefekturat e vendit, Lista e pjesëmarrësve; Materialet e shpërndara.	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB, Drejtoritë respektive në Ministritë e përfshira Organizata që punojnë në fushën e të Drejtave të Njeriut.
<p>Qëllimi 2 Fuqizimi i gruas nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së saj në vendimmarrje.</p>	<p>Objektiv 2.1. Rritja e numrit të grave dhe vajzave në vendimmarrjen politike</p>	<p>2.1.1. Rishikimi i ligjit elektoral dhe mbështetja e veprimëve që synojnë rritjen e numrit të grave dhe vajzave në parlament apo në strukturat vendimmarrëse në nivel lokal.</p>	<p>Partitë politike Parlamenti Media OJF dhe rjetet e grave dhe vajzave MPCSSHB</p>	2008-2010	30,000	Shtyrja e afateve kohore për miratimin e ndryshimeve në ligj Klima e ashpër politike mund të frenojë iniciativën e grave dhe vajzave, për t'u	Draft ligji i përgatitur Ligji i miratuar dhe i botuar në fletoren zyrtare Kuota e cituar Trajtimi i diskriminimit me bazë gjinore në	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB,

Qëllimet strategjike	Objektivat Specifike	Vepimet që duhen ndërmarrë	Institucionet përgjegjëse dhe partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ buxheti 000/Lekë	Supozimet/vështirësitë	Treguesit e monitorimit	Mekanimizat monitorues dhe vlerësues
						përfshirë në vendimmarrje, pavarësisht kuotës së vendosur.	politikën shqiptare jo si një problem shqetësues vetëm për gratë dhe vajzat, por edhe si një paaftësi e partive politike dhe më gjerë, e të gjithë shoqërisë shqiptare.	
	Objektiv 2.2. Rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare për pjesëmarrjen aktive të grave dhe vajzave në politikë.	2.2.1. Nxitja e prurjeve të vlerave të reja në jetën politike, formave të reja të trajtimit të nevojave të shoqërisë, si dhe rritjes së solidaritetit dhe barazisë në ndërtimin e një shoqërie më demokratike e më	Media OJF dhe rrjetet e grave dhe vajzave MPÇSSHB	2007 - 2010	10.000	Vështirësi të lidhura me mentalitetin, veçanërisht kur bëhet fjalë për prurje të vlerave apo formave të reja. Vështirësi në aplikimin e koncepteve për shkak të	Numri i grave dhe vajzave në forumet drejtuese të Partive Politike si dhe atyre të zgjedhura në Kuvendin e Shqipërisë Mjedisi i përmirësuar për gratë dhe	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB,

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		paqësore.				mungesës së burimeve dhe kapaciteteve përkatëse.	vajzat pjes-marrëse në politikë Manifestimi i vlerave të solidaritetit, vëçaritë, në brezin e ri. Modelet e reja në politikë; Mënyra e komunikimit transparenca ndaj publikut, Numri i personave të trajnuar për hartimin e politikave.	
Qëllimi 3 Fuqizimi ekonomik i gruas dhe rritja e mundësive të saj për punësim	Objektiv 3.1. Rritja e numrit të projekteve apo programeve të cilat nxisin	3.1.1. Studim mbarëkombëtar mbi vendin që zenë gratë dhe vajzat në tregun formal të punës; si	MPCSSH Sherbimi Kombëtar i punësimit OJF-te INSTAT	2007-2010	Të përlogarit	Pamjaf-tueshmëria e burimeve mund të çojë në kufizimin e metodave të studimit apo dhe	Dy studimet e realizuara Botimi dhe shpërndarja e studimeve Gjetjet dhe	KKBGJ, Sekretari-ati Teknik, KSHB, OJF dhe part-nerë

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështrirësiti	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
dhe kualifikim profesional.	formimin dhe grave min e vajzave, si dhe shtrirja e këtyre projekteve edhe në zonat rurale.	dhe mbi vendin që zenë gratë dhe vajzat në punësimin informal				në shtrirjen e tyre në mbarë vendin.	rekomandimet për përmirësimin e politikave të punësimit dhe fuqizimit ekonomik të grave dhe vajzave.	privatë të interesuar në fushën e punësimit.
		3.1.2. Zgjerimi i shërbimit të punësimit për gratë dhe vajzat në nevojë dhe rritja e përfshirjes së këtij targeti në programet e nxitjes së punësimit dhe formimit prof.	MPCSSHB Partnerët ndërkombëtarë OJF Biznesi	2007-2010	500.000	Mungesa e shërbimeve të tjera sociale, mund të pengojë gratë dhe vajzat të punësohen	Rritja e numrit të grave dhe vajzave të kualifikuara dhe të punësuara.	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB, OJF, Grupet e interesit
		3.1.3. Hartimi i politikave të punësimit me kohë të pjesshme (part-time) për gratë në nevojë.	MPCSSHB SHKP Donatorët Qeveria OJF Punëdhënësit	2007-2010	20.000	Këto politika mund të rrezikojnë të kthehen në dominante për punësimin e	Numri i grave në nevojë partituese nga punësimi me kohë të pjesshme	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB, OJF-të Aktorët e

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanismat monitorues dhe Vlerësues
						grave dhe vajzave në përgjithësi.		përfshirë në fushën e punësimit
		3.1.4. Ndërtimi i një sistemi të ri informacioni në nivelin qendror dhe vendor, me qëllim sigurimin e një qasjeje dhe aksesit të barabartë të grave dhe vajzave në marrjen e informacionit publik mbi të drejtën për punësim dhe legjislacionin e punës, info mbi tregun e punës, aksesin ndaj edukimit dhe formimit profesional, aksesin ndaj pronës dhe kredisë.	MPÇSSHB Shërbimi Kom-bëtar i Punësimit Institucionet bankare OJF-të	2007-2010	Të përllogarit	Vështirësia në përdorimin e teknikave të ndryshme për marrjen e informacionit (psh interneti) mund të pengojë në mbulimin e gjithë territorit me informacionin përkatës	Numri i personave të trajnuar dhe informuar; Web site i ndërtuar, Numri i botimeve të shpërndara	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB, OJF-të Aktorët e përfshirë në fushën e punësimit

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanimizat monitorues dhe Vlerësues
		3.1.5. Ndërtimi i programeve me subvencionim të pagës për kategori të përjash-tuara grash, gratë kryefamiljare, gra e vajza të trafikuarra e te dhunuara, afër moshës së pensionit, invalide ose me aftësi të kufizuara	MPCSSH Donatorët Qeveria OJF Operatorë privatë	2007-2010	200.000	Mungesa e transparencës dhe e kontrollit mund të cojë në mos përfitim mit realisht të grupeve të synuara.	Numri i grave dhe vajzave në nevojë që përfitojnë nga programi i subvencionim. të pagës	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB,
	Objektiv 3.2. Rritja e numrit të grave dhe vajzave sipërmarrëse përmes dhënies së mundësive për më shumë akses në pronë, kapital dhe kreditime	3.2.1. Mbështetja e iniciativave për ngritjen e programeve të kreditimit të grave dhe vajzave , nëpërmjet pilotimit në dy zona, me qëllim nxitjen e sipërmarrjes.	Ministria e Ekonomisë MPCSSH OJF SHSSH Donatorët Agjensi kreditimi bankat	2007 - 2010		Mentaliteti në zonat e synuara, mbi aksesin e grave dhe vajzave në prona dhe kreditime, mund të pengojë ose tjetërsojë fokusin e ndërhyrjes.	Histori të suksesshme të grave sipërmarrëse në dy zonat e pilotuara; Numri i aktiviteteve të suksesshme të realizuara nga	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB, Agjensi kreditimi Bankat Shoq Civile

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanismat monitorues dhe Vlerësues
							gratë dhe vajzat e zonave sub-urbane dhe rurale, që kanë përfituar nga programet e kreditimit	
		<p>3.2.2. Nxitja e zhvillimit të bizneseve të vogla të menaxhuara nga gratë dhe vajzat, përmirësimi i përfitimeve të tyre nëpërmjet: programeve të rigjallërimit intensiv, këshillave financiarë dhe të marketingut, trajnimeve për menaxhim, përmirësimin e produkteve, rritjen e burimeve njerëzore.</p>	<p>MPÇSSHB Donatorët Dhomat e Tregëtisë OJF-të</p>	2008 -2010		<p>Mungesa e burimeve mund të çojë në mos realizimin e plotë të programeve të planifikuara.</p> <p>Mendësia e krijuar në mënyrën e organizimit të bizneseve të vogla mund të pengojë rihuturimin e burimeve, kryesisht njerëzore</p>	<p>Rritja e numrit të bizneseve të vogla të menaxhuara nga gratë dhe vajzat; Fuqizimi i bizneseve ekzistuese. Numri i pjesëmarrësve në programet dhe trajnimet përkatëse Rritja e shijeve të produkteve (cilësia e përmirësuar)</p>	<p>KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB, Shoqëria civile</p>

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
Qëllimi 4 Promovimi i aksesit të barabartë të grave dhe vajzave në arsimin cilësor;	Objektiv 4.1. Përmirësimi i programeve shkollore që promovojnë barazinë gjinore, si dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në mësimdhënie, planifikimin dhe menaxhimin e arsimit.	4.1.1. Trajtimi i gjinisë nëpërmjet temave të veçanta në lëndë përkatëse, si dhe nëpërmjet futjes së lëndëve të veçanta mbi këtë çështje, që në hartimin e kurrikulave mësimore universitare	MASH Instituti i Kurrikulave Universitetet Katedrat	2008-2010	35.000	Mungesa e interesit nga Departamente të veçanta, si pa-sojë e mungesës së informacionit mbi përfshirjen e çështjeve të përkatësive gjinore në të gjitha fushat (gender = cross cutting issue)	Kurrikulat e përmirësuara	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB, Instituti i Studimeve Gjinore
		4.1.2. Përmirësimi dhe rishikimi në mënyrë të vazhdueshme i programeve shkollore dhe teksteve mësimore, për stereotipet gjinore.	Instituti i Kurrikulave, Instituti i Studimeve Gjinore OJF-të eksperte të fushës	2007-2010	Nuk ka kosto	Mos kushtimi i vëmendjes së duhur për rishikimin në mënyrë të vazhdueshme.	Programe shkollore të rishikuara nën perspektivën e barazisë gjinore	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB, MASH

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanismat monitorues dhe Vlerësues
		<p>4.1.3. Caktimi i analizës gjinore si një nga kriteret e rëndësishme për përzgjedhjen e teksteve më të mira për botim (teksti i mësuesit, nxënësit dhe materiale të tjera didaktike ndihmëse; guidat për mësues, modulet e trainimit, si dhe metodologjinë e dhënies së trainimeve për mësues.)</p>	Instituti i Kurrikulave MASH Instituti i Studimeve Gjinore	2007-2010	Nuk ka kosto	Mungesa e kapaciteteve mund të çojë në mos përdorimin saktë të analizës gjinore si kriter përzgjedhës.	Sistem dhe procedura të qarta për analizën gjinore në përzgjedhjen e teksteve	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB, Komisionet e përzgjedhjes së teksteve
	<p>Objektiv 4.2. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve arsimore për të integruar çështjet dhe konceptet e</p>	<p>4.2.1. Përgatitja e moduleve të trainimit të mësuesve ku integrohet gjinia si temë specifike dhe ku të përfshihet dialogu prind-mësues</p>	MASH, Instituti i studimeve pedagogjike dhe kurrikulave Instituti i Studimeve	2007-2008	Të përlogarit		Modulet e përgatitura.	KKBGJ, Sekretariati Teknik,

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanismat monitorues dhe Vlerësues
	barazisë gjinore në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin në arsim;		Gjinore OJF që japin trajnime					
		4.2.2 Trajnimi imësuesve të ciklit të ulët dhe atij të mesëm në këtë drejtim.	MASH DA OJF që japin trajnime	2008-2009	Të përlogaritet	Mungesa e burimeve mund të cojë në mos mbulimin e gjithë vendit	Numri i mësuesve të trajnuar në 12 Prefektura Politika të qarta dhe efikase pro-gjinore në arsim	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB
		4.2.3. Rritja e numrit të grave dhe vajzave të përfshira në menaxhimin e shkollave nëpërmjet emërimit të tyre në pozicione drejtuese dhe në arranzhime të tjera institucionale	MASH, MD PI Drejtoritë arsimore	2007-2010		Mentaliteti egzistues mund të bëhet pengesë për arrijjen e këtij objekti në zona të caktuara	Numri i grave dhe vajzave të emëruara rrishtazi në menaxhimin e shkollave në 12 prefekturat	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanimizat monitorues dhe Vlerësues
	Objektiv 4.3. Përmirësimi i qëndrimeve shoqërore dhe kulturore të komuniteteve dhe familjeve që promovojnë vlerat dhe rëndësinë e arsimit të vajzave duke përfshirë rolet dhe kontributet e grave dhe vajzave në zhvillim.	4.3.1. Studim mbarëkombëtar për qëndrimet shoqërore dhe kulturore në lidhje me arsimimin e vajzave dhe pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në vendim-marrje në arsim.	MASH OJF PL Donatorët	2007-2008	5.000	Burimet e pamjaftueshme mund të çojnë në kufizimin e zonave të mbuluara	Studimi i përfunduar dhe i botuar; Rezultatet dhe rekomandimet e dhëna	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB
		4.3.2. Ndërmarrja e një fushate ndërgjegjësimi bazuar në të dhënat e studimit, për shkollat, prindërit dhe komunitetet, sidomos	MASH, OJF-të dhe institute të specializuara studimore Media	2007-2010	10.000	Jo gjithmonë janë vetëm mentaliteti dhe mungesa e informacionit, faktorët që influencojnë ndërrprejjen e	Numri i posterave, fletëpalosjeve dhe bisedave të realizuara në 12 prefektura	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		në zonat e largëta dhe rurale, mbi rëndësinë dhe përftimet e arsimit të vajzave duke përfshirë dhe vazhdimin e arsimit për vajzat përtej arsimit fillor.				arsimit tek vajzat. Mungesa e infra-strukturës sjell gjithashtu ndërprerjen e arsimit	Numri në rritje i vajzave që vazhdojnë arsimin përtej arsimit fillor në zonat rurale	
		4.3.3. Përfshirja e mësuesëve dhe mësuesëve në fushatën e ndërgjegjësimit shtëpi më shtëpi, në zonat rurale dhe të largëta për arsimimin e vajzave dhe grave.	MASH DAR Stafi pedagogjik, komunitetet dhe prindërit Shoqatat e mësuesëve	2007-2010	15.000	Vështirësia e infrastrukturës në zonat e largëta mund të bëhet pengë për monitorim të saktë	Numri i mësuesve të angazhuar në fushatën e ndërgjegjësimit në 24 Bashki Numri i shtëpive dhe fshatrave të vizituar për këtë qëllim.	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanimizat monitorues dhe Vlerësues
	Objektiv 5.2. Shtrirja në të gjithë vendin e shërbimeve komunitare për gratë dhe vajzat me probleme sociale	5.2.1. Zgjerimi i rrjetit të shërbimeve komunitare nëpërmjet pilotimit në tre zona, për gratë dhe vajzat në nevojë, vecanërisht për ato rome dhe egjiptjane, si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së funksionimit të tyre.	MB MPCSSHB OJF-të Donatorët	2009	Të perllogaritet		Numri i shërbimeve të reja të ngritura në 3 zona Numri i grave dhe vajzave në nevojë që përfitojnë nga këto shërbime. Informacioni statistikor perioidik	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB
		5.2.2 Rritja e aksesit për kategoritë e grave dhe vajzave në nevojë për t'u informuar mbi bazën ligjore, dokumentat që sigurojnë mbrojtjen sociale si dhe institucionet publike dhe private që ofrojnë këto shërbime	MPCSSHB SHSSH MF/ISSH Fakulteti i Sociologjise OJF-të	2008-2010	Të perllogaritet	Aksesi i ulët ndaj Teknologjisë së re të Informacionit Mungesa e infrastrukturës së informacionit në zonat e largeta të vendit (rurale/malore)	Numri i personave që marrin informacion Numri i botimeve sensibile Numri i personave të trajnuar	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhën Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
Qëllimi 6 Përmirësimi i shëndetit të popullsisë duke rritur përgjigjen e sistemit shëndetësor ndaj nevojave të veçanta shëndetësore të grave/burrave dhe vajzave djemve.	Objektiv 6.1. Hartimi dhe përmirësimi i politikave dhe programeve shëndetësore në mënyrë që ato t'ju përgjigjen dallimeve gjinore dhe nevojave shëndetësore të grave/burrave dhe vajzave djemve.	6.1.1. <i>Rishikimi i Skemës e Sigurimeve Shëndetësore me fokusin:</i> 1. Grupdiagnozat që lidhen direkt me shëndetin riprodhues. 2. Të drejtën e përfitimit të barnave me Rimbursim nga bashkëshorti/ bashkëshortja, edhe kur ato/ata nuk janë në marrëdhënie pune; (kur njëri nga ata është i siguruar)	Instituti Sigurimeve Shëndetësore (ISKSH); Instituti i Shëndetit Publik; Ministria e Shëndetësisë Pushteti Qendror; Pushteti Lokal; Shoqata e Pacientëve OJF e Shëndetit	2010	Nuk ka kosto	Vonesa në miratimin e skemës së rishikuar. Përfshirja e grupdiagnozave Lista e barnave me rimbursim;	Skema e Sigurimeve shëndetësore e rishikuar; Përfshirja e grupdiagnozave Lista e barnave me rimbursim;	MSH KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB
		6.1.2. Sigurimi i vaksinimit falas kundër Human Papilloma Virus (HPV) si një mjet shumë efikas në reduktimin e Kancerit Cervikal te femrat.	MSH ISHP Operatorët privat Shoqatat ISKSH	2010	Për t'u përlllogarit	Nevojitet paraprija e këtij vaksinimi me një fushatë ndërgjegjësimi dhe edukimi të vajzave mbi kujdesin për ShR.	Numri i femrave të vaksinuara	MSH ISHP KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështrirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
	6.2. Rritja e njohurive dhe të kuptuarit e shëndetit të femrave dhe meshkujve, si dhe të nevojave të tyre shëndetësore.	6.2.1. Mbledhja dhe raportimi vjetor i të dhënave të ndara sipas gjinisë për të ndjekur treguesit e shëndetit për femrat dhe meshkujt	MSH ISHP INSTAT	2008 dhe në vazhdim	Të perilogarit	Mungesa e një modeli të përbashkët për mbledhjen e të dhënave të disagreguara, mund të cojë në vështirësi në e përpunimit të tyre	Të dhënat dhe Raporte të disponueshme	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB
		6.2.2. Fushatë e edukimit të popullsisë mbi fertilitetin dhe përgjegjësitë e përbashkëta të burave dhe grave për një shëndet familjar të mirë	Instituti i Shëndetit Publik OJF-të	2007-2010	10000	Burimet e pamjaf-tueshme mund të cojnë në kufizimin e zonave të ndërhyrjes	Numri dhe përmbajtja e mesazheve ndërgjegjësuese; Numri i emisioneve; Mjetet e tjera të përdorura për realizimin e fushatës.	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB MSH

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		6.2.3. Zhvillimi i programeve shkollore mbi ushqyerjen, higjienën dhe planifikimin familjar për djemtë dhe vajzat.	MASH MSH Ekspertët Donatorët OJF	2007-2010	Të llogaritet	Kujdes duhet treguar për të përfshirë të gjitha komunitetet	Programet e zhvilluara, Numri i nxënësve të përfshirë	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB
	Objektiv 6.3. Mbështetja dhe të garantimi i aksesit të plotë dhe të barabartë në të gjitha nivelet e shërbimit shëndetësor për gratë, vajzat dhe burrat, djemtë, si dhe sigurimi i dhënies së shërbimeve efektive shëndetësore për ta.	6.3.1. Mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë për përdorimin e shërbimeve shëndetësore shtetërore dhe private.	MSH Instituti i Shëndetit Publik INSTAT, Organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e shëndetit	2007-2008	Të llogaritet	Mungesa e një baze të dhënash të mëparshme	Baza e të dhënave të ndara sipas gjinisë.	Baza e të dhënave të ndara sipas gjinisë.

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		6.3.2. Sigurimi i arritjes lehtësisht nga gratë dhe vajzave i qendrave apo klinikave shëndetësore, si dhe përshtatja me oraret e tyre të punës.	Pushteti vendor Drejtoritë e Shëndetit Publik në Rrethe	2008-2010			Oraret e klinikave dhe qendrave shëndetësore të përshtatura	MSH KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB
		6.3.3. Vendosja e një sistemi transporti emergjence vecanërisht për gratë, vajzat, si dhe angazhimi i komunitetit për metoda efikase në transportimin e grave/vajzave në spital.	Pushteti lokal Qendrat shëndetësore	2008-2010	Të llogaritet	Pamjaftueshmëria e burimeve mund të çojë në kufizimin e zonave të ndërhyrjes	Sistemi i transportit i vendosur në 24 bashki	MSH KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB
		6.3.4. Angazhimi i burimeve të mjaftueshme për trajnimin e personelit në të gjithë nivelet e sistemit të dhënies së shërbimeve shëndetësore.	MSH dhe institucionet derivate OJF-të	2008-2010			Burimet njerëzore dhe financiare të angazhuara për trajnim	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		6.3.5. Përfshirja e perspektivës gjinore sipëse e kurrikulës së Fakultetit të Mjekësisë dhe të Shkollës së Lartë të Infermierisë.	MASH Fakulteti i mjeksisë Universiteti i Infermierisë Ekspertet	2008 e në vazhdim			Kurrikula e përmirësuar	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB
	Objektiv 6.4. Mbështetja e dhënies së shërbimeve efektive shëndetësore për gratë, vajzat, burrat, djemtë, si dhe promovimi i shëndetit të mirë, nëpërmjet masave parandiluese dhe zvogëlimit të faktorëve të rrezikut në shëndetin e grave dhe vajzave.	6.4.1 Kryerja e fushatave vjetore depistuese (Pap test, mamografi etj) për ekzaminime të domosdoshme që ndihmojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së grave dhe vajzave.	MSH ISKSH ISHP Shërbimet private Donatorët Ekspertet	2007 Gjate gjithë periudhës	Të llogaritet	Kufizimi në burime mund të çojë në ngushtimin e zonave të nderhyrjes	Numri i depistimeve të bëra Numri i zonave të nderhyra	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Vepimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
Qëllimi 7 Përmirësimi i rolit të medias për një mentalitet të ri, që i përgjigjet zhvillimit të kohës, lidhur me barazinë gjinore në shoqëri dhe rritjen e përfaqësimit të grave dhe vajzave në këtë profesion.	Objektiv 7.1. Rritja e ndërgjegjësimit dhe cilësisë së informimit të publikut për kapërcimin e stereotipeve gjinore dhe rëndësinë e arrijës së barazisë gjinore në shoqëri, nëpërmjet politikave dhe produkteve të ndryshme në fushën e medias.	7.1.1. Ndërgjegjësimi për reduktimin e gjuhës seksiste në media dhe promovimi i përdorimit të gjuhës që reflekton parimet e barazisë gjinore.	Shoqatat e gazetarisë Media e shkruar dhe elektronike Instituti i mediave të lira MPCSSHBB Fakulteti i Shkencave Sociale Fakulteti i Gazetarisë OJF	2007 dhe në vazhdimësi	Te llogaritet		Udhëzues i përfunduar; Reduktimi i reklamave ku gratë dhe vajzat trajtohen si objekte seksi; fushatat për informimin e publikut rreth problemeve dhe çështjeve gjinore në Shoqipëri. Minutazhi dhe hapësira në median elektronike dhe të shkruar ; Spot televiziv Krijimi dhe funksionimi i njësive të monitorimit të medias	KKBGJ, Sekretariati Teknik, KSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështrirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
Qëllimi 8.1 Të rritet dhe zhvillohet ndërgjegjësimi i shoqërisë kundër dhunës në familje dhe masave për të ndihmuar viktimat nëpërmjet ndryshimit të qëndrimeve;	Objektivi 8.1.1 Ngritja e strukturave informuese mbi dhunën në familje	8.1.1.1 Ngritja dhe forcimi i zyrave të komunikimit qytetar në nivel lokal	MPL MPCSSHB OJF Media	2007-2010	Nuk ka kosto	Moskuptimi i rëndësishëm së komunikimit me qytetarët	Zyra efi-kase të informimit të publikut	MPL MPCSSHB OJF
		8.1.1.2 Vlerësimi i situatës së dhunës në nivel komunitar për gratë, dhe fëmijët	MPCSSHB OJF Fakulteti i shkencave sociale	2008-2009	5		Argumenta per poli-tikëbërësit në nivel qendror dhe lokal për të ndërmarrë veprime konkrete dhe efi-kase kundër dhunës në familje	MPCSSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.1.1.3 Hartimi dhe realizimi i një strategjie informuese për shkatërrimin e tabuve	OJF Media Fakulteti i shkencave sociale	2010	1.6		Informimi i publikut	OJF MPCSSHB
		8.1.1.4 Ndërmarrja e studimeve për të matur incidencën & prevalencën e fenomenit të dhunës ndaj fëmijëve, grave/vajzave dhe të moshuarve në familje, për të përcaktuar grupe specifike të pasojave shëndetësore.	Ministria e Shëndetësisë, MPCSSHB Fakulteti i Shkencave Sociale ISHP OJF Donatorët	2008 - 2012		Vështirësia e raportimit të dhunës prej të moshuarve.	Publikimi i gjetjeve të studimit/ve.	Vlerësim sasior i rasteve të viktimave të dhunës në familje.
		8.1.2.1.1 Të ngrihet një grup shkencor për rishikimin e kurrikulës	MASH & QKAVP	2008	8	Pak në numër	Mungesa e teknologjisë	MASH IKS Specialistë të dhunës në familje

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
dhuna në familje është e papranueshme dhe të aftësohen të bëjnë zgjedhje të mirë-informuara.								
		8.1.2.1.2 Të përcaktohen standardet për çdo nivel shkollimi dhe edukimi për lëndët e përafërta	MASH, IKS	2008-2010	Nuk ka kosto			MASH
		8.1.2.1.3 Të përcaktohen objektiva specifike për lëndët e edukimit shoqërore dhe qytetare	IKS, QTKA MASH&INSIKS, Shtëpitë Botuese	2008-2010	Nuk ka kosto		Rishikimi i kurrikulës sipas SKZHAP	MASH
	Objektivi 8.1.2.2 Të rishikohen planet mësimore,	8.1.2.2.1 Të rishikohen programet për trajtimin e dhunës në familje sipas cikleve	MASH & OJF MPÇSSHB	2008-2009	Nuk ka kosto		Mungesa e specialistëve për dhunën në familje Mungesa e	MASH

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhën Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
	tekstet shkollore dhe literatura ekstrakurrikulare dhe jashtëshkollore	të edukimit dhe mësimit					bashkëpunimit	
		8.1.2.2.3 Të vendosen në tekste mësimore tema të veçanta për dhunën në familje	MASH & OJF MPÇSSH	2009-2010	3		Hartimi i politikave kundër dhunës në familje	MASH
		8.1.2.2.4 Të vendoset sistemi i moduleve në shkollat e mesme	IKS	2008-2009	Nuk ka kosto		Sjelljet dhe qëndrimet ndaj viktimave të dhunës	MASH
		8.1.2.2.5 Të vendosen në literaturën ekstrakurrikulare tema të caktuar për dhunën në familje	IKS & Shtëpitë Botuese	2008-2010	3		Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit	MASH
		8.1.2.2.6 Të hartohen tekste dhe literaturë mbështetëse	IKS & QKTA	2008-2009	120		Krijimi i specialistëve për dhunën në familje	

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Verësuës
		8.1.2.2.7 Të sigurohen në shkollat e larta profilizime për specialistë dhf –	MASH, DRA UNIVER- ISITETET	2008-2010	Nuk ka kosto			
Qëllimi 8.1.3 Të krijohen kapacitetet njerëzore për trajtimin e dhunës në familje	Objektivi 8.1.3.1 Të krijohet një grup train-erësh kom-bëtarë	8.1.3.1.1 Të krijohet një bërthamë kombëtare e kualifikuar për problemet, e për dhunën në familje	MASH, MP- ÇSSH MSH	2007-2008	8.000		Sasia e cilësia e kapaciteteve të krijuar	MASH, MP&SHB,
		8.1.3.1.2 Të krijohet sistemi vertikal i trainimeve	MASH QKTA	2008-2009	144.000		Rritja e efikasitetit të komunikimit e shërbimit	MP&SHB
		8.1.3.1.3 Të planifikohen trainimet në vazhdimësi	MASH QKTA	2008-2010	Përfshirë në koston e mësipërme		Ndjekja e problemeve nga PL DRA, SHK	MASH, MPÇS&SHB,
		8.1.3.1.4 Të trainohet administrata e të gjithë dikastereve qendrore	MASH, MP- ÇSSH, PV, OJF, MB	2008-2009	48.000			MB, MPÇS&SHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.1.3.1.5 Të trainohen mësuesit e të gjitha niveleve	MASH	2008-2010	1.440.000			MASH, MTKR&S
		8.1.3.1.6 Të trainohet administrata e PL	MASH, MB, PV, MSH, MP- ÇSSH	2008-2010	440.000			OJF
		8.1.3.1.7 Të parashikohen trainime të prindërve fëmijëve e të grupeve vullnetare	MASH	2008-2010	Nuk ka kosto			MPÇS&SHB
	Objek-tivi 8.1.3.2 Krijimi dhe kualifikimi i ekipeve multi-dis-iplinare për të garantuar cilësinë e shërbimit ndaj vik-timave të dhunës dhe individëve që dhunojnë.	8.1.3.2.1 Organizimi i fushatave ndërgjegjëse dhe trajnuese për ofruesit e kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet e këtij shërbimi, përf-shirë mjekët e familjes dhe mjekët specialistë, kryesisht ata pediatër dhe psikiatër.	Ministria e Shëndetësisë, OJF, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale & Shan-seve të Barabarta	2008 – 2010	5.000		1.Fushata ndërgjegjëse dhe kryeja e 2 trajnimeve në 4 zona të Veriut, 4 të Shqipërisë së mesme dhe 4 të Shqipërisë së Jugut.	Shqyrtimi i raporteve vlerësuese nga organizuesit & donatorët.

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhën Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		<p>8.1.3.2.2 Organizimi i trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra si dhe i supervizimit të shërbimeve shëndetësore të ofruara nga stafi mjekësor i Qendrave të kujdesit shëndetësor pranë komunave dhe bashkive. (Identifikimi, trajtimi i rasteve të lehta dhe referimi i rasteve të rënda)</p>	<p>Ministria e Shëndetësisë, OJF, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale & Shansve të Barabarta</p>	<p>2008 – 2010</p>	<p>32.000</p>	<p>Përcaktimi dhe miratimi nga MSH i një numri të konsiderueshëm qendrash shëndetësore që do të përfitojnë prej trajnimeve.</p>	<p>Të dhënat në rritje të numrit të rasteve të identifikuar dhe trajtuara nga stafi i Qendrave të kujdesit shëndetësor.</p>	<p>(4 zona – 2 urbane të ndryshme dhe 2 rurale të ndryshme)</p>
		<p>8.1.3.2.3 Përfshirja e specialistëve të tjerë (jo shëndetësor) punojnës socialë, psikologë etj. në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor</p>	<p>MSH MF OJF</p>	<p>2008 - 2010</p>	<p>80.000</p>	<p>Mungesa e financave të mjaftueshme për të siguruar një numër të konsiderueshëm ekipeve multidisciplinare</p>	<p>Vënia në punë e 4 ekipeve multidisiplinar në Shqipëri që do të trajtojnë viktimat dhe individët që dhunojnë,</p>	<p>Vlerësimi sasior dhe cilësor i pacientëve që kanë përfituar prej ekipeve të ngritura. Vlerësimi i</p>

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		dhe shërbimet e urgjencës në spitale.				në Shqipëri.	(2010).	regjistrave mjekësore dhe dokumentacionit të përdorur prej tyre.
		8.1.3.2.4 Përfshirja në rutinën e punës me viktimat e dhunës në familje të informacionit mbi ekspertizën mjekoligjore, si dhe të raporteve mjekësore dhe psikiatrike apo dhe ndonjë raport tjetër që pacienti kërkon.	MSH MPCSSHB MD OJF	2008-2010	Nuk ka kosto	Mungesa e përgjegjshmërisë së stafit mjekësor dhe indiferenca ndaj dhënies së këtij informacioni.	Rritja e numrit të raporteve mjekësore, psikiatrike të regjistruara edhe nga Gjykata.	
	Objektivi 8.1.3.3 Sisteme për denoncimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimës	8.1.3.3.1 Të sigurohet fushata mediatike për pasojat e dhunës në familje	MPCSSHB Media Pushteti vendor	2009-2010	5.000			MASH, PL

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.1.3.3.2 Të ngrihet shërbimi i informimit për ndërgjegjesimin e viktimave të dhunës në familje e denoncim.	DAR, ZA	2009-2010	10.000			MB, MP-ÇSSH
		8.1.3.3.3 Të përdorin telefonin, e-mail, adresa në internet, literaturë në bibliotekën e shkollës apo lagjes, qytetit	MASH	2008-2010	Nuk ka kosto			
		8.1.3.3.4 Të hartohen kode bashkëpunimi polici, shkollë, pushtet lokal	DRA, SHK	2008-2010	Nuk ka kosto			
Qëllimi 8.2 Kuadri ligjor dhe struktura drejtësie garante për parandalimin	Objektivi 8.2.1 Përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me dhunën në	8.2.1.1. Përgatitja e akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 9669 dt. 18.12.2006	MPCSSHB, MB, MD, MSH	2008 – 2010	Nuk ka kosto	Vonesa të kushtezuara nga mosngritja e strukturave	Kuadri nenligjor i plotësuar	MPCSSHB, shoq. civile, Parlamenti, donatorët

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhën Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
dhe mbrojtjen nga dhuna në familje	familje							
		8.2.1.2. ngritja e strukturave sipas ligjit dhe trajnimi i tyre	MPCSSHB, MB, MD, SHM, SHP, DHKA	Shtator 07 dhe në vazhdim	144	Vonesa për shkak të moskoordinimit, prioritetëve të tjera qeveritare, etj.	Strukturat të ngritura dhe të trajnuara	MPCSSHB, shoq. civile, donatorët
		8.2.1.3 fushatë ndërgjegjësimi lidhur me këtë ligj dhe aktet ndërkombëtare të fushës dhe procedurat	MPCSSHB, MB	Janar-mars 2008	Përfshirë në kostonë të tjera		Nr i botimeve, aktiviteteve dhe mjeteve të informimit të vena në dispozicion qytetarit	MPCSSHB, shoq. civile, anketime
		8.2.1.4. Harmonizimi i ligjeve në fuqi që ofrojnë mbrojtje të gjerë ndaj dhunës në familje. Rishikimi, përgatitja dhe miratimi i		Prill-dhjetor 2008	500			

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		ndryshimeve dhe shtesave ligjore në KC, KF, KP, KPP, KPC dhe ligje të tjera në harmoni me standardet ndërkombëtare (KE, BE, OKB) dhe me ato legjisllacionit të brendshëm.						
		8.2.1.4.a nëgritja e një grupi pune me eksperte dhe me perfaqesues të OJF-ve për identifikimin e nevojave për ndryshim, përgatitjen e ndryshimeve dhe të relacionit përkatës.	MD, MPCSSHB	Gjashtëmu- jori i parë 2008	Nuk ka kosto	Mooskoordinim mes MPC- SSHB dhe MD, vonesa nga grupi i eksperteve	Nje pakete me projekt amenda- menteparaqi- tur Kuvendit	MPCSSHB, shoqeria civile, Kuvendi
		8.2.1.4.b Përgatitja e akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të këtyre ndryshimeve.	MPCSSHB, MD, MB, MSH	2009	Nuk ka kosto	Vonesa per shkak te mosrealizimit te objektivit 8.2.1.4. a	Aktet ne- nligjore te miraturara	MPCSSHB, shoqeria civile, Kuvendi

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
	8.2.2 Përmirësimi i politikave lidhur me aksesin në sistemin ligjor dhe të drejtësisë	8.2.2.1 Përsosja e sistemit të informacionit lidhur me të drejtat e viktimave të dhunës në familje dhe garancitë e tyre procedurale prej sistemit të drejtësisë.	MPCSSHB, MD	Mars 08	10 Pjesë e kostove të tjera të llogaritura	Veshitësi të lidhura me mentalitetin e nepunesve publike lidhur me shërbimet me neqender qytetarin dhe të drejten e tyre per informim	Publik me informuar lidhur me të drejtat e tyre	Anketim, shoqëria civile, donatorët, Kuvendi
		8.2.2.1.a a-përgatitja e fletës palosjeve me të drejtat procedurale dhe vendosja e tyre në mjediset e aksesueshme prej publikut në gjykata, polici, etj.	MD, MB, MPCSSHB	Mars 08	5	Mosdhënia prioritetit nga strukturat e ngarkuara	Nr i materialeve informuese, nr i qytetareve të informuar, nr i njesive ku jane shperndare	Anketim, shoqëria civile, donatorët, Kuvendi
		8.2.2.1.b -përgatitja e guidave për llojet, funksionimin dhe aksesin në shërbimet mbështetëse të	MPCSSHB, MB, MSH	Mars 08	5 Angazhim i dy ekspertëve	Mosdhënia prioritetit nga strukturat e ngarkuara, moskoordinim	Nr i materialeve informuese, nr i qytetareve të informuar, nr i	Anketim, shoqëria civile, donatorët, Kuvendi

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		viktimave dhe të rehabilitimit të dhunuesve dhe vendosja e tyre në mjediset e aksesueshme prej publikut në gjykata, polici, etj				mes strukturave per pergatitjen e guidave	njesive ku jane shperndare	
		8.2.2.1.c përgatitja e modeleve mbi dokumentet tip (kërkesë padi, etj) Përgatitja e fletëpalosjeve për procedurat efiçase (ligjore), të ankimit, të mjeteve të sigurimit, të mbrojtjes, të drejtave juridike specifike, të programeve të rehabilitimit.	MD, DHKA	Mars –maj 2008	5 Angazhim i dy ekspertëve	Mosdhënia prioriteteve nga strukturat e ngarkuara, moskoordinimi mes strukturave per pergatitjen e guidave	Nr i materialeve informuese, nr i qytetareve te informuar, nr i njesive ku jane shperndare	Anketim, shoqeria civile, donatoret, Kuvendi

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.2.2.3 Përcaktimi i procedurave dhe protokolleve të komunikimit dhe të ndërhyrjes së menjëhershme në situatat e krizave mbi baza të koordinuara ndërmjet të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë		2008	Nuk ka kosto			
		8.2.2.3.a -përgatitja e manualeve mbi procedurat	MD, MPCSSHB, MB, MSH	2008	5 (Angazhim i dy ekspertëve)	Moskrijimi ne kohe i struktures koordinuese ne MPCSSHB	Manualet procedurale të përfunduara dhe shpërndara	KM, Kuvendi, shoqëria civile, donatorët

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.2.2.3.b -përgatitja dhe miratimi i protokolleve të koordinimit, bashkëpunimit dhe komunikimit midis shërbimeve që ofrohen brenda sistemit të drejtësisë dhe jashtë tij	MD, MPCSSH, MB, MSH	2008	Nuk ka kosto	Moskrijimi në kohë i strukturës/koordinues/udhëheqëse në MPCSSH, moskoordinimi mes strukturave, mungese e shërbimeve të konsoliduara	Nr. i protokolleve të përfunduara mes strukturave, nr. i njësive administrative të mbuluara	KM, Kuvendi, shoqëria civile, donatorët
		8.2.2.4 nxitja dhe fokusimi i veprimtarisë shkencore në çështjet e dhunës në familje me qëllim hartimin e politikave dhe legjislacionit adekuat.	MD, MPCSSH, MB, MSH		Përfshire në kosto të tjera			

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhën Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.2.2.4.a- planifikimi i punës kërkimore në lidhje me shkaqet dhe efektet e dhunës, dhe monitorimi në vazhdimësi i efikasitetit të masave	MASH, Fak e Drejt, SHM, SHP, Fak. Shk. Soc, te Mjek, Shk. Inf, Inst. Mjek Ligj	Dhjetor 09	Përfshire në kosto të tjera	Mosdhenie prioritët ketij komponenti, moskoordinim mes strukturave	Nr. i studimeve, analizave dhe vëzhgimeve	Studiuesit dhe aktivistët e fushës, shoqëria civile, donatorët, KM, Kuvendi
		8.2.2.4.b- Përfshirja në kurrikulat e fakulteteve të drejtësisë, të SHP, e SHM dhe në programet e edukimit në vazhdimësi të gjyqt, prok, polic, te CEDAW, Konv për të Dr e fëmijëve, etj.	Fak. e Drejt, SHM, SHP	Shtator 08	2	Pengese mund të behet mungesa e ndergjegjesimit të strukturave vendimmarrëse të ketyre institucioneve edukuese, mungesa e fondëve, etj.	Programet edukuese perm-bajne njohuri per barazine gjinore, dhunen ne familje, CEDAW, CRC dhe detyrime te tjera nderkombetare	MASH, donatorët, shoqëria civile, studentët

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhën Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanismat monitorues dhe Vlerësues
		8.2.2.4.c -Realizimi i studimeve lidhur me sistemin e drejtësisë penale për të miturit dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e tij.	MB, MD, SHM, SHP, Fak. e Drejt MPÇSSH	2008	2.5 Pjesë e kostove të përllogaritura	Mosdhënie prioritë të komponentit, moskoordinim mes strukturave	Nr. i studimeve, analizave dhe vezhgimeve ne	Studiuesit dhe aktivistet e fushës, shoqëria civile, donatorët, KM, Kuvendi
		8.2.2.4.d -analiza e situatës së ndihmës ligjore falas dhe e mekanizmave ligjore dhe nënligjore për zgjerimin e përmirësimin e saj	MD, DHKA	Qershor 08	2.5	Moskoordinim mes dy strukturave	Raporti i përfunduar	Shoqëria civile, anëtarët e DHKA, organizatat që ofrojnë ndihmë ligjore

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Vepimet që Duhen Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.2.2.4.e-Bëria e studimeve mbi situatën e riviktimizimit të viktimave prej sistemit të drejtësisë dhe gjetjen e mekanizmave për eliminimin e tij.	MD, MB, SHM, SHP, Fak. e Drejt, Fak., Shk. Soc MPCSSHB	Dhjetor 09	2.5 Pjesë e kostove të përllogaritura	Mosdhenie prioritë ketij komponenti, moskooordinim mes strukturave	Nr. i studimeve, analizave dhe vezhgimeve	Studuesit dhe aktivistët e fushës, shoqëria civile, donatorët, KM, Kuvendi
		8.2.2.4.f- Të promovohen dhe/ose mbështeten financiarisht studimet në lidhje me situatat specifike të dhunës për anëtarët e paaftë të familjes, gratë, vajzat, të moshuarit, fëmijët, dhe sistemet e rehabilitimit të dhunuesve dhe dënimeve të mundshme alternative.	MPCSSHB, MASH, MSH, Fak.Drejt, Fak. Mjek, Fak. Shk. Soc	Janar 2010	2.5 Pjesë e kostove të përllogaritura	Mosdhenie prioritë ketij komponenti, moskooordinim mes strukturave	Nr. i studimeve, analizave dhe vezhgimeve	Studuesit dhe aktivistët e fushës, shoqëria civile, donatorët, KM, Kuvendi

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanismat monitorues dhe Vlerësues
		8.2.2.5 Përfshirja në Ligjin për Buxhetin e mjeteve të nevojshme të mbështetjes financiare të rasteve të dhunës në familje			Nuk ka kosto	Mosrealizimi në kohë i pikës 1.1.1b, mungesa në mundësitë financiare, mungesa e konsensusit politik sa i përket prioritetit të DhF	Ligji buxhetor miratuar me komponent për dhunën në familje	Parlamenti, shoqëria civile, MPCSSHB
		8.2.2.5.a -Buxhet për shërbimet (streheza, ndihme ligjore)	MPCSSHB, MF	2008	Përfshire në kosto të tjera të përlogaritura	Mosrealizimi në kohë i pikës 1.1.1b, mungesa në mundësitë financiare, mungesa e konsensusit politik sa i përket prioritetit të DhF	Ligji buxhetor miratuar me komponent për dhunën në familje	Parlamenti, shoqëria civile, MPCSSHB
		8.2.2.5.b -Buxhet për ngritjen e strukturave	MPCSSHB, MB, MSH, MF	2008	Përfshire në kosto të tjera të përlogaritura	Mosrealizimi në kohë I pikës 1.1.1 b, mungesa në mundësitë financiare, mungesa e konsensusit politik sa i përket prioritetit të DhF	Ligji buxhetor miratuar me komponentet për dhunën në familje	Parlamenti, shoqëria civile, MPCSSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhen Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.2.2.6.c -Buxhet për infrastrukturen	MPCSSHB, MB, MSH, MF, Zyra per Buxh Gjyq	Dhjetor 08	Përfshire në kosto të tjera të përlogaritura	Mosrealizimi ne kohe I pikes 1.1.1 b, mungesa ne mundesite financiare, mungesa e konsensusit politik sa I perket priorititetit te DhF	Ligji buxhetor miratuar me komponent per dhunen ne familje	Parlamenti, shoqeria civile, MPCSSHB
		8.2.2.6.d -Buxhet për formimin e kapaciteteve	MPCSSHB, MB, MD, MSH, MF SHM, SHP, Fak. e Drejt, Fak., Shk. Soc, Fak. Mjek, Shk Inf. Mjek. Ligj	Në vazhdimësi	Përfshire në kosto të tjera të përlogaritura	Mosrealizimi në kohë i pikës 1.1.1 b, mungesa në mundësitë financiare, mungesa e konsensusit politik sa i perket priorititetit të DHF	Ligji buxhetor miratuar me komponent per dhunen ne familje	Parlamenti, shoqeria civile, MPCSSHB
	8.2.3 Monitorimi i ndërhyrjeve, masave dhe funksionimit të legjislativionit dhe të sistemit të drejtësisë	1.3.1 Hartimi dhe zbatimi i politikave për matjen e rezultateve sipas indikatorëve të unifikuar	MPCSSHB, MB, MD, MSH	Dhjetor 08 dhe në vazhdimësi	Nuk ka kosto	Vonesa në krijimin e strukturës udhëheqëse pranë MPCSSHB, moskoordinim i mirë mes strukturave përgjegjëse,	Një mekanizëm i fortë, i qartë efektiv dhe funksional për vëzhgimin e zbatimit të ligjit dhe funksionimit të	MPCSSHB, MD, KM, Kuvendi, shoqëria civile, donatorët, gjykatat

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
Rritja e aksesit në drejtësi përmes përmirësimit të shërbimeve të ofruara prej sistemit ligjor dhe të drejtësisë për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave dhe ndëshkimin dhe rehabilitimin e dhunuesve	8.2.4 Krijimi i strukturave specifike në përgjigje të nevojave të viktimave të dhunës në familje	8.2.4.1 përcaktimi i aktorëve të sistemit të drejtësisë që do të merren me rastet e dhunës në familje. Ngritja e njësi/vektorëve/vektorëve që do të merren me çështje të dhunës në familje pranë institucioneve përkatëse.	MPCSSHB, MB, MD, MSH, Kryetaret e gjykatave	2007-2008	1 Llogaritur për 1 vit	neglizhim i nevojës për përcaktimin e monitorimit në vazhdimësi	Cdo institucion I ngarkuar me detyra nga Ligji per Dhunen ne Familje, me strukturat/njese te specializuara	Parlamenti, KM, shoqeria civile, MPCSSHB

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhën Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.2.4.2 përgatitja e listave të ekspertëve (për mbështetje psikologjike, juridike, etj) dhe vënia e këtyre në dispozicion të gjykatës, policisë, prokurorisë, etj.	MPCSSHB, MB,MD, DHKA	Shtator 08	Nuk ka kosto	Moskoordinim mes strukturave	Çdo institucion i informuar për shërbimet që ofrohen dhe ekspertët që i ofrojnë	MPCSSHB, MB, MD, DHKA, organizatat që ofrojnë shërbime, bashkimet e eksperteve etj.
	8.2.5. Hartimi dhe zbatimi i marreveshjeve të bashkëp. mes strukturave shtet. dhe këtyre me OJF që vepron në mbrojtje të viktimave	8.2.5.1 përgatitja e një protokollit të detyruar veprimi në mënyrë që policia dhe të gjitha shërbimet të ndjekin të njëjtën procedurë dhe të hartojnë plane veprimi të koordinuara afatmesme dhe afatgjata për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimave.		2008	Nuk ka kosto	Moskrijimi ne kohe i struktures koordinuese/ udhe-heqese ne MPCSSHB, moskoordinimi mes strukturave, mungese e shërbimeve te konsoliduara	Nr. i marreveshjeve te perfunduara mes strukturave, nr. i njesive administrative te mbluara	KM, Kuvendi, shoqeria civile, donatoret

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhën Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështrësytë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
	8.2.6 Forcimi institucional i kapaciteteve specifike në përgjigje të nevojave të viktimave të dhunës në familje	8.2.6.1 Trajnimi i specialistëve të aktores të sistemit të drejtësisë (gjyqtarëve, prokurorëve, policisë, avokatëve, etj) që do të trajtojnë çështje të dhunës në familje.	MB, MD, SHM, SHP, DHKA	08 e në vazhdimësi	40	Mosplanifikimi drejtë për mbulimin e nevojave, mungese e fondeve të mjaftueshme buxhetore, moskoordinim me donatorët	Nr. I punonjësve të trajnuar në çdo sektor, krahasuar me nevojat e identifikuar	MPCSSHB, shoqëria civile, donatorët
		8.2.6.1.a -Vlerësimi i nevojave,						
		8.2.6.1.b -Caktimi i ekspertëve. ToT						
		8.2.6.1.c -Përgatitja e moduleve dhe kalendareve						
		8.2.6.1.d -Realizimi i trajnimit						

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vëzhgimet	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.2.6.2 trajnimi i administratës gjyqësore	MD, SHM	Shtator 08	40	Mosplanifikimi i drejtë për mbulimin e nevojave, mungesë e fondeve të mjaftueshme buxhetore, moskoordinim me donatorët	Nr. i punonjësve të trajnuar, krahasuar me nevojat e identifikuar	MPCSSHB, shoqëria civile, donatorët
		8.2.6.3 Njohja e strukturave të sistemit të drejtësisë me strategjinë e dhunës në familje, me aktet ndërkombëtare, ligjore dhe nënligjore.	MPCSSHB, MB, MD, PP, SHM, SHP, DHKA	dhjetor 07 e në vazhdimësi	Pjesë e kostos së trajnimit			

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
	8.2.7 Krijimi, forcimi i infrastrukturës së sistemit të drejtësisë në përgjigje të nevojave të viktimave të dhunës në familje	8.2.7.1 Krijimi i nje mjedisi te sigurtë gjyqësor si për viktimat ashtu edhe për dëshmitarët, avokatët, prokurorët dhe ne menyre te vecante per gjyqtarët dhe stafin administrativ	MD, MB	Janar 2010	Pjesë e kostos së ngritjes së strukturave	Moskoordinimi i strukturave	Instalimi i pajisjeve detektuese për armë në cdo gjykatë. Funksionimi i një sistemi alarmi/njoftimi që mundëson ndërhyrjen e policisë në raste incidentesh	MB nëpërmjet nr të incidenteve në gjykatë, shoqëria civile, anketime
		8.2.7.2 Modifikimi i sistemit te pagesave per shërbimet që iu ofrohen viktimave nga sistemi i drejtësisë	MD, MF	Janar 08	Nuk ka kosto	Vonesa burokratike	Shërbime që nuk rëndojne financiarisht viktimat	MPCSSHB, KM, shoqëria civile

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështrirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanismat monitorues dhe Vlerësues
		8.2.7.3 Linje telefonike 24-orëshe pranë sistemit të drejtësisë dhe organizimi i shërbimit të gjyqtarëve, prokurorëve e policëve të gatshëm përgjatë 24 h.	MD,PP Gjykatat	2008	500	Mosrealizimi në kohë i objektivave lidhur me hartimin e akteve nënligjore	Shërbimet e sistemit të drejtësisë ofrojnë akses telefonik 24 orësh për qytetarët	MPCSSHB
	8.2.8 Përmirësimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave, raportimit dhe analizës së tyre	8.2.8.1 Përgatitja e modeleve të unifikuara të regjistrimit të dhunës në familje.	MB, PP, MD, Gjykatat, Instat	Shtator 08	Pjesë e kostove të përlogaritura	Mosrealizimi në kohë i objektivave lidhur me hartimin e akteve nënligjore. Koha e punës që iu shtohet in-situcioneve të ndryshme në mbledhjen edhe të ketyre statistikave	Krijimi i bankes së të dhënave për dhunën në familje	INSTAT, MPCSSHB, KM

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhen Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështrirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.2.8.2 Pasurimi i data base me të dhëna mbi dhunën në familje, mbledhja e të dhënave dhe hartimi i statistikave të unifikuara dhe standarde.	MB, PP, MD, Gjykatat	Në vazhdimësi	50	Mangesite e bankes se te dhenave ne fazen e pare. Puna qe iu shtohet institucioneve per perditësimin edhe me statistikat e dhunes ne familje	Statistika vjetore per dhunen ne familje	INSTAT, MPC-SSHB, KM
		8.2.8.3 Bërija publike e statistikave të gjykatës dhe policisë dhe të shërbimeve të tjera, si dhe analiza e fakteve që burojnë prej tyre.	MB, PP, MD, Gjykatat	Në vazhdimësi	Nuk ka kosto	Mangesi ne funksionimin e sistemit te pergjithshem te informimit te strukturave te sistemit te drejtesise	Nr. i publikimeve statistike mbi dhunen ne familje	MPCSSHB, shoqeria civile, donatoret
	8.2.9 Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e parandalimit dhe të viktimave të dhunës në	8.2.9.1 Bashkëpunimi ndërkombëtar në kërkimet sistematike dhe mbledhjen, analizën dhe përhapjen e të dhënave, duke përfshirë të dhënat	MD, MJ, MPC-SSHB	Në vazhdimësi	10	Moskoordinim i mire me donatorët	Nr. i marrëveshjeve te perfunduara dhe programeve mes strukturave shteterore dhe ato	MPCSSHB, KM, shoqeria civile, donatoret

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanimizat monitorues dhe Vlerësues
	familje si dhe të politikeve rehabilitues ndaj dhunuesve	ndara në bazë të seksit, moshës dhe çdo informacion tjetër përkatës në lidhje me natyrën dhe pasojat e dhunës kundër grave/ vajzave dhe në lidhje me impaktin dhe efikasitetin e politikave dhe programeve për luftën kundër kësaj dhune.					nderkombetare apo te vendeve te tjera	
		8.2.9.2 Raportimi rregullisht tek organet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për zhvillimet e dhunës në familje dhe kundër grave/ vajzave dhe marra për parandalimin dhe luftën kundër saj.	MJ, MD, MPC-SSHB	Në vazhdimësi	Nuk ka kosto	Vonesë të shkaktuara nga moskoordinimi dhe mosorganizimi i mirë i punës nga strukturat shtetërore	Nr. i raporteve të Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare	KM, Kuvendi, shoqëria civile, organizmat ndërkombëtare

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhën Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/Buxheti 000/lekë	Supozimet/Vështrësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
Qëllimi 8.3 Të përmirësohen shërbimet dhe mbështetja për të gjitha viktimat e dhunës në familje	8.3.1 Ngritja e rrejtëve shërbimeve dhe e kapaciteteve profesionale të ofruesve të shërbimeve për individë e dhunuar në familje.	8.3.1.1 Krijimi i strukturave të shërbimeve në nivel lokal.	MB,PL MPCSSHB	Duke filluar nga 2008	396	Mungesë e buxhetit Moskuptim i rëndësishëm së krijimit të strukturave nga pushteti lokal.	Numri i strukturave të krijuara Numri i përfutueseve të shërbimeve	
		8.3.1.2 Krijimi i një grupi për përcaktimin e shërbimeve, trajnimeve të nevojshme	MPCSSHB SHSSH OJF	2008	Nuk ka kosto		Liste me modellet dhe temat e trajnimit	
		8.3.1.3 Krijimi i programeve të trajnimit për punonjësit, të cilët ofrojnë shërbime mbështetëse	OJF Fakulteti i shkencave sociale SHSSH	2008-2009	9		Programe trajnimit të hartuara për të gjithë aktorët e përfshirë në dhënie të shërbimeve	

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.3.1.4 Mbështetja e programeve ekzistuese me fonde dhe mjete	MPL MPCSSHB Donatore MF OJF	2008-2010	100	Mungesë e fondeve	Programe efikase	
		8.3.1.5 Krijimi i një programi kombëtar 3-vjeçar për fëmijët të cilët jetojnë me dhunë në familje. Afrimi i shërbi-meve mbështetëse për fëmijët, të cilët përjetojnë dhunë	OJF SHSSH Donatorë	2008	6			
		8.3.1.6 Krijimi i një grupi pune për hartimin e një protokollit të nevojshëm lidhur me dokumentimin e rastit në regjistrat mjekësorë, raportimin, trajtimin dhe referimin e viktimeve të dhunës në familje. Drafti i këtij protokollit	Ministria e Shëndetësisë, OJF, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale & Shansave të Barabarta, Ministria e Drejtësisë.	2009 e ne vazhdimesi	Nuk ka kosto	Zvarritja/ ndëprerja e procesit në njërin prej hallkave të këtij mekanizmi.	Publikimi dhe bashkëngjitja e protokollit për trajtimin, dokumentimin dhe referimin e rasteve të dhunës, legjislacionit shëndetësor të përmirësuar.	Disponimi i të gjithë dokumentacionit që ka shoqëruar procesin e hartimit të protokollit, diskutimin, sugjerimet dhe komentet deri në miratimin e tij.

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		diskutohet me grupin përgjegjës të ngritur me qëllim përmirësimit e legjislacionit shëndetësor në favor të viktimave të dhunës e prej këtej i bashkëngjitet ndryshimeve të tjera që ky grup pune do të propozojë për miratim.						
		8.3.1.7 Rishikimi dhe përmirësimi i detyrave të personelit shëndetësor (mjek, infermier, etj) ndaj të sëmurëve kur këta janë viktimë të dhunës në familje	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, OJF, Urdhëri i Mjekut, Organizata Profesionale Mjekësore	2008-2010	2.500		Ndër detyrat e mjekëve në kodin deontologjikshohen & përcaktohen & miratohen detyrat e përgjegjësi të reja të mjekut në rastin e përballjes me te viktimë të dhunës.	

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhën Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
	8.3.2 Sigurimi i shërbimeve të shpejta dhe efikase në mbështetje dhe mbrojtje të viktimave të dhunës në komunitet	8.3.2.1 Krijimi i linjave falas në nivel lokal per denoncimin e dhunes ne familje.	PL OJF MD	2010	Përlogaritur në kosto të tjera		Linja falas në ndihmë të viktimave të dhunës	
		8.3.2.2 Transferimi i shërbimeve dhe fondeve në nivel lokal	MF MPCSSH	2007-2010	Përlogaritur në kosto të tjera		Sherbime ne komunitet per viktimat e dhunes ne familje	
		8.3.2.3 Krijimi i lehtësirave financiare për marrje kredie nga pushteti vendor për ngritje strehëzash	MF	2010	Nuk ka kosto		Numri i strehëzave të ngritura pranë komuniteteve	
		8.3.2.5. Zhvillimi i programeve të trajnimit mbi nevojat për mbështetje të grave dhe vajzave të dhunuara me stafet në nivel lokal.	Fakulteti i shkencave sociale SHSSH OJF	Duke filluar nga 2008	40		Stafi lokal i trajnuar Numri i përfitueseve Përmitësimi i cilësisë së shërbimeve	

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.3.2.6 Përfshirja e aftësive identifikuese, referuese dhe trajtuese të viktimave të dhunës si pjesë e standarteve vlerësuese të mjekëve dhe institucioneve shëndetësore për akreditimin individual dhe institucional.	MSH QKCSAISH OJF, Urdhëri i Mjekut	2008-2010	32.000	Botimi i dokumentit të rishikuar të standarteve vlerësuese të mjekëve & institucioneve për akreditimin e tyre.		
		8.3.2.7 Përfshirja e punonjësve socialë dhe psikologje në personelin e qendrave të kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbimet e urgjencës, trajnimi i tyre për çështje të identifikimit, trajtimit në bashkëpunim me	Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, OJF	2009 – 2010	Nuk ka kosto	Përcaktimi i një grupi me punonjës sociale dhe psikologë dhe trajnimi i tyre për çështjet e identifikimit, trajtimit në bashkëpunim me stafin mjekësor si dhe referimin për raste të rënda.	Vlerësimi sasior dhe cilësor i pacientëve që kanë përfituar nga shërbimi i punonjësve socialë/psikologëve në kujdesin shëndetësor parësor.	

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		stafin mjekësor si dhe referimin e rasteve të rënda.						
	8.3.3 Përmirësimi i shërbimit të urgjencës në zonat urbane dhe ato rurale për t'iu përgjigjur imediatisht dhe cilësish nevojave shëndetësore të viktimave të dhunës në familje.	8.3.3.1 Përcaktimi i personave përgjegjës në Qëndrat e Kujdesit Shëndetësor dhe shërbimet e urgjencës në spitale për trajtimin e viktimave të dhunës në familje.	Ministria e Shëndetësisë, OJF	2008 – 2010	Nuk ka kosto	Mungesa e burimeve financiare për të realizuar përmirësimin e shërbimeve të urgjencës, sidomos për motivimin e stafit mjekësor për të punuar në zonat rurale.	Rritja e numrit të stafit mjekësor në shërbimin e urgjencës në Shqipërinë e Veriut, dhe në zonat rurale.	Marrja & shqyrtimi i raporteve nga MSH që pasqyrojnë rritjen sasore dhe cilësore të stafit mjekësor në shërbimin e urgjencës në Shqipërinë e Veriut dhe zonat rurale.
		8.3.3.2 Hartimi i një plani ndërhyrjeje për ndërgjegjësimin dhe edukimin e stafit ekzistues mjekësor në shërbimin e urgjencës mbi njohjen, identifikimin dhe menaxhimin e	Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale & Shanseve të Barabarta, Ministria e	2007 – 2010	Nuk ka kosto	Shtyrja e implementimit të strategjisë nga ana e qeverisë	2. Miratimi i planit të ndërhyrjes nga MSH për ndërgjegjësimin dhe edukimin e stafit mjekësor në shërbimin e	Bërja publike dhe diskutimi publik i planit ndërgjegjësues për stafin e urgjencës.

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhet Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		individëve të dhunuar.	Drejhtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, OJF, Ministria e Financave				urgjencës.	
	8.3.4 Të vendoset shërbimi psikosocial në të gjitha shkollat	8.3.4.1 Të ngrihet skuadra e shërbimit në shkollë	PL, DRA, ZA,	2008-2009	Nuk ka kosto		Shërbimi i specializuar psikosocial	DRA, SHK, SHQS
		8.3.4.2 Të sigurohet sistemi i të dhënave	DRA SK, Shkolla	2008-2009	Nuk ka kosto		Vendosja e psikologut e punonjësit social si sistem shërbimi në shkolla	DRA, SHK, PL
		8.3.4.3 Të punohet me programe individuale e grup	DRA, SHK	2008-2009	8.000		Krijimi i një dokumentacioni bazë për raportimin e dhunës në familje	SHK, DRA, PL

Qëllimet Strategjike	Objektivat Specifike	Veprimet që Duhën Ndërmarrë	Institucionet Përgjegjëse dhe Partnere	Koha e Realizimit	Burimet/ Buxheti 000/lekë	Supozimet/ Vështirësitë	Treguesit e Monitorimit	Mekanizmat monitorues dhe Vlerësues
		8.3.4.5 Të bashkërendohet shërbimi psikologjik me veprimtaritë edukative dhe mësimore në shkollë	DRA,ZA,	2007-2009	Nuk ka kosto		Vendosja e sistemit TIK në shkollë	PL, DRA
		8.3.4.6 Bashkëpunimi i shkollave me komunitetin për integrimin psikosocial të fëmijëve viktimë të dhunës në familje	SHK	2009-2010	Nuk ka kosto		Përmirësimi i legjislacionit për ndarjen e pushteteve dhe kombinimin e veprimtarive	MASH, MB, KUVENDI
	8.3.5 Të ngrihen mjediset fizike të favorshme	8.3.5.1 Të ndërtohen mjediset relaksuese në komunitet për fëmijët viktimave të dhunës si rezidenca ditore, kënd lojrash etj,	RA, SHK DRA, PV- njësitë e qeverisjes vendore, MASH	2008-2010	Përfshirë në kosto të tjera			

ANEKS 1

PËRSHKRIM I LEGJISLACIONIT

Përkufizimi i diskriminimit nuk jepet në Kushtetutë. Megjithatë Kushtetuta ka parashikuar se mbas saj, në hirearkinë e ligjeve më të rëndësishme, janë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi ynë, të cilat kanë epërsi mbi legjislacionin vendas që bie në kundërshtim me të (Neni 122(2) i Kushtetutës). Shqipëria është anëtare e OKB-së që në vitin 1955 dhe ka ratifikuar një numër të madh të Konventave për të Drejtat e Njeriut, ku për aspektin për të cilin po flasim më e rëndësishmja është Konventa “Për Eleminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas” (CEDAW) 1978, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me Ligjin nr.7767, datë 09.11.1993 si dhe protokollin shtesë i kësaj Konvente në vitin 2003, me Ligjin nr. 9052, datë 17.04.2003. Sipas këtij Protokollin, çdo person ose grup që e ndjen veten të diskriminuar lidhur me të drejtat e parashikuara në Konventë, ka të drejtë të ankohet në Komitetin e Konventës, sipas një procedure të caktuar. Kjo Konventë për nga rëndësia njihet edhe si *Kushtetuta e Gruas*. Shteti Shqiptar sipas detyrimeve që ka, ka raportuar pranë Komitetit të Konventës në janar 2003, dhe tani është në fazën e përbushjes së rekomandimeve të bëra nga Komiteti i Konventës, sikurse dhe në përgatitjen e raportit të tretë periodik zyrtar.

Duke qenë se Konventa e OKB-së CEDAW, është e vetëzbatueshme, lidhur me diskriminimin gjinor mund të jepet përkufizimi i diskriminimit sipas Nenit 1 të Konventës: “*çdo dallim, përbashkëtim ose kufizim në bazë gjinie, që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë ose zhvlerësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gruaja, cilado qoftë gjendja e saj martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër*”.

MSA

Në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA), nenet 77 dhe 99 përcaktojnë detyrimet e Shqipërisë lidhur me ofrimin e mundësive të barabarta në punësim, në fushën e kushteve të punës, veçanërisht të shëndetit dhe sigurisë në punë. Në kuadrin e bashkëpunimit social synohet përshtatja e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* përsa i përket mundësive të barabarta për gratë.

Në vitin 1995, në Konferencën e IV Botërore për Gruan nga ku doli Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim, u përcaktuan 12 fusha konkrete ndërhyrjeje, të cilat detyronin shtetet nënshkruese (180 vende) të hartonin legjislacion, platforma e strategji në përputhje me kushtet e vendit dhe në mbrojtje të të drejtave të grave. Kjo Deklaratë mbështet veprimet solemne të qeverive, si dhe përfaqëson një përpunim të detajuar të asaj që kërkon zbatimin efektiv të Konventës CEDAW mbi krijimin e mekanizmit kombëtar.

Deklarata e Mijëvjeçarit, e nënshkruar në shtator 2000 në Mbledhjen e nivelit të lartë të OKB-së, u kërkon vendeve anëtare “të përkrahin barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, si rrugë të frytshme për të luftuar varfërinë, urinë dhe sëmundjet dhe për të nxitur zhvillimin, që të jetë me të vërtetë i qëndrueshëm”. Në Pekin +10, një dekadë mbas Deklaratës së Pekinit, u rishikua dhe vlerësua periudha dhjetëvjeçare e zbatimit të Platformës për Veprim. Në këtë takim, u përqendrua vëmendja tek shtatë prioritetet e propozuara nga rekomandimet e OZHM-ve mbi Barazinë gjinore, nga të cilat edhe “Eleminimi i pabarazive gjinore në punësim, si dhe eleminimi i diferencës në të ardhura”.

Mandati i ILO (International Labor Office), Zyra Ndërkombëtare e Punës, mbi barazinë gjinore është të promovojë barazinë midis grave, dhe burrave, në botën e punës. Mandati bazohet në Konventat Ndërkombëtare të Punës që i kushtojnë rëndësi të veçantë barazisë gjinore, veçanërisht në katër Konventat kyçe të barazisë. Nga këto, janë ratifikuar dhe raportohet në Zyrën Ndërkombëtare e Punës mbi: Konventën Nr. 100 “Për shpërblim të barabartë”, Konventën Nr. 111 “Kundër diskriminimit” dhe Konventën Nr. 183 “Për mbrojtjen e amësisë”. Së fundmi në korrik 2007 u ratifikua edhe Konventës Nr. 156 “Mbi punonjësit me përgjegjësi familjare”.

1.2.1. Kuadri ligjor në lidhje me të drejtat politike (dhe në vendim-marrje).

Të drejtat civile e politike: Si burrat, edhe gratë, gëzojnë *de jure* të drejta të barabarta civile e politike. Ligjërisht gruaja ka të drejtë të zgjedhë lirisht vendbanimin, të mbajë një emër dhe një mbiemër, të drejtën e shtetësisë dhe të ndryshimit të saj.

Të drejtat politike: Legjislacioni shqiptar iu njeh të drejta të barabarta si burrave, ashtu edhe grave,, që me mbushjen e moshës madhore 18 vjeç, të zgjedhin dhe të zgjidhen (Kushtetuta Neni 45). E drejta e votës është e garantuar. Historikisht gruaja e ka fituar të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur për herë të parë në vitin 1928. Praktikisht të drejtën e votës gratë e zbatuan në zgjedhjet e para të pasluftës në vitin 1945.

Në Kodin Zgjedhor Ligji Nr. 8087 datë 19.06.2003, sanksionohet edhe njëherë pas Kushtetutës parimi i mosdiskriminimit për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur, si dhe garantohet e drejta e votës për zgjedhësit. Lëvizja e grave ka punuar për të futur në ligjin elektoral të vitit 2000 e më pas, një kuotë prej 30% përfaqësimi për gjininë më të diskriminuar. Por kjo ende nuk është arritur. Sistemi mazhoritar që parashikon legjislacioni ynë nuk e lejon përfshirjen e kuotës. Ndërkaq partitë politike më të mëdha kanë sanksionuar në statutet e tyre kuotën për pjesëmarrjen e grave në organet drejtuese të partive.

1.2.2. Kuadri ligjor në lidhje me të drejtat ekonomike dhe në fushën e punësimit.

Në Kushtetutën e RSH në nenin 18 është përcaktuar se të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkak të racës, gjinisë, bindjeve fetare, filozofike dhe politike, gjuhës, gjendjes ekonomike, arsimore dhe sociale. Me tej, në Kreun IV “Për liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, ligji themelor i shtetit shqiptar parashikon në nenin 49 (1) të drejtën për t’u punësuar. “Çdo njeri ka të drejtën të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës si dhe sistemin e kualifikimit të tij profesional”. Të drejta të barabarta për burrin dhe gruan janë parashikuar dhe në Ligjin “Për Barazi Gjinore” (që aktualisht është duke u rishikuar), i cili konsiston në vendosjen në pozita të barabarta të dy seksëve në fushën e punësimit si dhe dispozita të veçanta për ngacmimin seksual në vendin e punës (nenet 4, 5, 6, 7 dhe 8).

Të drejtat në fushën e punës. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në Kreun IV, Neni 49 pika 1, përcakton se gjithëkush është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional. Kodi i Punës në nenin 9, sanksionon se ndalohet çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit. Kodi i Punës ndalon diskriminimin në bazë të seksit që cënon të drejtën e individit për të qënë i barabartë në punësim dhe trainim, në proçeduarat e marrjes në punë dhe kushtet e punës, në kryerjen e detyrave, në shpërblim, asistencë sociale dhe përfundimin e kontratës së punës si dhe pjesëmarrjen në sindikata.

Shpërblimi i barabartë. Përsa i përket shpërblimit të barabartë midis burrave, dhe grave, neni 115 i Kodit të Punës, në paragrafin 3, parashikon që punëdhënësi t'u japë burrave, dhe grave pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë. Ky formulim është në përputhje me të gjitha instrumentat ndërkombëtare (ILO-Konventa nr.100 mbi Shpërblimin e Barabartë, 1951), në të cilën Shqipëria është palë. Po sipas Kodit të Punës, në rastin e shkeljes së këtij parimi, punëdhënësi detyrohet t'i paguajë punëmarrëses/it të diskriminuar një shpërblim që përfshin të gjithë avantazhet që ka punëmarrësi i seksit tjetër (neni 115, paragrafi 4 i Kodit të Punës). Legjislacioni shqiptar lidhur me shpërblimin e barabartë *nuk është diskriminues*. Ai i trajton në mënyrë të barabartë si burrat edhe gratë. Problemi *de facto* që evidentohet është pjesëmarrja e ulët e gruas në poste drejtuese. Edhe pse ajo është e arsimuar dhe e kualifikuar në përgjithësi, vendet drejtuese në sektorin publik por edhe atë privat i mbajnë burrat, të cilët rrjedhimisht do të kenë edhe shpërblim më të lartë. De facto gratë punojnë në sektorë ku shpërblimi është më i ulët. Ato punojnë në punë të tilla si infermiere; në sistemin parashkollor dhe mësuese të arsimit nëntëvjeçar dhe shkollë të mesme; në sektorin privat si rrobaqepësi etj, punë të cilat rrjedhimisht janë më pak të paguara. Në pikën ç të nenit 4 të Ligjit 9198/01.07.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri” përcaktohet se një nga detyrimet e punëdhënësit për të zbatuar të drejta të barabarta, është të japë pagesë të barabartë për punë me vlerë të barabartë. Neni 5 pika a) cilëson si veprim diskriminues të punëdhënësit për shkak të gjinisë kur “përdor standarte të diferencuara ndaj punëmarrësve lidhur me kohëzgjatjen dhe/ose pagesën për punën me vlerë të njëjtë”. Shkelja e dispozitave të këtij ligji sipas rastit sjell përgjegjësi disiplinore, administrative ose penale për personin fajtor; si dhe nëse shkelja është bërë nga nëpunësit e administratës shtetërore, shkelësi paguan gjobë deri në 30.000 lekë.

Kushtet e punës. Kodi i Punës në Kapitullin VIII nga neni 39-75 parashikon sigurimin dhe mbrojtjen e shëndetit. Në Kodin e Punës janë parashikuar rregulla të veçanta për mbrojtjen e gruas punëtore. Neni 54 (3) parashikon që gruaja shtatzënë që punon vazhdimisht në këmbë, në çdo tre orë duhet të pushojë të paktën 20 minuta. Neni 55 paragrafi 5, parashikon që pesha që mund të ngrejë gruaja është deri në 20 kg, ndërsa për burrin është 55 kg. Sipas nenit 72 punëdhënësi, në vendet ku punojnë gra, është i detyruar, përveç kushteve të tjera higjienike, të sigurojë dhoma të veçanta për to. Shkelja e dispozitave të sipër përmendura dënohet me një gjobë që shkon nga 20-50 fishin e pagës minimale mujore të vendosur me ligj.

Mbrojtja në rastet e pushimit nga puna. Kodi i Punës në Nenin 146 paragrafi 2 përcakton rastet e zgjidhjes së kontratës nga punëdhënësi pa shkaqe të arsyeshme. Gjykata vendos në rastet e pushimit pa shkaqe të arsyeshme që punëdhënësi detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në 1 (një) vit pagesë ose rikthim në vendin e punës. Mbrojtja sigurohet si nga legjislacioni shqiptar ashtu edhe nga konventat e ratifikuara nga Parlamenti ynë. Ankimi në rastet e diskriminimit gjinor, në vijimësi të ligjeve të mësipërme, parashikohet edhe në Ligjin Nr. 9198, datë 01.07.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Neni 16.

Ngacmimi seksual në vendin e punës. Lidhur me ngacmimin seksual në vendin e punës nuk ka të dhëna statistikore zyrtare nëse këto çështje kanë shkuar dhe janë zgjidhur në gjykatë. Edhe nga shoqatat e grave që merren me ndihmë juridike për gratë dhe vajzat nuk rezulton ndonjë rast i tillë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se këto raste nuk ekzistojnë. Në media disa herë është shkruar për fenomenin dhe mënyrën se si trajtohet ai nga opinioni dhe legjislacioni. Lidhur me ngacmimin seksual në vendin e punës Legjislacioni shqiptar shprehet në Kodin e Punës dhe Ligjin nr 9198/01.07.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

E drejta e grave të punësuara për mbrojtjen gjatë shtatëzënisë. Leja e paguar për gratë para dhe pas lindjes:

1. Neni 54 i Kushtetutës së Shqipërisë flet për masa të posaçme për mbrojtje nga shteti të disa kategorive më vulnerabël dhe konkretisht për fëmijët, të rinjtë, gratë shtatëzëna dhe nënat e reja. Në përputhje me këtë mbrojtje kushtetuese, Qeveria nxjerr akte nënligjore për mbrojtjen e grave shtatëzëna në marrdhëniet e punësimit.
2. Sipas Ligjit nr. 9198/01.07.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri” nuk përbën diskriminim ose dhunim të të drejtave të barabarta për gratë e burrat “mbrojtja e posaçme e grave gjatë shtatëzënisë, lindjes e sëmundjes”.
3. Një grua ka të drejtën e lejes së lindjes, nëse ajo ka qenë e përfshirë në skemat e sigurimeve shoqërore për 12 muajt e fundit dhe ka qenë e punësuar me një kontratë punësimi nga momenti i fillimit të shtatëzënisë deri në fillimin e lejes së lindjes. Periudha e përfitimit të lejes së lindjes është 365 ditë duke përfshirë një minimum prej 35 ditë përpara lindjes dhe 42 ditë pas lindjes (neni 104 i Kodit të Punës).
4. Ligji nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” garanton më tej të drejtën e grave të siguruara për përfitime në rast barrëlidje.

Punëdhënësi është i detyruar që t’i ruajë vendin e punës një gruaje gjatë periudhës që ajo është me leje lindjeje, në rast të kundërt kjo konsiderohet diskriminim për shkak të gjendjes së shtatëzënisë apo të mëmësisë (Konventa CEDAW). Gjithashtu punëdhënësi nuk mund t’i komunikojë pezullim apo pushim nga puna punëmarrëses e cila deklaron se është shtatëzanë.

Mbrojtja e posaçme. Këshilli i Ministrave me VKM Nr. 397/20.05.1996 ndryshuar me VKM nr. 185/ 03.05.2002 ka miratuar vendimin “Për mbrojtjen e veçantë të grave shtatëzëna dhe të amësisë”. Sipas nenit 108 të Kodit të Punës ndalohet puna e natës për gratë shtatëzëna. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë i konsideron si një akt kriminal kundër grave shtatëzëna kushtet e keqësuara, neni 50(e), ndërsa neni 79(b) parashikon burgim të përjetshëm për vdekjen e gruas shtatëzënë.

Ligji 8549 datë 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil” parashikon në kreun IV neni 15 ngritjen në detyrë për nëpunësit civilë pa dallim seksi. Ky ligj përcakton dhe procedurat për ngritjen në detyrë nëpërmjet konkurimit.

1.2.3 Kuadri ligjor në lidhje me arsimin dhe formimin profesional.

Legjislacioni në arsim është ngritur duke u bazuar në barazinë gjinore si një ndër parimet e rëndësishme të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në parimet e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë. Këtu përfshihen: Ligji nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” i ndryshuar, Ligji nr. 8872, datë 29.03.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” si dhe Ligji nr. 8461, datë 25.02.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar parashikon në nenin 3 sanksionimin e barazisë gjinore duke u shprehur për të drejta të barabarta të shtetasve të Republikës së Shqipërisë për t’u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimit, pavarësisht nga gjendja sociale, kombësia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shëndetësore dhe niveli ekonomik. Barazia gjinore mbahet parasysh në këtë ligj edhe në hartimin e programeve të zhvillimit të arsimit, të cilat bëhen në përputhje me prirjet dhe zhvillimet arsimore ndërkombëtare, si dhe veçoritë kombëtare, rajonale, social-ekonomike dhe demografike të Shqipërisë.

Ligji nr. 8872, datë 29.03.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi 3 garanton të drejtën për arsimin dhe formimin profesional gjatë gjithë jetës, mundësinë e kryerjes së arsimit fillestar profesional, si dhe fitimin e njohurive profesionale të nevojshme për punësim duke krijuar mundësi të barabarta për të gjithë. Pranimet në arsimin dhe formimin profesional, këshillimin dhe orientimin në arsimin dhe formimin profesional kanë një trajtim të barabartë të të gjithë subjekteve të cilët preken nga ky ligj pavarësisht nga gjinia.

Ligji nr. 8461, datë 25.02.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, tanimë është ndryshuar tërësisht, duke i dhënë një zhvillim më të madh arsimit të lartë shqiptar dhe duke e përfshirë atë në zonën europiane të këtij arsimit. Ky ligj në përmbajtje reflekton parimin e barazisë gjinore. Të gjitha subjektet që janë pjesë e këtij ligji, apo preken prej tij, trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa dallim gjinie. Ndërkohë, ky ligj siguron të mësuarit gjatë gjithë jetës, mundësi dhe shanse të barabarta për të gjithë, mundësi për lëvizje të lirë, duke dhënë kështu mundësi për njohje të studimeve të kryera në të gjithë zonën europiane.

Ligji nr.8872, datë 29.3.2002 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” në pikën 3 të Nenit 1 të tij, përveç qëllimeve të tjera shprehet se ky ligj garanton të drejtën e shprehur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për arsimin dhe formimin profesional gjatë gjithë jetës, mundësinë e kryerjes së arsimit fillestar profesional, si dhe të fitimit të njohurive profesionale të nevojshme për punësim, duke krijuar shanse të barabarta për të gjithë. Nga ky ligj përfitojnë përveç nxënësve dhe personave që kanë mbushur 18 vjeç sipas pikës c) “grupe të veçanta, që dëshirojnë riaftësim profesional, si personat me aftësi të kufizuara, nën atë shumë fëmijë, personat nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, personat nga familje nën nivelin e varfërisë dhe çdo kategori tjetër që do të përcaktohet si e tillë me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Urdhëri Nr. 394 datë 23.02.2004 i Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale “Për tarifat e Sistemit të Formimit Profesional” përcakton se tarifat e regjistrimit për kategoritë: komuniteti rom, vajzat dhe gratë e trafikuar, etj, janë falas për kurset e profesioneve të ofruara nga Qendrat Publike të Formimit Profesional.

1.2.4 Kuadri ligjor në lidhje me kujdesin social²⁹.

Në vitin 2002 miratohet **Ligji Nr.8889, datë 25.04.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7703, datë 11.05.1995 “Për sigurimet shoqërore në RSH”.** Ky ligj solli: së pari, ulje të normës së kontributeve që duhet të paguajnë punëdhënësit dhe punëmarrësit nga 42.5%, në 38.5% duke filluar nga 01.07.2002 dhe së dyti, ndryshime në moshën e pensionit, duke realizuar një rritje graduale për gratë nga 55- 60 vjeç dhe për burrat nga 60- 65 vjeç. Pra, ende ruhet njëfarë diskriminimi pozitiv i gruas në lidhje me përfitimin për pension, duke shtuar këtu edhe faktin se ajo për shkak të jetëgjatësisë më të madhe se burrat, e gëzon për një periudhë më të gjatë kohe pensionin e saj të pleqërisë.

Në **Ligjin Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimin Shoqëror në RSH”,** në Nenin 91/ pika 4 thuhet: “Periudha e kryerjes së studimeve në Shkollën e lartë, me shqiptarë nga puna për gruan, duke filluar nga 1 shtatori 2000 e në vazhdim, pavarësisht nga vendi dhe vitet se kur janë kryer studimet, njihet si periudhë sigurimi vetëm për efekt pensioni pleqërie. Në këtë rast kontributet përballohen nga buxheti i shtetit në kohën kur paraqitet kërkesa për pension”.

²⁹ Për informacion më të detajuar, mund të referoheni tek Aneksi 2, bashkëlidhur kësaj strategjie.

Në **Ligjin Nr.8087, datë 13.03.1996** “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura të RSH, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, në nenin 11, për pension të përkohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm, që kanë dalë në rezervë apo në lirim pas datës 03.07.1991, deri në plotësimin e kushteve për pension pleqerë, përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kur plotësojnë vjetërsinë e shërbimit si ushtarakë, në masën 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat, si dhe të kenë mbushur moshën: gratë 42 vjeç dhe burrat 47 vjeç.³⁰

Me sigurimin vullnetar, që realizohet sipas **Rregullores Nr.35/1,2005**, sistemi i sigurimeve shoqërore iu përgjigj kërkesave të qytetarëve që dëshironin të futeshin në skemën e sigurimeve shoqërore, pa qenë ekonomikisht aktivë, ku sikurse e trajtuam më lart, gratë zenë një peshë specifike më të madhe të popullsisë jo ekonomikisht aktive. Kjo skemë gjithashtu krijoi mundësinë që personi të sigurohet për përfitime maksimale, ku edhe në këtë rast, femrat si më pak të paguara në tregun e punës, kanë mundësi të rritin përfitimet sociale nëpërmjet sigurimit për pensione maksimale. Sigurimin e saj vullnetar mund ta bëjë një person i tretë, pa qenë ajo domosdoshmërisht prezente.

1.2.5 Kuadri ligjor në lidhje me kujdesin shëndetësor.

Neni 55 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton të drejta të barabarta për kujdesin shëndetësor ofruar nga shteti. Megjithatë legjislacioni shqiptar nuk ka të formuluar specifikisht mosdiskriminimin në kujdesin shëndetësor. Ligji mbi Kujdesin Shëndetësor daton nga viti 1963 dhe nuk reflekton klimën e tanishme ligjore.

Ligji për Shëndetin Riprodhues Nr. 8876, datë 04.04.2002 përdor termin diskriminim dhe akordon dhënien e shërbimeve pa dallim gjinie, apo kategorie tjetër demografike. Neni 8 garanton vendim-marrjen e çdo individi në lidhje me ushtrimin e të drejtave riprodhuese sipas interesave të tyre, pa u diskriminuar, detyruar apo dhunuar. Ky ligj gjithashtu ofron mbështetje të veçantë për shërbimet e kujdesit shëndetësor për nënat dhe fëmijët (neni 13/2) dhe vizita kontrolli mjekësore periodike, para dhe pas lindjes, sidomos kontrollë pre dhe post-partum të detyruara (neni 24/1). Qëllimi i këtij ligji është njohja dhe pranimi i të drejtave riprodhuese dhe shëndetit riprodhues të çdo individi. Ky ligj i cili mbështetet në Kushtetutë, Konventën CEDAW, Konventën “Për të Drejtat e Fëmijëve” thekson se shëndeti riprodhues është pjesë e rëndësishme e shëndetit në përgjithësi. Ai jo vetëm që është një refleksion i shëndetit gjatë adoleshencës dhe moshës së rritur, por përcakton dhe bazat e shëndetit gjatë viteve riprodhuese për gratë dhe burrat, si dhe ka edhe efekte të rëndësishme mbi gjeneratat e ardhshme. Ligji respekton gjithashtu parimin e mosdiskriminimit i sanksionuar në Kushtetutë dhe dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare. Neni 37 i ligjit ku bën fjalë për përdorimin e metodave të teknologjive riprodhuese të asistuar ndalon **zgjedhjen e seksit të fëmijës**, me përjashtim të rasteve kur ka mundësi për të trashëguar sëmundje të lidhura me seksin.

Ligji 8045 datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” - Ligji në nenin 1 të tij garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës. Ky parim nuk shkelet, me përjashtim të rasteve kur është e domosdoshme dhe e përcaktuar në ligj. Ligji si një parim tjetër kryesor ka përdorimin të metodave të planifikimit familjar, nga të gjitha qendrat shëndetsore, si mjet për të shmangur shtatëzani të padëshiruara. Ligji ndalon në çdo rast që ndërprerja e shtatëzanisë të konsiderohet si metodë planikimi familjar.

³⁰ “Legjislacioni i Sigurimeve Shoqërore” – ISSH, fq.52

Sipas Ligjit:

Shtatzania mund të ndërpritet për arsye shëndetësore brenda 22 javëve dhe për arsye psikosociale brenda 12 javëve të para të shtatzanisë. Ligji nuk parashikon si nje kusht paraprak pëlqimin e babait të fëmijës për abortin. Në rastet e shtatzanisë për vajzat e reja nën 16 vjeç, kërkohet pëlqimi i prindërve ose i kujdestarit ligjor..

Ligji “Mbi promovimin dhe mbrojtjen e ushqimit me gji” nr. 8528, 23.09.1999, është hartuar për të dekurajuar zëvendësimin e qumështit të gjirit me formulën, për të rregulluar tregëtimin e ushqimit artificial për bebet, si dhe për të promovuar ndërgjegjshmërinë publike mbi avantazhet e ushqimit me gji.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.7895, 27.01.1995, nenet 93, 94 dhe 95 përshkruajnë sanksionet deri në pesë vjet burgim për përfundimin e shtatzanisë pa pëlqimin e gruas, abortin e kryer në mjedise të paautorizuara dhe me persona të paautorizuar, si dhe atyre që u japin grave shtatzana mjete për të ndërprerë shtatzëninë përtej javës së 12.

Strategjia kombëtare për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së HIV/AIDS në Shqipëri në vitet 2004-2010 vë theksin në rrezikun e prekjes nga HIV/AIDS të grave dhe vajzave në Shqipëri dhe synon masa parandaluese ndërgjegjësuese dhe masa trajtimi.

ANEKS 2

REFERENCA LIDHUR ME KUADRIN LIGJOR PËR MBROJTJEN SOCIALE³¹

Ligji i ri “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore” me **VKM, nr. 9355, datë 10.03.2005**, që zëvendësoi ligjin e mëparshëm nr.7710, datë 18.05.1993 “Për Ndhimën dhe Përkujdesjen Shoqërore” si rezultat i ndryshimeve të ndodhura në vend dhe nevojave për shërbime të reja sociale. Ligji i ri është plotësuar me një sërë aktesh nënligjore si:

- ✦ **VKM nr. 564**, datë 12.08.2005 “Për licensimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, i cili është plotësuar dhe me dy udhëzime të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- ✦ **Udhëzimi nr. 90**, datë 16.01.2006 “Për ngritjen e komisionit të licensimit të ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”;
- ✦ **Udhëzimi nr. 90/1**, datë 16.01.2006, “Për procedurën e organizimit të komisionit të licensimit të ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”.

VKM nr. 787, datë 14.12.2005, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së Ndhimës Ekonomike”, si dhe **Udhëzim nr. 338/3**, datë 10.03.2006 “Mbi zbatimin e VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së Ndhimës Ekonomike”.

VKM 786, datë 26.11.2003 “Për komisionimin dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar”, si dhe **Udhëzim nr.298**, datë 11.02.2004 “Për komisionimin dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar”.

VKM nr. 563, datë 12.08.2005 “Për përcaktimin e përgjegjësive të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve shoqërore”.

VKM nr. 209, datë 12.04. 2006, “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe private të përkujdesit shoqëror”.

VKM nr. 419, datë 19.06.2003 “Për trajtimin e jetimëve me shërbim shëndetësor dhe me barna”.

VKM nr. 512, datë 31.05.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore”.

VKM nr. 618, datë 07.09.2006 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”.

³¹ Për më shumë informacion mund t’iu referoheni dhe: Strategjisë së PAK; Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve dhe Strategjisë së Romëve.

VKM nr. 619, datë 07.09.2006 “Për disa ndryshime të VKM nr.31, datë 20.01.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik” të ndryshuar.

Ligji nr. 8788, datë 07.05. 2001 “Për Organizatat jofitimprurëse”.

Udhëzim nr. 687, datë 24.03.2006 “Për administrimin e ndihmave humanitare që përfitojnë institucionet rezidenciale dhe ditore të përkujdesit shoqëror”.

Strategjia e Shërbimeve Shoqërore e miratuar me VKM Nr.265, datë 28.04.2005. Në këtë strategji një vend të *rëndësishëm zënë, gratë e* trafikuar, të dhunuara, romët etj.

ANEKS 3

REFERENCA LIDHUR ME KUADRIN LIGJOR PËR DHUNEN NE FAMILJE

Instrumenta Ndërkombëtare që Mbështesin Veprimtarinë e Shkollave

I – Legjislacioni i brendshëm

- ✦ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- ✦ Ligji për arsimin parauniversitar
- ✦ Kodi Penal
- ✦ Kodi Civil
- ✦ Kodi i Familjes

II – Dokumenta të Organizatës së Kombeve të Bashkuara

- ✦ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- ✦ Konventa për të Drejtat e Fëmijës
- ✦ Konventa për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave

III – Dokumenta të Këshillit të Europës dhe Komisionit European

- ✦ Karta Sociale europiane,
- ✦ Konventa europiane për liritë dhe të drejtat themelor të njeriut,
- ✦ Konventa europiane për ushtrimin e të drejtave të fëmijës,
- ✦ Konventa e Hagës për mbrojtjen e të miturve dhe për bashkëpunimin në fushën e birësimit ndërkombëtar,
- ✦ Rezoluta e Parlamentit European mbi trafikimin e fëmijëve dhe për fëmijët ushtarë,
- ✦ Rekomandime të komisionit european për shfrytëzimin seksual të fëmijëve,
- ✦ Rekomandime të veçanta të Këshillit të Europës,
- ✦ Rekomandimi (85) 4 “ Për dhunën në familje”,
- ✦ Rekomandimi (87) 21“ Për asistencë ndaj viktimave të krimit dhe parandalimin e viktimizimit,
- ✦ Rekomandimi (91) 11 “Për shfrytëzimin seksual”
- ✦ Pakti Ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore Neni 10.

SHTOJCA 2

Analize e kuadrit ligjor ekzistues lidhur me dhunën në familje

Në këtë analizë të gjendjes aktuale të legjislacionit do të respektojmë parimin e hierarkisë së normave që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë të përcaktuar nga vetë Kushtetuta³².

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta përdor një gjuhë neutrale nga këndvështrimi gjinor dhe në të thuhet se: Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca ...” (neni 18/2). Ndonëse nuk ka një normë që në mënyrë specifike të trajtojë dhunën në familje, Kushtetuta e R.Sh i garanton martesës dhe familjes mbrojtje të veçantë (neni 53/2). Meqë i gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në rregullimet dhe parimet kushtetuese, çdo ligji, akt nënligjor, vendim gjyqësor, veprim ose mosveprim i individëve dhe organeve, duhet të respektojë dhe t'i mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të cilat janë të pandashme, të patjetërsueshme e **të padhunueshme** dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik (neni 15/1). Të drejtën për një mbrojtjeje të veçantë nga shteti kanë fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja. Gjithashtu çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi ... (n.54)».

2. Konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Shqipëria ka ratifikuar një pjesë të konsiderueshme të instrumenteve ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në fletoren zyrtare. Sipas nenit 122/2 të Kushtetutës, «marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to».

a) Instrumentet e Kombeve të Bashkuara

Dhuna në familje përfshihet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), pavarësisht se kjo nuk shprehet në mënyrë specifike. Sipas CEDAW diskriminimi përfshin “dhunën e bazuar në gjini, që drejtohet kundër një gruaje sepse ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë shpërpjesëtimore. Ajo përfshin veprime që shkaktojnë dëmtim fizik, mendor apo seksual ose vuajtje, kërcënime për akte të tilla, shtrëngim dhe privime të tjera të lirisë”. CEDAW parashtron një listë të tërë të detyrimeve për shtetet palë për të ndërmarrë “të gjitha masat e duhura”. Kjo Konventë dhe këto masa bëhen më të përforcuara për shkak të miratimit të Protokollit Opsional të CEDAW dhe të Rekomandimit të Përgjithshëm 19 të Komitetit të CEDAW. Në rekomandimet që i ka paraqitur Shqipërisë Komiteti i CEDAW-t ka rekomanduar rishikimin e legjislacionit penal për të bërë të dënueshme dhunën në familje, miratimin e ligjeve të tjera të posacme për dhunën në familje që të parashikojnë udhrat gjyqësore të mbrojtjes dhe ndihmen ligjore për gratë ngritjen dhe funksionimin e një numri të mjaftueshëm strehezash, ngritjen e një mekanizmi shtetror për mbledhjen sistematike të të dhënave dhe statistikave për dhunën në familje, trajnimin dhe ndergjegjesimin e strukturave të sistemit të drejtësisë për çeshtje të dhunës në familje si dhe ndermarrjen e fushatave ndergjegjesuese dhe edukuese për publikun³³.

³² Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998. Sipas nenit 116 të Kushtetutës së R.Sh: “Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e R.Sh janë: a)Kushtetuta;b)marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;c)ligjet;d)aktet normative të Këshillit të Ministrave

³³ Fushat Kryesore Problematike dhe Rekomandimet e Komitetit të CEDAW-t për Qeverinë Shqiptare me rastin e Paraqitjes së Raportit të Kombinuar Fillestar dhe të Dytë Periodik. <http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N03/468/20/PDF/N0346820.pdf?OpenElement>

Mospërmbushja e detyrimeve për të siguruar mbrojtjen e viktimave nga dhuna në familje nuk justifikohet me kushtet e vështira politike, sociale, apo të krizës ekonomike nëpër të cilat kalon shteti shqiptar. CEDAW kërkon nga shtetet *gjithë kujdesin e duhur*. Shteti ka për detyrë që jo vetëm të mos kryejë veprime të paligjshme që shkelin të drejtat e njeriut por edhe të mos lejojë dhe të ndeshkojë qytetaret e vet që kryejnë veprime të tilla të dhunshme. Shteti e ka detyrë ligjore të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të ndaluar dhunimet e të drejtave njerëzore dhe të përdorë mjetet në dispozicion për të kryer hetime serioze të dhunimeve të kryera brenda juridiksionit të tij, të identifikojë përgjegjësit, të imponojë dënimin e përshtatshëm dhe t'u sigurojë viktimave shpërblimin e përshtatshëm.

Mekanizmi i mbikëqyrjes së CEDAW-t (dhe Protokollit Opsional i CEDAW-t) është Komiteti i CEDAW-t, një organizëm ekspert i themeluar në 1982. Shteti detyrohet t'i raportojë Komitetit të pakten çdo kater vjet për parimet që ka bere ne zbatimin e Konventes.

Protokolli Opsional i CEDAW³⁴ u ofron grave kompensime ndërkombëtare, mundësi për të fituar drejtësi në rastet të veçanta dhe inkurajon qeveritë në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme në nivel kombëtar. Duke ratifikuar këtë dokument, Shqipëria i njeh kompetencën Komitetit të CEDAW për të marrë dhe shqyrtuar ankesa nga individë apo grupe brenda juridiksionit të vet³⁵. Përmes forcimit të parimit të llogaridhënies për shkeljet, Protokolli Opsional ka përforcuar efektivitetin e CEDAW si një mjet për mbrojtjen të drejtave të njeriut të grave.

Rekomandimi i Përgjithshëm 19 i Komitetit të CEDAW³⁶ është krijuar për të përforcuar detyrimet e CEDAW-t edhe në fushën e dhunës në familje. Ai rekomandon miratimin e legjislationit të veçantë lidhur me dhunën në familje përfshirë këtu ndëshkimet penale dhe dëmshpërblimin civil; marrjen e një sërë masash parandaluese (duke përfshirë informimin publik dhe programet e edukimit për të ndryshuar qëndrimet përsa i përket roleve dhe statusit të grave, dhe burrave) dhe masash mbrojtëse (duke përfshirë strehimin, këshillimin, rehabilitimin dhe shërbimet e mbështetjes për gratë të cilat janë viktime të dhunës dhe të cilat janë në rrezik dhune); raportimin e dhunës me baza gjinore, duke përfshirë të dhëna mbi çdo formë dhune dhe mbi pasojat e kësaj dhune mbi gratë të cilat janë viktime; monitorimin e vazhdueshëm të masave të ndërmarra; rishikimin e efektivitetit të masave aktuale në mënyrë që të bëhet modifikimi i tyre nëse është rasti, etj.

Deklarata mbi Eliminimin e Dhunës kundër grave³⁷ (DEVAW) e miratuar më 1993 përkufizon në mënyrë të gjerë dhunën kundër grave dhe bën të ditur se ajo mund të ndodhë në familje. Ndonëse Deklarata nuk ka fuqi detyruese, normat e saj kanë rëndësi të madhe në vendosjen e detyrimeve konkrete në fushën e luftës kundër dhunës në familje. Ajo është universale në trajtimin e çështjes dhe është njohur si burim i së drejtës ndërkombëtare. Deklarata përcakton në mënyrë specifike veprimet që një shtet duhet të ndërmarrë për të eliminuar dhunën që ndodh në jetën private: të hartojë legjislationin e duhur penal; planet kombëtare të veprimit për të eliminuar dhunën kundër grave; sipas burimeve në dispozicion t'u sigurojë viktimave të dhunës shërbime sociale; të trajtojë nëpunësit publikë që kanë për detyrë zbatimin e ligjeve për të qenë të ndjeshëm ndaj nevojave të grave, të parashikojë shpenzime në buxhetin e qeverisë për të luftuar dhunën në familje, etj. Deklarata bën

³⁴ Ka hyrë në fuqi më 22 Dhjetor 2000. Që nga 3 Marsi 2006 ka 76 shtete palë.

³⁵ Protokolli Opsional krijon dy procedura: Procedurat e komunikimeve që u lejojnë grave dhe grupeve të bëjnë ankesa ndaj shkeljeve të të drejtave të mbrojtura prej CEDAW, dhe Procedura e hetimit që i lejon vetë Komitetit, pa marrë më parë një ankesë, të iniciojë hetime në situata të shkeljeve të rënda apo sistematike të të drejtave të njeriut në një juridiksion të veçantë.

³⁶ U.N.DocA/47/38(1992)

³⁷ A/Res/48/104

të qartë se veprimet e shteteve palë do të vlerësohen në raport me standardet ndërkombëtare të cilat artikulojnë qartë strategji për eliminimin e dhunës kundër grave në familje³⁸.

Platforma për Veprim e Pekinit në fushën e dhunës në familje, si çështje me prioritet, rekomandon rishikimin e legjislationit, marrjen e masave të tjera të nevojshme dhe krijimin e mekanizmeve të përshtatshëm për të siguruar mbrojtjen e të gjitha grave nga dhuna në familje e cila duhet të trajtohet si një vepër penale, e dënueshme nga ligji (neni 69).

Konventa mbi të drejtat e fëmijës (neni 19), nënvizon detyrimin e shteteve për marrjen e të gjitha masave legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës fizike e mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja ose mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë edhe abuzimin seksual. Konventa përfshin ndër këto masa procedurat e efektshme për parandalimin, identifikimin, raportimin, referimin, hetimin, trajtimin dhe ndjekjen e rasteve të keqtrajtimit të fëmijëve, përfshirë këtu edhe procedurat gjyqësore nëse është rasti. Marrja e masave për riaftësimin fizik dhe psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë e çdo forme të pakujdesisë, shfrytëzimit ose keqtrajtimit, tortures ose të çdo forme tjetër të trajtimit çnjerëzor duhet bërë në kushtet e një mjedisi që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës (neni 39).

Konventa kundër torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo degraduese³⁹.

Protokolli shtesë i Konventës kundër torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo degraduese.

b) Instrumentet e Këshillit të Europës

Dokumentet e të drejtave të njeriut të Këshillit të Europës reflektojnë parimet e traktateve të Kombeve të Bashkuara dhe të instrumenteve të tjera sipas të cilëve dhuna ndaj grave është një dhunim e të drejtave themelore të njeriut. Si të tilla përmendim KEDNJ⁴⁰, Karta Sociale Europiane,

³⁸ Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Rezolutën e të Drejtave të Njeriut 2003/45, **Eliminimi i dhunës kundër grave dhe Legjislationi model mbi dhunën në familje** nga Raportuesi i Posaçëm mbi dhunën kundër grave. E/CN.4/1996/53/Add.2, 2 Shkurt 1996. Në 1996 Raportuesi i Posaçëm mbi dhunën kundër grave përfshiu në raportin e vet një legjislation model mbi dhunën në familje. Modeli përfshin një përkufizim të dhunës në familje, mekanizmat ankues, detyrat e gjyqtarëve, procedurat penale dhe civile, dhe dispozita përpara i përket shërbimeve të emergjencës dhe jo emergjencës, trajnimin e zyrtarëve të policisë dhe të gjyqtarëve, dhe këshilltarëve. Kuadri i këtij legjislationi model skicon elementë të rëndësishëm që duhet të përmbajë një ligj i mire për dhunën në familje. Qellimi i tij është të shërbejë si udhëzues për legjislativin dhe organizatat gjatë lobimeve të tyre mbi legjislationin e dhunës në familje. Modeli ofron masa fleksibel dhe të shpejta për të dekurajuar dhunën në familje dhe për të mbrojtur gratë kur një dhunë e tillë ka ndodhur. Modeli, gjithashtu shërben për ta shpjeguar dhe kuptuar me mire dhunën në familje dhe shkaqet e saj dhe inkurajon pjesëmarrjen e komunitetit në përpjekjet për zhdokjen e dhunës në familje.

³⁹ Dhuna shtetërore në Shqipëri. Raport alternativ për komitetin kundër torturës së OKB. Tiranë dhe Gjenevë 2005. Përgatitur nga CRCA, AHRG dhe CLCI (ish QAG fq 63-95)

⁴⁰ Neni 14 i Konventës Europiane shpreh se “gëzimi i të drejtave dhe lirive të vendosura nga kjo Konventë duhet të sigurohen pa diskriminim për asnjë arsye të tilla si seksi...”. Konventa garanton të drejtën për jetën (neni 2), të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit (neni 5) dhe të drejtën për të qenë i lirë nga tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues (neni 3). Traktati gjithashtu vendos të drejtat e grave për një dëmshpërblim ligjor efektiv përpara autoriteteve kombëtare nëse janë shkelur të drejtat e saj njerëzore (neni 13).

Konventa Europiane për Ndalimin e Torturës dhe Trajtimin dhe Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues⁴¹.

c) Instrumentet e Bashkimit Europian

Ndonëse Shqipëria nuk është vend anëtar i BE, nënshkrimi i MSA prodhon një sërë detyrimesh në drejtim të njohjes, harmonizimit të kuadrit ligjor dhe të strukturave të sistemit të drejtësisë me këto standarde⁴².

Hyrja në BE nuk është thjesht një dëshirë pa detyrime të caktuara. Procesi i integritimit është një rrugë e cila imponon detyrimisht përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në bazë të Rezolutës së miratuar më 2 Shkurt 2006 për të luftuar dhunën kundër grave, Parlamenti Evropian i bëri thirrje Komisionit dhe Shteteve Anëtare **“për të krijuar mjetet e nevojshme për të monitoruar aktivitetin dhe progresin e hyrjes në BE dhe vendet kandidatë në lidhje me trajtimin e grave në të gjitha sferat e shoqërisë, dhe për ta bërë sigurinë dhe trajtimin e grave në këto vende një kriter për anëtarësim”** (paragrafi 1/k). Në të njëjtën kohë, Parlamenti Evropian ka deklaruar një tolerancë zero përkundrejt dhunës kundër grave. Megjithëse rezolutat dhe dokumentet e tjerë të Bashkimit Evropian janë të lidhura vetëm me Shtetet Anëtare, vendet Evropiane jo-anëtare siç është rasti i vendit tonë, që dëshiron të aplikojnë për anëtarësim duhet të harmonizojë legjislacionin me standardet e BE-së.

⁴¹ KEDNJ ka efekt të drejtpërdrejtë në ligjet e brendshme, dhe gjyqësori duhet të mbështetet në dispozitat e Konventës Europiane dhe jurisprudencën e gjykatës së Strasburgut.

Komiteti i Ministrave ka miratuar një sërë rekomandimesh për shtetet anëtare përsa i përket dhunës në familje. Konferenca e tretë Ministrave Europiane mbi barazinë ndërmjet grave dhe burrave në 1993 i përkushtojë strategjive për eliminimin e dhunës kundër grave. Konferenca miratoi • Deklaratën mbi Politikën për luftën kundër dhunës ndaj grave në një Europë demokratike. Një grup pune u formua për të krijuar një • Plan Veprimi për të luftuar dhunën kundër grave. Raporti përfundimtar u finalizua në 1998 dhe përfshin rekomandimet për të luftuar dhunën kundër grave në dy nivele, atë kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Ato përfshijnë zbatimin e reformave legjislativë, gjyqësore dhe ekzekutive. • Rekomandimi 1450 (2000) rekomandon harmonizimin e legjislacioneve kombëtare me të drejtën europiane duke siguruar mbrojtjen e viktimave nëpërmjet sistemit ligjor. • Në Rekomandimin 1582 (2002) nxit shtetet anëtare “të jene të ndërgjegjshme se ato kanë një detyrim të ndalojnë, hetojnë dhe dënojnë aktet e dhunës në familje dhe të sigurojnë mbrojtje për viktimat”. • Rekomandimi 1681 (2004) nxit trajtimin më të gjerë të dhunës në familje si një prioritet politik kombëtar me të cilën duhet të merret qeveria, parlamenti dhe shoqëria civile. Shtetet duhet të marrin masa efektive për të parandaluar dhe dënuar akte të tilla nga persona private dhe për të mbrojtur viktimat/te mbijetuarit.” Rekomandimi nënvizon se “aktet e dhunës në familje të përbëjnë një vepër penale, që viktimave duhet t’u ofrohet mbrojtja më e mirë juridike, psikologjike dhe financiare dhe se një vit të quhet viti evropian kundër dhunës në familje për të siguruar që një dhunë e tillë të mos jetë më një tabu”.

⁴² Burimet kryesore të së drejtës komunitare janë traktatet dhe direktivat.

BE ka trajtuar barazinë gjinore përmes një sërë direktivash, rezolutash, rekomandimesh dhe aktesh, të nxjerra nga Këshilli i Bashkimit i Evropian, Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian⁴³.

Plani Kombëtar për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-se dhe zbatimit të MSA-së parashi-kon një sërë masash legjislative lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë që një kuadër i tërë ligjor do të jetë në një proces analize për t'u harmonizuar me standardet e BE-se. Grupet e punës të krijuara pranë Ministrisë së Drejtësisë, në këtë kuadër, duhet të përfshijnë edhe harmonizimin e legjislacionit me standardet evropiane të mbrojtjes nga dhuna⁴⁴.

Ndërkohë që *konventat e ratifikuara* nga vendi ynë, lidhur me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të grave e fëmijëve në veçanti, janë të shumta e në bazë të Kushtetutës quhen pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe janë të detyrueshme për zbatim, *niveli i njohjes së tyre dhe zbatimit nga gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët është i kufizuar*. Këto instrumente janë të panjohura prej viktimeve të dhunës në familje. Kjo sjell *mos aplikimin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sistemi i drejtësisë dhe mosvënien e tyre në shërbim të viktimeve dhe të atyre që kërkojnë akses në drejtësi (nga monitorimi i vendimeve gjyqësore ka rezultuar se përgjithësisht referimi tek këto konventa është pothuajse zero)*.

⁴³ Dhuna kundër grave është një nga temat kryesore me të cilat merret Bashkimi Evropian. Parlamenti Evropian miratoi Rezolutën mbi dhunën kundër grave në 1986. Rezoluta bënte thirrje për njohjen ligjërish të përdhunimit martesor, trajnimin e atyre që vijnë në kontakt me viktimat e dhunës në familje, dhe rekomandonte sigurimin e asistencës ligjore për gratë. Në vitin 1997 Komisioni Evropian ngriti projektin Dafne për të luftuar dhunën kundër grave, dhe Parlamenti Evropian bëri thirrje për një fushatë ("Toleranca zero") për të mos toleruar dhunën kundër grave. Në të njëjtin vit Lobi i Grave Europiane krijoi Qendrën Europiane për Veprim Politik për Dhunën kundër Grave dhe Observatorin Evropian të dhunës kundër grave. Presidenca e Bashkimit Evropian e ka vendosur çështjen e dhunës në familje në axhenden politike që prej vitin 1998 dhe ka kaluar një sërë rekomandimesh që trajtojnë kryesisht dhunën në familje. Përveç kësaj, në 1999 u lançua Fushata Europiane mbi Dhunën në Familje. Në Konferencën e Bashkimit Evropian mbi dhunën kundër grave të mbajtur në të njëjtin vit, pese forume ekspertësh u ngritën për të hetuar aspekte të caktuara të dhunës në familje: shtrirjen, arsyet që qëndrojnë pas saj dhe pasojat, mundësitë ligjore për luftën kundër dhunës në familje, parandalimin, ndihmën për organizatat dhe bashkëpunimin me institucionet dhe rrjetet Europiane, dhe punën me dhunuesit. Konferenca miratoi Rekomandimet e Forumeve të Eksperteve për shtetet anëtare. Mbledhja e eksperteve të Bashkimit Evropian mbi dhunën kundër grave e mbajtur në 1999 hartoi rekomandimet për modelet të përbashkëta për veprime ndihmëse për të luftuar dhunën. Ato përmbanin programe për trajtimin e burrat të cilët përdornin dhunën, procedimet ligjore dhe kërkimin mbi dhunën. Theksohej se dhuna në familje është një krim dhe se ajo është objekt i procedimeve penale, ku programet e trajtimit të burrave nuk mund ta kompensojnë. Propozimi i bërë prej Parlamentit Evropian dhe Direktiva e Këshillit për të drejtën e qytetarëve të BE dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe banuar lirisht brenda territorit të shteteve anëtare jep shpjegimin se neni mbi "divorcin apo pavlefshmërinë e martesës nuk do të shkaktojë humbjen e të drejtës së banimit të anëtarëve të familjes së qytetarit të BE të cilët nuk janë shtetas të një shteti anëtar i BE" duhet të shtrihet edhe në situatën e dhunës në familje. Komiteti Social dhe Ekonomik rekomandoi se ky formulim duhet të referohej në mënyrë më eksplicite, pra edhe për "dhunën me natyrë psikologjike ose fizike, gjinore në shtëpi ose në familje".

Duke rishikuar zbatimin prej shteteve anëtare të BE-së, Këshilli i Bashkimit Evropian ka përgatitur një raport përsa i përket çështjes se dhunës në familje. Raporti përfshin draftin e përfundimeve të Këshillit në lidhje me treguesit e dhunës në familje dhe listën e treguesve të përgatitur nga presidenca daneze për matjen e përputhjes së dispozitave të dhunës në familje të shteteve anëtare me të Platformën për Veprim të Pekinit.

Në fillim të 2006, Parlamenti Evropian ka prezantuar politikën e tolerancës zero përsa i përket të gjitha formave të dhunës kundër grave. Përmes Rezolutës së tij mbi luftën kundër dhunës së burrave ndaj grave, të miratuar më 2 shkurt 2006, Parlamenti Evropian nxiti shtetet anëtare të marrin masat e duhura të parandalimit dhe ndëshkimit në ligjet e tyre kombëtare, si dhe masat për të mbështetur viktimat dhe ata që janë në rrezik për tu bërë viktimë. Përveç kësaj, Parlamenti i bëri thirrje Komisionit dhe shteteve anëtare "të krijojnë mjetet e nevojshme për të monitoruar aktivitetin dhe përparimin e vendet candidate përsa i përket trajtimit të grave në të gjitha fushat e shoqërisë, dhe ta bëjë sigurinë dhe trajtimin e grave të këtyre vendeve një prej kriterëve të pranimit" (parag.1k). Të gjitha këto aktivitete në nivelin e BE-së tregojnë përfaqshen e rëndësisë së luftës kundër dhunës në familje dhe përgjegjësinë e shteteve në këtë drejtim Shih:http://europa.int.eu/comm./employment_social/equ_opp/colognrec_en.html; <http://presidency.finland.fi/netcomm/news/showarticle1871.html>

⁴⁴ Shih Plani Kombëtar për përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian dhe zbatimit të MSA. Republika e Shqipërisë. Këshilli i Ministrave. Tiranë 2005. fq 89-109.

Kjo bën që edhe *përkufizimet e përdorura prej këtyre instrumenteve të mos njihen e të mos zbatohen*. Ndonëse në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme ndodhet një listë e detajuar e konventave ndërkombëtare të ratifikuara (OKB dhe KE) dhe protokollet respektive, *mungojnë mundësitë njohëse të tyre për shkak se jo të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë kanë akses në internet*. Azhurnimi me legjislacionin e ri ka pengesat e veta, *kjo edhe për shkak të një prodhimtarie evidente të bollshme*. Ndërsa Fletorja zyrtare shpërndahet falas për gjyqtarët dhe prokurorët, kjo nuk ndodh me avokatët. Veç kesaj, jo për të gjitha instrumentat ndërkombëtare është bërë botimi i përkthimit zyrtar në gjuhën shqipe. Jo vetëm kaq por nuk ka një shërbim të indeksuar dhe të azhurnuar të legjislacionit në formë elektronike. Qendra e Publikimeve zyrtare (dhe të tjerë) me gjithë përpjekjet e saj nuk kanë mundur që të prodhojnë në mënyrë virtuale një shërbim të tillë i cili të reflektojë duke përditësuar ndryshimet në legjislacion, të indeksuara sipas çështjeve në mënyrë që të përdoren me lehtësi nga të interesuarit. Konstatohet se ka raste që përkthimet e teksteve të konventave lënë shumë për të dëshiruar dhe krijojnë konfuzion në terminologji.

3. Ligjet në fuqi

Me gjithë reformat e shpeshta në legjislacionin shqiptar, ende *nuk ka ndonjë rregullim, apo ligj specifik* që të ndëshkojë në mënyrë singulare dhunën në familje. Kjo nuk do të thotë që mungojnë dispozitat që ndëshkojnë dhunën dhe veprimet e dhunshme në përgjithësi, por mungesa e një ligji apo e dispozitave specifike, bën që, kur dhuna ushtrohet brenda mjedisit familjar, sistemi i drejtësisë të reagojë përmes zbatimit të atyre dispozitave dhe mjeteve që ndëshkojnë veprimet e dhunshme në përgjithësi. Kjo nuk është efektive dhe e drejtë. Ligjet aktuale parashikojnë disa masa ligjore me qëllim garantimin dhe mbrojtjen nga dhuna në përgjithësi, por *këto norma janë shumë të kufizuara, të paplota dhe këto nuk janë efikase në lidhje me parandalimin, mbrojtjen e viktimave, hetimin, procedimin dhe ndëshkimin e autorëve të dhunës në familje. Në legjislacionin aktual mungon një definicion lidhur me dhunën në familje si edhe një përcaktim adekuat i rrethit të personave që nën këtë kontekst do të quhen anëtarë të familjes*.

Përkufizimi i dhunës në familje duhet të bëjë të qartë që kjo është një formë specifike e dhunës me bazë gjinore. *Do të ishte e rekomandueshme që në këtë kontekst të përdoret përkufizimi i dhunës me bazë gjinore që mbizotëron në dokumentet ndërkombëtare*. Nuk është aspak e plotë nëse kufizohet shtrirja e dhunës në familje vetëm midis personave që janë të martuar (siç ndodh me KF), për këtë arsye duhet bërë kujdes që shtrirja dhe rrethi i personave t'i përgjigjen shtrirjes së problemit. Ka përkufizime të ngushta të natyrës së dhunës në familje sepse *kjo nuk përfshin vetëm dhunën fizike por edhe atë seksuale, psikologjike dhe ekonomike, gjë që nuk pasqyrohet në ligj duke i lënë viktimat pa mbrojtjen e duhur*.

Nga analiza e kuadrit ligjor konstatohet se:

- ✦ **Në Kodin penal** nuk parashikohet si një vepër penale e veçante dhuna në familje. Kodi Penal nuk bën dallimin ndërmjet akteve të kryera nga një anëtar i familjes prej akteve të kryera nga persona të tjerë. Kjo sjell trajtimin e viktimës dhe të dhunuesit brenda një konteksti jo specifik, çka marrëdhënia ndërmjet tyre e dikton. Mungon një përcaktim adekuat sipas këtij legjislacioni lidhur me rrethin e personave që përbëjnë anëtarë të familjes dhe kjo sjell vështirësi edhe në zbatimin e rrethanave renduese. Të dhënat e marra nga studimi i vendimeve gjyqësore evidencojnë faktin se dhuna seksuale është dukuri e përhapur brenda familjes⁴⁵ por në KP *mungon gjithashtu një dispozitë e posaçme për ndëshkimin e përdhunimit martesor*. Ndër masat penale të sigurimit dhe dënimet plotësuese mungon një e tillë si “largimi i përkohshëm nga banesa

⁴⁵ (fq. 32 QNLQ “për një zbatim sa më të mirë të ligjit...”)

bashkëshortore dhe pezullimi/heqja i/e përkohshëm i përgjegjesisë prindërore”. Kundravajtjet penale që lidhen me forma të ushtrimit të dhunës në familje praktikisht sot dënohen vetëm me gjobë. Për efekte parandaluese do të ishte e rekomandueshme dënimi me burg (nga disa ditë deri në disa muaj). Përvoja botërore ka treguar se efektet e një dënimi me burgim janë më efektive se sa një ndëshkim me gjobë. Masa e dënimit është indikator i rëndësisë që ka për shtetin dhe për shoqërinë mbrojtja e një marrëdhënieje të caktuar. Sepse impakti tek viktimat, dhunuesi dhe mesazhi shoqëror që jepet është më me efekte.

Lidhur me *keqtrajtimet fizike të të miturve* konstatojmë se në KP *mungojnë figura veprash penale specifike të tilla si abuzimi me mjetet e korrigjimit dhe të disiplinës, keqtrajtimet e fëmijëve*⁴⁶. *Nuk ka norma specifike në KP për abuzimin psikologjik*. Ndërkohë rastet e abuzimit psikologjik shkaktojnë pasoja të rënda të fëmijët. Të tilla janë shqetësimet psikologjike dhe format e depressionit fëmijor. *Nuk ka norma në KP të cilat i referohen dhunës së asistuar* e cila nënkupton çdo akt dhune fizike, verbale, psikologjike, seksuale dhe ekonomike që ushtrohet mbi subjekte që janë pika referimi të afërta për fëmijët në praninë e fëmijëve. *Nuk ekziston në KP dhe KPP alternativa e masës së sigurimit dhe dënimi plotësues lidhur me “pezullimin e përkohshëm dhe heqjen e përgjegjesisë prindërore” për prindërit abuzues*. Në legjislacionin tonë nuk ka masa të veçanta të cilat janë të disponueshme për qëllime të mbrojtjes së fëmijëve kundër çdo dhune në të cilën i ekspozon konflikti dhe që mund të dëmtojë seriozisht zhvillimin e personalitetit të tyre. Fëmijët e viktimave duhet të kenë ndihmë të specializuar, si p.sh. rehabilitim, asistencë në kujdesin ndaj tyre dhe përkrahje.

Dhuna ndaj të moshuarve shprehet në formën e dhunimit të së drejtës për kujdes dhe asistencë, dhunës fizike, dhunës psikologjike dhe dhunës ekonomike. Përgjithësisht dispozitat e legjislacionit penal shqiptar nuk i referohen në mënyrë specifike mbrojtjes së moshës së tretë. Trajtimi i tyre bëhet nën kontekstin e përgjithshëm të kornizës ligjore.

✦ ***Një trajtim jo specifik i dhunës në familje është i ndjeshëm edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Kështu është evidente se legjislacioni procedural penal nuk mundëson palët e treta të fillojnë procedimet penale duke e njohur këtë si të drejtë vetëm të viktimës (i dëmtuari akuzues). Ndërkohë konstatohet një lloj tërheqjeje e këtyre të fundit (viktimave) ndaj procedimit penal të të afërmeve të tyre. Kështu nga analiza që i është bërë vendimeve gjyqësore pjesa më e madhe e çështjeve të pushuara, me akuzë rrahje dhe plagosje të lehtë, arsyetohen me tërheqjen e ankimit nga e dëmtuara akuzuese. (QNLQ “për një zbatim, fq. 18-40).***

Raportimet e dhunës së prindërve ose anëtarëve të tjerë të familjes ndaj fëmijëve janë pothuajse inekzistente, sikurse raportimet e dhunës që ushtrohen ndaj personave të moshuar. Provat që evidentojnë ushtrimin e dhunës në familje janë të njëjta me provat që nevojiten për të provuar kryerjen e çdo lloji veprash të tjerë penale. Nuk ka asnjë lehtësi në procesin e të provuarit.

✦ ***Dispozitat e Kodit Civil lidhur me shpërblimin e dëmit jo vetëm që nuk zbatohen në mënyrë efektive por në to nuk bëhet asnjë dallim për rastet e dëmit të shkakuar nga dhuna në familje duke e trajtuar këtë çështje në mënyrë të përgjithshme. Në to nuk trajtohet e drejta që kanë viktimat për të marrë kompensimin që u takon për dëmin e pësuar (fizik, psikologjik, moral dhe social) përfshirë këtu edhe shpenzimet gjyqësore. Janë të rralla rastet e ngritjes së padisë civile brenda procesit penal. Kjo sepse edhe për avokatët mbrojtës e ca më shumë për viktimat njohuritë nuk janë të plota e të qarta.***

⁴⁶ këto janë pjesë e disa legjislacioneve të vendeve të tjera, p.sh. neni 571-572 KP Italian

✦ Sipas **Kodit të Familjes**, bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin e bashkëshortit që ushtron dhunë nga banesa bashkëshortore (neni 62). Kështu konstatohet se bëhet fjalë **jo për dhunë në familje në kuptimin e gjerë**, pra të dhunës në familje e cila përfshin ata që ndajnë bashkërisht një jetë familjare dhe quhen anëtarë të familjes, por dhuna ndërmjet bashkëshortëve. Në këtë kontekst nuk përfshihet rasti i bashkëjetesës dhe kompleksiteti i individëve dhe marrëdhënieve të familjes. *KF nuk e trajton në mënyrë të plotë aplikimin e masave të mbrojtjes në rastet e dhunës në familje.* Është e vështirë të sigurohet mbrojtja duke e lënë dhunuesin brenda mjedisit familjar. Ndërkohë dhuna është një situatë emergjence që kërkon një përgjigje të shpejtë. Largimin e menjëhershëm të dhunuesit nga banesa. Neni 62 ndërsa është një mundësi për një mbrojtje më shumë, veç mundësive që të jep legjislacioni penal lë pa përgjigje një sërë pyetjesh si: Sa kohë do të zgjasë masa? Si do të zhvillohet gjykimi? Çfarë mbrojtjeje do të ketë gjatë kësaj kohe që masa të ketë efekt ndaj viktimës së dhunës dhe anëtarëve të tjerë të familjes. Kjo tregon se dispozita ka nevojë për rregullime të karakterit procedural civil.

Kodi i Familjes *nuk parashikon procedura të shpejta ose të thjeshtuara kur zgjidhja e martesës ndodh për këtë shkak të dhunës.* Ndërkohë jeta e viktimës mund të jetë në rrezik. Të njëjtin konkluzion do të thoshim edhe në rastin e dispozitave mbi pasojat e zgjidhjes së martesës mbi fëmijët kur shkak i zgjidhjes së martesës është dhuna në familje (kjo mund të kërkojë modifikim të dispozitave mbi ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe mbi kujdestarinë).

Mungesa e mekanizmave ligjorë të efektshëm për të kundërvepruar ndaj dhunës në familje është një pengese serioze në parandalimin e fenomenit. Një nen i vetëm në KF është i pamjaftueshëm. Futja e rregullave procedurale të qarta dhe zgjerimi i kufirit të pushtetit, sidomos të policisë, do të lehtësonte mbledhjen e provave. Ekzistenca e rregullave legjislative që përcakton parametrat e veprimit të oficerëve të policisë dhe të prokurorit do të jetë një garanci me e mirë për të drejtat e viktimave. Ajo çka lë për të dëshiruar dhe që konstatohet gjatë studimit të vendimeve gjyqësore në rastet e zgjidhjes së martesës, është se shpesh herë njohja dhe kërkimi i këtyre të drejtave prej viktimave dhe mbrojtësve të tyre, rezulton të jetë shumë e ulët.

Ligji për avokatinë nuk parashikon shprehimisht ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje gjë që në mënyrë të drejtpërdrejtë siguron aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë dhe mungesën e një ndihmë ligjore të kualifikuar për vetë specifikën e këtyre situatave. Nuk parashikohet mbrojtja ex officio e viktimave të dhunës në familje si në procesin penal ashtu edhe në atë civil. Ndonëse neni 11/b parashikon ndihmën ligjore falas kur personi i mbrojtur ose i perfaqësuar nuk ka mundësi financiare dispozita e lidh këtë me rastet e caktimit kryesisht të mbrojtësit nga gjykata ose prokuroria dhe në këtë mënyrë dispozita mund të mos ofrojë atë shërbim që duhet të garantohet për viktimat e dhunës në familje pavarësisht statusit të tyre ekonomi.